




Bashkimi Ndërparlamentar
Për demokraci. Për secilin.



ICRC



E Drejta Humanitare Ndërkombëtare

Doracak për Deputetë Nr. 25



Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë

© Bashkimi Ndërparlamentar (UNP) dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq (KNKK) 2016

Ky publikim është botim i përbashkët i Bashkimit Ndërparlamentar dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq.

Publikimi i tërë apo disa pjesë të tij mund të riprodhohen për përdorim personal dhe jo komercial, me kusht që të theksohen të drejtat e autorit dhe burimi i publikimit dhe të mos bëhet asnjë ndryshim i dokumentit. Ju lusim ta informoni Bashkimin Ndërparlamentar lidhur me përdorimin e përmbajtjes së këtij publikimi.

Dizajni: Ludovika Kavalari

Shtypur nga: Kourand et Asocies

ISBN: 978-92-9142-656-0 (BNP)

Fotoja e ballinës: Taiz, Jemen. Në mes të shkatërrimit, popullsia civile përpiqet për të mbijetuar. Çdo ditë sjell sfida të reja dhe rreziqe të reja. ©KNKK/Anes Mahsoub

Përmbajtja

Falënderimi	 05
Parathënia	 06
Çfarë përmban ky doracak?	 08
Pjesa 1: Pyetje dhe përgjigje për të drejtën humanitare ndërkombëtare	 09
Çfarë është e drejta humanitare ndërkombëtare?	 09
Cilat janë marrëveshjet kryesore të DHN-së dhe instrumentet përkatëse?	 000
Kur aplikohet DHN-ja?	 000
Kë mbron DHN-ja dhe si?	 000
Cilat vende dhe objekte janë mbrojtur me DHN dhe si?	 000
Kush i nënshtrohet DHN-së?	 000
Si pengohen shkeljet e DHN-së?	 000
Si dënohen shkeljet e DHN-së?	 000
Cili është dallimi në mes DHN-së dhe DNDNj?	 000
Pjesa 2: Roli i parlamentarëve në implementimin e DHN-së	 000
Si bëhet implementimi i DHN-së?	 000
Cilat masa mund të marrin parlamentarët për ndërtimin e një kornize ligjore gjithëpërfshirëse nacionale për DHN?	 000
Cilat masa praktike mund të marrin parlamentarët për të siguruar zbatimin e DHN-së në nivel nacional?	 000
Cilat masa mund të marrin parlamentarët për të siguruar Dënimin e shkeljeve të DHN-së?	 000
Cili është roli i parlamentarëve në inkurajimin e zbatimit nacional të DHN-së?	 000
Cilat janë masat tjera të implementimit në përputhje me DHN-në?	 000
Çfarë mund të bëjnë parlamentarët për të ndihmuar aksionin humanitar?	 000
Si mund të bëjnë parlamentarët uljen e prekshmërisë në vendet e prekura nga konfliktet përmes sigurimit burimeve fleksibile, të parapara dhe të qëndrueshme të fondeve për aksionin humanitar?	 000

Pjesa 3: Qasja sipas temës	000
DHN-ja dhe terrorizmi	000
Përdhunimi dhe forma të tjera të dhunës seksuale gjatë konflikteve të armatosura	000
Mbrojtja e kujdesit shëndetësor në situata të konfliktit	000
DHN dhe sfida e teknologjive të reja	000
Aktivitetet humanitare dhe mbrojtja e të dhënave personale	000
Fëmijët	000
Refugjatët	000
Personat e zhvendosur brenda vendit	000
Personat e zhdukur	000
Personat me aftësi të kufizuara	000
Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë	000
Armët nukleare	000
Pjesa 4: Instrumentet model dhe materialet referuese	000
Aneksi 1: Instrumentet model për ratifikimin dhe miratimin e konventave ndërkombëtare	000
Aneksi 2: Instrumentet model për ratifikimin dhe miratimin e marrëveshjeve DHN	000
Aneksi 3: Propozim-deklaratat	000
Aneksi 4: Ligjet model	000
Shkurtimisht për KNKK dhe BNP	000
KNKK	000
BNP	000
Akronimet	000

Falënderimi

Ky doracak është rezultat i punës së përbashkët të Bashkimit Ndërparlamentar (BNP) dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq (KNKK). Një kontribut të rëndësishëm në realizimin e këtij punimi dhanë gjithashtu edhe parlamentarët e Komitetit për Promovimin e Respektimit të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe BNP-së.

Ky publikim përfaqëson zëvendësim të doracakut fillestar të botuar në vitin 1999. Edhe pse struktura e këtij doracaku nuk është ndryshuar në masë të konsiderueshme, përmbajtja është ripërtëritë plotësisht me integrimin e përmbajtjeve të reja në fushën së drejtës humanitare ndërkombëtare.

Këshilli i shkrimit dhe redaktimit:

Karen Jabre dhe Norah Babic (BNP)

Antoin Bouvier (KNKK)

Në përgatitjen e këtij doracaku kanë dhënë kontribut edhe këshilltarët e mëposhtëm juridikë të KNKK: A. Breiteger, T. Feraro, G. Giaka, L. Zhizel, M. Lpondono, L. Mareska, M. Mareli, M.-J. Ebu, C. Pelandini dhe C. Sabga; dhe anëtarët e mëposhtëm të Shërbimit Këshillëdhënës të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të KNKK: A. Tobalagba, M. L. Tar, L. Ladouceur, A. Mekei, C. Aperce dhe J. Aesshiman.

Parathënia

Në botën gjithnjë e më të komplekse, konfliktet jo vetëm që po bëhen gjithnjë e më të përhapura me gjasë të madhe për t'u shtrirë përtej kufijve nacionalë, por gjithashtu gjithnjë e më shumë po manifestohen me forma të ndryshme jo konvencionale të dhunës. Nevoja për respektimin dhe mbrojtjen e civilëve është shumë më emergjente dhe më e domosdoshme se kurrë më parë, për shkak se format dhe praktikat e luftimit modern po ndryshohen në mënyrë dramatike.

Konventa origjinale e Gjenevës e miratuar para më shumë se 150 vjet ishte një hap i madh përpara në mbrojtjen e luftëtarëve të sëmurë dhe të lënduar. Që atëherë, e drejta humanitare ndërkombëtare (DHN) u bë më gjithëpërfshirëse dhe inkorporoi një numër të madh marrëveshjesh dhe protokollesh, në mënyrë që rregullojë mënyrën e zhvillimit të luftës dhe për të kufizuar efektet e luftës.

Për fat të keq, konfliktet e armatosura gjithmonë janë të shoqëruara me vuajtje të tmerrshme njerëzore, shpeshherë si rezultat i shkeljeve të DHN-së. Ato ndikojnë jo vetëm në palët ndërluftuese, por edhe në civilët, të cilët gjithnjë e më shumë e mbajnë barrën e konfliktit. Nganjëherë civilët merren si objektiv konkret dhe u nënshtrohen krimeve të tmerrshme me një mospërfillje të papërligjur të Konventave të Gjenevës, të cilat si qëllim kryesor kanë mbrojtjen e personave që nuk janë të përfshirë në armiqësitë.

Por, asgjë nuk është e pashmangshme lidhur me këto vuajtje: ne kemi aftësi dhe mjete për të parandaluar këtë. Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë janë një mekanizëm i fuqishëm, i dizajnuar për të mbrojtur ata që nuk janë apo që tanimë nuk janë të përfshirë në luftërat. Në një botë ku jemi dëshmitarë të mosrespektimit gjithnjë e më të madh të DHN-së, rëndësia dhe domethënia e kësaj pjese të së drejtës asnjëherë nuk ka qenë aq e madhe.

Edhe pse të gjitha vendet kanë ratifikuar Konventat e Gjenevës së vitit 1949, shumica prej tyre ende nuk i kanë ratifikuar apo pranuar Protokollet Shtesë të vitit 1977 dhe marrëveshjet tjera DHN. Ratifikimi universal i instrumenteve të DHN-së është një hap nismëtar thelbësor për të siguruar për personat që kanë të drejtën e mbrojtjes sipas ligjit, që të kenë dobi nga kjo e drejtë.

Parlamentarët luajnë një rol të rëndësishëm për të marrë këtë hap të parë të domosdoshëm, si dhe hapat tjerë pasues, të nevojshëm për të siguruar një implementim efektiv. Rregullat e DHN-së duhet të inkorporohen në legjislaturën nacionale dhe dispozitat e çdo vendi. Implementimi nacional i marrëveshjeve të fushës së të drejtës humanitare ndërkombëtare ka një rëndësi thelbësore për realizimin e një niveli më të lartë të respektimit të DHN-së.

Legjislacioni në vetvete nuk mjafton. Parlamentet dhe parlamentarët, përmes përgjegjësisë mbikëqyrëse mund të sigurojnë që forcat ushtarake dhe të sigurisë të aftësohen në mënyrë përkatëse dhe të kenë njohuri të duhura të DHN-së. Përmes udhëheqjes dhe avokimit të tyre, ata gjithashtu mund të rrisin ndërgjegjësimin publik për të drejtën humanitare ndërkombëtare. Nëse konceptet e DHN-së njihen dhe kuptohen në kohë pazeje, ka më shumë gjasa se ato do të zbatohen në kohë lufte.

Ky doracak është rezultat i bashkëpunimit dhe partneritetit të frytshëm shumëvjeçar ndërmjet Bashkimit Ndërparlamentar (BNP) dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq (KNKK), roje dhe promotor i DHN-së. Doracaku është dizajnuar në mënyrë speciale për t'ua bërë të njohura parlamentarëve (deputetëve) parimet e përgjithshme të Konventave të Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë, dhe për t'i udhëzuar ata në procesin e zbatimit të kësaj fushe të së drejtës në vendin e tyre. Doracakut siguron informacione hap-pas-hapi për masat që duhet t'i marrin vendet-nënshkruese të Konventave të Gjenevës, për të përmbushur detyrat që i kanë pranuar lidhur me "respektimin dhe sigurimin e respektimit" të DHN-së.

Kjo është një fushë shumë e politizuar ku deputetët, si liderë politikë dhe përfaqësues të popullit, duhet të jenë avangardë në lidhje me përpjekjet për të siguruar zbatimin konsekuent të DHN-së.

Gjithashtu ky doracak ka për qëllim t'u ndihmojë parlamentarëve në vendet që akoma nuk i kanë nënshkruar të gjitha marrëveshjet lidhur me të drejtën humanitare ndërkombëtare, për të bindur liderët e qeverive në lidhje me nevojën absolute për të mbrojtur civilët e prekur nga një konflikt i armatosur dhe për të siguruar që autorët e krimeve të mbajnë përgjegjësinë për veprimet e tyre.

Viktimat e lutës anëmbanë botës na përkujtojnë për çdo ditë se përgjegjësia për të mbrojtur njerëzit më të prekur dhe për t'i dhënë fund vuajtjeve njerëzore është obligim kolektiv. Fuqia e parlamenteve në botë është e madhe për të ndikuar në ndryshimet globale duke ndërmarrë veprime individuale nacionale. Ky doracak ka për qëllim të ndihmojë ata të shfrytëzojnë këtë fuqi në mënyrë që të ndërmerren hapat e domosdoshme.

Martin Çungong
Sekretar i përgjithshëm
Bashkimi Ndërparlamentar

Piter Mauer
Kryetar
Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq

Çfarë përmban ky doracak?

Pjesa 1 jep një pasqyrë të përgjithshme të së drejtës humanitare ndërkombëtare (SHN) përmes analizës së nëntë pyetjeve të përgjithshme. Në këtë pjesë theksi është vënë në burimet e DHN-së; situatat kur zbatohet ajo; kategoritë e njerëzve që janë të mbrojtur me rregullat që janë inkorporuar në DHN; mekanizmat për zbatimin e DHN-së dhe ndalimi i shkeljeve të DHN-së; dhe lidhja ndërmjet DHN-së dhe fushave të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

Pjesa 2 plotësisht i kushtohet **rolit të deputetëve në zbatimin e DHN-së**. I shqyrton llojet e ndryshme të masave që parlamentarët duhet t'i marrin parasysh për të përmirësuar respektimi e DHN-së nga ana e vendeve. Këto masa kanë për qëllim *pengimin* e shkeljeve të obligimeve të pranuar nga vendet; *përmirësimin e mbikëqyrjes* në lidhje me zbatimin e rregullave; dhe *dënimin* e atyre që janë përgjegjës për shkeljen e rregullave. Secila prej këtyre masave është e shoqëruar me një listë të hollësishme të gjërave që duhet t'i kenë parasysh deputetët.

Pjesa 3 përmban një pasqyrë të disa **çështjeve kyçe** që janë të pranishme në konfliktet e armatosura të sotme, duke filluar nga aktet e terrorizmit deri te dhuna seksuale, dhe nga përdorimi i teknologjive të reja deri te mbrojtja e të dhënave personale e viktimave të konflikteve të armatosura.

Pjesa 4 siguron një numër të caktuar të **instrumenteve model dhe të materialit referues**. Këto resurse mund të ndihmojnë deputetët në përpjekjet e tyre për të respektuar vendi i tyre marrëveshjet në përputhje me DHN-në dhe për të zbatuar punën ligjvënëse e cila është e domosdoshme për një zbatim dhe aplikim të drejtë të këtyre marrëveshjeve në vend.

Pjesa 5 më hollësisht përshkruan punën e Bashkimit Ndërparlamentar (BNP) dhe të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq (KNKK).

Pjesa 1: Pyetjet dhe përgjigjet e së drejtës humanitare ndërkombëtare

Burgu Anajansi, Kuibdo, Kolumbi. Intervistë me një person të paraburgosur.
KNKK, Boris Heger



Çfarë është e drejta humanitare ndërkombëtare?

E drejta humanitare ndërkombëtare (DHN), e cila nganjëherë quhet “ligji i luftës” ose “ligji i konflikteve të armatosura”, rregullon marrëdhëniet ndërmjet shteteve, organizatat ndërkombëtare dhe subjektet tjera në përputhje me të drejtën ndërkombëtare gjatë një konflikti të armatosur. DHN është një fushë e të drejtës humanitare ndërkombëtare që përbëhet nga rregullat për mbrojtjen e njerëzve që nuk janë pjesë, ose që tanimë nuk marrin pjesë në armiqësitë, dhe nga kufizimet e mjeteve dhe metodave të luftimit. Me fjalë të tjera, DHN përbëhet nga e drejta ndërkombëtare e kontratave dhe rregullat zakonore të cilat posaçërisht janë të dedikuara për zgjidhjen e çështjeve humanitare që dalin drejtpërdrejt nga konflikti i armatosur, pavarësisht nëse janë të karakterit ndërkombëtar ose jo-ndërkombëtar.

DHN ka dy fusha:

“Ligji i Gjenevës”: rregulla që mbrojnë viktimat e konflikteve të armatosura, si për shembull personelin ushtarak që tanimë nuk është pjesë e veprimeve ushtarake (si për shembull luftëtarët e plagosur ose të burgosurit e luftës) dhe viktimat që nuk janë pjesë apo që nuk marrin pjesë më në armiqësitë.

“Ligji i Hagës”: rregulla që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve ndërluftuese në kryerjen e veprimeve armiqësore, të cilat i kufizojnë mjetet dhe metodat e luftës.

Shtatë rregullat themelore që dalin nga Konventat e Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokollet e tyre shtesë të vitit 1977 dhe 2005

1. Njerëzit që nuk tanimë pjesë e veprimeve luftarake, respektivisht që nuk janë të përfshirë direkt në armiqësitë, kanë të drejtën që t'u respektohet jeta e tyre dhe integriteti moral dhe fizik. Në të gjitha rrethanat, ata duhet të jenë të mbrojtur dhe të trajtuar në mënyrë humane pa asnjë sjellje armiqësore ndaj tyre.
2. Është e ndaluar të vritet apo të lëndohet armiku i cili është dorëzuar apo që tanimë nuk është pjesë e veprimeve luftarake.
3. Të plagosurit dhe të sëmurët do të merren dhe për ta do të përkujdeset pala në konflikt që i ka nën kontrollin e saj. Mbrojtja gjithashtu përfshin personelin mjekësor, objektet, mjetet dhe pajisjet e transportit. Emblemat e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe janë shenjat që sigurojnë këtë mbrojtje dhe ato doemos duhet të respektohen.
4. Luftëtarët e zënë robër dhe civilët nën autoritetin e palës kundërshtare kanë të drejtën që t'u respektohet jeta, dinjiteti, të drejtat dhe bindjet personale të tyre. Ata duhet të jenë të mbrojtur nga të gjitha aktet e dhunës dhe reprezaljet. Ata kanë të drejtën për të bërë letërkëmbim me familjet e tyre dhe për të marrë ndihmë.
5. Secili ka të drejtën për të gëzuar garancitë themelore gjyqësore. Askush nuk duhet të jetë përgjegjës për një vepër që nuk e ka bërë. Askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës fizike apo mendore, ndëshkimit fizik ose trajtimit mizor ose degradues.
6. Palët në konflikt dhe pjesëtarët e forcave të tyre të armatosura nuk kanë zgjedhje të pakufizuar të metodave dhe mjeteve të luftës. Është e ndaluar të përdoren armët apo metodat e luftës që sipas natyrës së tyre mund të shkaktojnë lëndime të tepruara apo vuajtje të panevojshme.
7. Palët në konflikt në çdo kohë do të bëjnë dallimin ndërmjet popullsisë civile dhe luftëtarëve, me qëllim që të kursehen civilët dhe pasuria e civilëve. Sulmet do të drejtohen vetëm kundër objektivave ushtarakë.

DHN nuk përcakton nëse ndonjë shtet ka të drejtë për të zhvilluar luftë apo për të përdorur forcë ushtarake kundër një shteti tjetër. Përgjigjen për këtë çështje mund ta gjeni në një të drejtë publike ndërkombëtare tjetër e quajtur **jus ad bellum** (e

drejta e luftimit) e paraqitur në Kartën e Kombeve të Bashkuara. DHN-ja, nga ana tjetër, është sinonim i **jus in bello** (sjellja e palëve). Ky trup i dytë i së drejtës rregullon sjelljen e palëve të përfshira në konfliktin e armatosur, pavarësisht nga arsyet e konfliktit apo se cila palë e ka filluar armiqësinë. Kjo e drejtë ka për qëllim mbrojtjen e viktimave të konfliktit të armatosur, pavarësisht nga përkatësia e tyre.

jus ad bellum

Përcakton të drejtën për të përdorur forcat e armatosura.

Lufta është mjet jo legal

Neni 2 (4) i Kartës së Kombeve të Bashkuara thotë se “anëtarët do të përmbahen në marrëdhëniet e tyre ndërkombëtare për t’u kërcënuar apo përdorur forcë kundër integritetit territorial apo pavarësisht politike të cilitdo vendi tjetër”. Me fjalë të tjera, lufta nuk është mjet i pranueshëm për zgjidhjen e kontesteve ndërmjet shteteve.

Karta megjithatë bën dy përjashtime në lidhje me këtë rregull:

- Në rast të vetëmbrojtjes individuale ose kolektive ndaj një agresioni të një shteti tjetër apo një grupi të shteteve; dhe
- Me autorizim të Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara (në bazë të Kapitullit VII të Kartës) me qëllim që të ruhet paqja dhe siguria ndërkombëtare.

Ndalimi për të përdorur forcën nuk zbatohet tek konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare.

Jus in bello

Zbatohet tek të gjitha palët në konflikt dhe rregullon sjelljen e tyre pasi të ketë shpërthyer një konflikt i armatosur.

Lufta është realitet

DHN-ja zbatohet pavarësisht arsyeve të konfliktit dhe vlefshmërisë së arsyeve që qëndrojnë prapa konfliktit.

Balancimi në mes domosdoshmërisë së luftës dhe humanitetit

DHN përfaqëson kompromis në mes dy parimeve kryesore: domosdoshmëria e luftës dhe humaniteti. Këto dy parime janë baza e të gjitha rregullave që dalin në kuadër të DHN-së.

Në përputhje me parimin e **domosdoshmërisë së luftës**, palët në konflikt mund të përdorin këto mjete dhe metoda që janë të domosdoshme për të realizuar objektivat legjitimë ushtarakë në një konflikt, të cilat në asnjë mënyrë nuk janë të

ndaluara me DHN. Shkalla dhe lloji i forcës që mund të përdoret nga palët në konflikt janë kufizuar në atë që është e domosdoshme për të mposhtur armikun sa të jetë e mundur më shpejtë me sa më pak humbje njerëzore dhe të resurseve.

Parimi i **humanitetit** ndalon palët në konflikt për të shkaktuar çfarëdo qoftë vuajtje apo shkatërrim të panevojshëm për realizimin e një objekti legjitim në konflikt.

Mbrojtja, proporcionaliteti dhe masat e kujdesit

DHN ka për që qëllim që mbrojtë popullsinë civile gjatë kohës së konfliktit përmes rregullimit të sjelljes gjatë armiqësive, respektivisht, të rregullojë sjelljen e palëve në konfliktin e armatosur gjatë operacioneve ushtarake. Kjo bazohet në tre parime:

Mbrojtja: Palët në konflikt në çdo kohë duhet të bëjnë dallimin midis popullsisë dhe objekteve civile, dhe luftëtarët dhe objektet ushtarake. Me fjalë të tjera, një palë e caktuar në një konflikt të armatosur mund drejtojë sulmet e veta mbi luftëtarët dhe objektet ushtarake. Janë të ndaluara sulmet direkt mbi popullsinë civile dhe objektet civile. Gjithashtu janë të ndaluara sulmet jo selektive; kjo nënkupton sulmet që nuk janë drejtuar kah objektivat specifike ushtarake, ose nëse përdorin metoda ose mjete të luftimit që nuk mund të orientohen drejt një objekti ushtarak, ose inkorporojnë metoda ose mjete të luftimit me ç'rast efektet nuk mund të kufizohen në përputhje me normat që dalin nga DHN-ja.

Proporcionaliteti: Lëndimet e civilëve dhe marrja incidentale e jetës së njerëzve dhe shkatërrimi i pasurisë nuk duhet të jenë të tepruara respektivisht duhet të jenë në atë shkallë sa të realizohet një përparësi konkrete dhe e drejtpërdrejtë ushtarake e paraparë me sulmin.

Masat e kujdesit: Palët në konflikt duhet të mbajnë llogari vazhdimisht për të kursyer civilët dhe objektet civile gjatë operacioneve ushtarake. Kjo mund të realizohet përmes kontrollit të dyfishtë nëse objekti me të vërtetë është objektiv ushtarak ose të jepet një paralajmërim efektiv për popullsinë civile para sulmit.

Ndalesat dhe kufizimet e disa mjeteve dhe metodave të luftimit

Ndalesat dhe kufizimet e përgjithshme

DHN i ndalon mjetet (armët) dhe metodat të cilat:

- janë dizajnuar kryesisht për të përhapur terror tek popullsia civile;
- nuk bëjnë dallim midis luftëtarëve dhe civilëve (dhe pasurisë së tyre);
- shkaktojnë lëndime të tepruara dhe vuajtje të panevojshme;
- shkaktojnë dëm të madh dhe afatgjatë në mjedisin jetësor.

Ndalesat dhe kufizimet e veçanta

Përdorimi i disa **armëve** është kufizuar ose janë ndaluar plotësisht me marrëveshje apo DHN zakonore, ndër të cilat:

- Helmet dhe armët helmuese;
- Armët kimike dhe biologjike;
- Plumbat që shpërndahen apo shpërthejnë në trup (plumbat dum-dum);
- Armët, efekti primar i të cilave është për të shkaktuar lëndim përmes fragmenteve që nuk mund të zbulohen me rrezet X;
- Projektilet shpërthyes dhe ndezës;
- Minat, minat tokësore dhe pajisje të ngjashme;
- Armët ndezëse dhe armë që janë dizajnuar kryesisht për të ndezur objekte dhe njerëz;
- Armët verbuese me laser;
- Mbetjet shpërthyes të luftës;
- Minat kundër këmbësorisë;
- Municionet thërrmuese.

Me Marrëveshjen për tregtinë me armë të vitit 2013 është ndaluar që shteti të autorizojë çfarëdo qoftë transferimi të armëve konvencionale, komponentët e tyre kryesorë dhe municionet, në qoftë se ekziston njohuria se ato do të përdoren për gjenocid, krim kundër njerëzimit, shkelje të rënda të dispozitave të Konventave të Gjenevës, të drejtuara kah objektivat civile apo civilët e mbrojtur, ose vepra të tjera penale të luftës.

Gjithashtu urdhëron vendin importues për të bërë vlerësimin e rreziqeve nëse kjo armë apo këto produkte mund të përdoren për të kryer apo ndihmuar shkelje serioze të DHN-së ose të së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (DNDNJ).

Disa metoda të luftimit janë veçanërisht të ndaluara në përputhje me marrëveshjen apo DHN-në zakonore, ndër të cilat janë:

- mos marrja e robërve të luftës; forcave të armikut detyrimisht duhet t'u jepet mundësia për t'u dorëzuar dhe për të qenë robër të luftës;
- plaçkitja e pasurisë private;
- Prurja e popullsisë civile në gjendje të urisë; dhe
- Vrasjet perfide, lëndimi apo kapja e armikut. Perfiditeti është përcaktuar në Nenin 37 të Protokollit I Shtesë si "vepër që mashtron mirëbesimin e armikut për ta sjellë në situatë që të besojë se ai ka të drejtë, apo është i detyruar për të lëshuar pe, mbrojtje në përputhje me rregullat e të drejtës ndërkombëtare që zbatohen në një konflikt të armatosur, me qëllim që të tradhtohet ai mirëbesim". Këtu nënkuptojmë edhe, për shembull lëndimin apo sëmundjen me qëllim që të sulmohet armiku.

Cilat janë marrëveshjet kryesore të DHN-së dhe instrumentet përkatëse?

Marrëveshjet për mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura

Konventa për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat ushtarake në luftë (Konventa e Parë e Gjenevës) 12 gusht 1949	Mbrojtja e të luftëtarëve të plagosur dhe të sëmurë, personelit që kujdeset për ta, objektet në të cilat janë akomoduar dhe pajisjet, duke përfshirë edhe mjetet e transportit që përdoren për këtë qëllim. Rregullohet përdorimi i emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq.
Konventa për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve, të sëmurëve dhe luftëtarëve të një anijeje të fundosur, pjesëtarë të forcave të armatosura detare (Konventa e Dytë e Gjenevës) 12 gusht 1949	Mbrojtja e luftëtarëve të një anijeje të fundosur dhe rregullimi i mënyrës për trajtimin e tyre.
Konventa për trajtimin e të zënëve robër (Konventa e Tretë e Gjenevës) 12 gusht 1949	Mbrojtja e pjesëtarëve të forcave të armatosura që janë të burgosur të luftës. Përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e forcave që paraburgosin të burgosur, duke përfshirë edhe mënyrën e trajtimit të të burgosurve të luftës.
Konventa për mbrojtjen e personave civilë gjatë kohës së luftës (Konventa e Katërt e Gjenevës) 12 gusht 1949	Përcakton rregullat e mbrojtjes së popullsisë civile, sidomos trajtimin e civilëve në një territor të okupuar dhe personat e privuar nga liria, dhe përgjithësisht çështjen e lidhur me okupimin.
Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës i 12 gushtit të vitit 1949, i cili i referohet mbrojtjes së viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare (Protokolli I Shtesë) 8 qershor 1977	Përmban garanci themelore për njerëzit që nuk janë pjesë e armiqësive gjatë kohës së një konflikti të armatosur ndërkombëtar dhe përcakton rregullat e mbrojtjes së civilëve, objekteve dhe instalimet

	civile që janë esenciale për mbijetesën e popullsisë civile.
Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës i 12 gushtit të vitit 1949, për mbrojtjen e viktimave në konfliktet e armatosura ndërkombëtare (Protokolli II Shtesë) 8 qershor i vitit 1977	Përmban garancitë themelore për njerëzit që nuk marrin pjesë në armiqësitë gjatë një konflikti të armatosur ndërkombëtar dhe përcakton rregullat e mbrojtjes së popullsisë civile, objekteve dhe instalimet civile që janë esenciale për mbijetesën e popullsisë civile.
Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës i 12 gushtit të vitit 1949, i cili i referohet miratimit të Emblemës Mbrojtëse Shtesë (Protokolli III Shtesë) 8 dhjetor i vitit 2005	Kristali i kuq i shtohet Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe si emblemë mbrojtëse.
Konventa për Të Drejtat e Fëmijëve 20 nëntor i vitit 1989	Neni 38 zgjeron mbrojtjen e fëmijëve në situata të konflikteve të armatosura. Neni 43 parasheh një komitet që do të formohet për të monitoruar përparimin e vendeve nënshkruese në lidhje me obligimet që dalin nga Konventa.
Protokolli jo i detyrueshëm ndaj Konventës për Të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura 25 maj i vitit 2000	Urdhëron vendet nënshkruese për t'u distancuar nga rekrutimi i dhunshëm i fëmijëve nën moshën 18-vjeçare në forcat e armatosura dhe për të siguruar që pjesëtarët e forcave të tyre të armatosura nën moshën 18-vjeçare të mos marrin pjesë direkt në armiqësitë. Thirren grupet e armatosura që nuk i takojnë forcave të armatosura shtetërore të përmbahen nga rekrutimi apo përdorimi i fëmijëve të moshës nën 18-vjeç në armiqësitë.

Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave nga Zhdukja e Dhunshme 20 dhjetor i vitit 2006	Ka për qëllim të sigurojë që njerëzit të mos zhduken, përfshirë edhe në situatat e një konflikti të armatosur.
--	--

Marrëveshjet që kufizojnë apo ndalojnë përdorimin e disa armëve


Protokolli për Ndalimin e Përdorimit të Gazrave Ngulfatës, Helmues apo të tjerë dhe të Metodave Bakteriologjike të Luftimit 17 qershor i vitit 1925	Ndalon përdorimin e gazrave dhe lëngjeve ngulfatëse, helmuese e të tjerë dhe të materialeve dhe pajimeve të kësaj natyre.
Konventa për Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit dhe Depozitimit të Armëve Bakteriologjike (Biologjike) dhe Helmuese dhe Zhdukja e tyre 10 prill i vitit 1972	Ndalon zhvillimin, depozitimin, furnizimin dhe ruajtjen e agentëve mikrobiologjikë, agentët dhe toksinë të tjerë biologjikë, që nuk kanë arsyetimin se janë duke u përdoruar për qëllime parandaluese, mbrojtëse dhe qëllime të tjera paqësore. Gjithashtu ndalon armët, pajimet dhe mjetet e shpërndarjes të destinuara për përdorimin e agentëve të tillë për qëllime armiqësore ose për përdorim në konflikte të armatosura.
Konventa për Mbrojtjen ose Kufizimin e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale që mund të konsiderohet se shkaktojnë Lëndime të Tepruara apo që kanë Efekte Jo Selektive 10 tetor i vitit 1980, e ndryshuar më 21 dhjetor të vitit 2001	Përcakton kornizën e mbrojtjes së disa armëve (shih protokollet e konventave më poshtë në këtë tekst).
Protokolli për Fragmentet e Pa-detektuara i Konventës për Mbrojtjen ose Kufizimin e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale (Protokolli I) 10 tetor i vitit 1980	Ndalon përdorimin e armëve që lëndojnë me fragmentet (pjesët) e tyre dhe të cilat nuk mund të detektohen me rrezet X.
Protokolli për Ndalimin dhe Kufizimin e Përdorimit të Minave, minave kundër	Ndalon përdorimin e minave, minave kundër këmbësores dhe pajisje të

këmbësisë dhe pajisje tjera ndaj Konventës për Mbrojtjen apo Kufizimin e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale (Protokolli II) 10 tetori i vitit 1980, i ndryshuar më 3 maj të vitit 1996	tjera ndaj popullsisë civile dhe kufizon përdorimin e objektivave ushtarake. Protokolli i ndryshuar në mënyrë plotësuese zgjeron ndalimin e këtyre pajisjeve dhe zgjeron zbatimin edhe të konflikteve jo-ndërkombëtare.
Protokolli për Ndalimin apo Kufizimin e Përdorimit të Armëve ndezëse ndaj Konventës për Mbrojtjen ose Kufizimin e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale (Protokolli III) 10 tetori i vitit 1980	Ndalon përdorimin e armëve ndezëse ndaj civilëve dhe objekteve civile dhe kufizon përdorimin e tyre në objektiva ushtarakë.
Protokolli për Armët Verbuese i Konventës për Mbrojtjen dhe Kufizimin e Përdorimit të Disa Armëve Konvencionale (Protokolli IV) 13 tetor i vitit 1995	Ndalohet përdorimi i armëve laser që janë dizajnuar posaçërisht për të shkaktuar verbëri të përhershme.
Protokolli për Mbetjet Eksplozive të Luftës i Konventës për Mbrojtjen apo Kufizimin e Disa Armëve Konvencionale (Protokolli V) 28 nëntor i vitit 2003	Urdhëron Vendet Nënshkruese, si dhe Palëve jo-shtetërore në një konflikt që janë përgjegjëse për mbetjet eksplozive të luftës në territorin që është nën kontrollin e tyre, dhe inkurajon përdoruesit e armëve eksplozive për të siguruar ndihmë për të lehtësuar shënimin dhe pastrimin, heqjen apo shkatërrimin e mbetjeve eksplozive të luftës.
Konventa për Ndalimin e Zhvillimit, Prodhimit, Depozitimit dhe Përdorimit të Armëve Kimike dhe Shkatërrimi i tyre 13 janar i vitit 1993	Ndalon zhvillimin, prodhimin, depozitimin dhe përdorimin e armëve kimike.
Konventa për Ndalimin e Përdorimit, Depozitimit, Prodhimit dhe Bartjes së Minave Kundër Këmbësisë dhe për Shkatërrimin e tyre	Ndalon përdorimin, depozitimin, prodhimin dhe bartjen e minave kundër këmbësisë.

18 shtator i vitit 1997	
Konventa për Municionet Thërmuese 30 maj i vitit 2008	Ndalon përdorimin, zhvillimin, prodhimin, blerjen, depozitimin, ruajtjen dhe bartjen e municionit thërmues dhe çdo ndihmë apo inkurajim të angazhimit në aktivitete të ndaluara me këtë Konventë.
Marrëveshja për Tregti me Armë 2 shkurt i vitit 2013	Rregullon transferimin ndërkombëtar të armëve konvencionale, materialit ushtarak, municionit, pjesët dhe komponentët.

Marrëveshjet për mbrojtjen e të mirave kulturore dhe mjedisit jetësor

Konventa për Mbrojtjen e Të Mirave Kulturore në Rast të një Konflikti të Armatosur 14 maj i vitit 1954	Mbron të mirat kulturore, përfshirë veprat me rëndësi arkitektonike, artistike apo historike; zbatohet gjithashtu edhe në konflikte jo-ndërkombëtare.
Protokolli i Parë për Konventën e Hagës i vitit 1954 për Mbrojtjen e Të Mirave Kulturore në Rast të një Konflikti të Armatosur 14 maj i vitit 1954	Ka për qëllim parandalimin e bartjes së të mirave kulturore nga territori i okupuar dhe të sigurojë se pasuria e tillë do të ruhet dhe kthehet.
Protokolli i Dytë për Konventën e Hagës i vitit 1954 për Mbrojtjen e Të Mirave Kulturore në Rast të një Konflikti të Armatosur 26 mars i vitit 1999	Zgjeron rregullat e mbrojtjes së të mirave kulturore dhe forcon mekanizmat e zbatimit; aplikohet vetëm në rast të konflikteve jo ndërkombëtare.
Konventa për Ndalimin e Përdorimit Armiqësor të Teknikave Ushtarake apo të çdo Teknike për Modifikimin e Mjedisit Jetësor 10 dhjetor i vitit 1976	Ndalon përdorimin, për shkak të qëllimeve ushtarake apo qëllimeve të tjera armiqësore, të aplikimit të teknikave të modifikimit të mjedisit apo gjeofizik, që kanë efekte me ndikim të gjerë, të përhershme dhe serioze.



E Drejta Penale Ndërkombëtare

Statuti i Gjykatës Penale
Ndërkombëtare
17 korrik i vitit 1998, i ndryshuar më 11
qershor të vitit 2010 (Amendamentet e
Kampalas)

Krijimi i një gjykate penale të
përhershme ndërkombëtare me
juridiksionin e gjenocidit, krimet e
luftës, krimet mbi njerëzimin dhe
krimet si rezultat i agresionit.

A doni të mësoni më shumë për marrëveshjet dhe instrumentet përkatëse DHN?

Kontaktoni direkt KNKK-në apo konsultojeni faqen për marrëveshjet dhe Të Drejtën Zakonore të KNKK-së: <https://www.icrc.org/in/war-and-law/treaties-customary-law>.

Jeni të interesuar nëse vendi juaj ka nënshkruar ndonjë marrëveshje?

Kontaktoni vendin nënshkrues apo KNKK, ose konsultojeni bazën e të dhënave për ndonjë marrëveshje (<https://www.icrc.org/ihl>).

Çfarë është DHN-ja zakonore?

DHN-ja zhvillohet nga ana e vendeve përmes marrëveshjeve dhe të drejtës zakonore. E Drejta zakonore formohet kur praktikët e vendeve në mënyrë të mjaftueshme janë të shpërndara, të shpeshta, reprezentuese dhe të uniformuara, dhe janë të shoqëruara me besimin e vendeve se janë të obliguara juridikisht të veprojnë sipas tyre – apo të ndalohet ndonjë veprim – në mënyra të caktuara. Zakoni është i detyrueshëm për të gjitha vendet përveç për ato që me këmbëngulje refuzojnë ndonjë praktikë apo rregull që nga hyrja e tij në fuqi.

Lidhjet midis së drejtës së marrëveshjeve dhe asaj zakonore janë të shumta dhe komplekse. Shumë dispozita të marrëveshjeve të përmendura më lart janë njohur se rrjedhin nga sfera e së drejtës zakonore, dhe shumica e dispozitave që përfaqësojnë një zhvillim të ri me rastin e miratimit të tyre si dispozita të marrëveshjes me kalimin e kohës marrin vlera zakonore. Përveç kësaj, shumë dispozita të marrëveshjeve që fillimisht është dashur të aplikohen vetëm në konfliktet e armatosura ndërkombëtare, tani konsiderohet se mund të aplikohen në të gjitha llojet e konflikteve të armatosura nëpërmjet të drejtës zakonore.

Jeni të interesuar për të dëgjuar diçka më shumë?

Në vitin 1995, KNKK filloi një studim të hollësishëm të rregullave zakonore të DHN-së. Studimin, i cili u zbatua 10 vjet, mund ta konsultoni në faqen e internetit të KNKK-së: <https://www.icrc.org/customary-ihl>.

Çfarë janë trazirat dhe tensionet e brendshme?

Trazirat dhe tensionet e brendshme (si p.sh., çrregullimet dhe aktet e izoluara dhe sporadike të dhunës) përfaqësojnë prishjen e rendit publik pa rezultuar me një konflikt të armatosur; ato nuk mund të konsiderohen si konflikte të armatosura për shkak se niveli i dhunës nuk është mjaftueshëm i madh ose për shkak se individët që përdorin dhunë nuk janë të organizuar si një grup i armatosur.

Kur zbatohet DHN-ja?

DHN-ja zbatohet në situata të një konflikti të armatosur. Ajo ofron 2 sisteme të mbrojtjes: njërin për konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe tjetrin për konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare. Rregullat që zbatohen në një situatë të caktuar varen nga klasifikimi i konfliktit të armatosur. DHN-ja nuk zbatohet në situata të dhunës që nuk kanë vëllimin e një konflikti të armatosur; këto janë trazira dhe tensione të brendshme të përkohshme dhe i nënshtrohen Ligjit për të Drejtat e Njeriut dhe legjislacionit nacional.

Konfliktet e armatosura ndërkombëtare (KAN), janë ato konflikte në të cilat një apo më shumë shtete përdorin forcën e armatosur ndaj një shteti apo ndaj shteteve tjera. Rregullat që zbatohen në konflikte të armatosur ndërkombëtare gjithashtu zbatohet gjatë një:

- Konflikt i armatosur ndërmjet një apo më shumë shteteve dhe organizata ndërkombëtare (shembull: forca shumëkombëshe);
- Lufta për çlirim nacional (nën kushte të caktuara); dhe
- Okupimi.

Konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare (KAJN) janë konflikte që ndodhin në një territor të caktuar të një vendi, ndërmjet forcave të armatosura qeveritare apo ndërmjet një ose më shumë grupeve të armatosura shtetërore, ose ndërmjet vetë këtyre grupeve. Shumë konflikte të armatosura sot janë jo-ndërkombëtare për nga natyra e tyre. Që armiqësia të konsiderohet si një KAJN, duhet të arrijë një nivel të caktuar intensiteti dhe të ekzistojë një nivel i kënaqshëm i organizimit tek grupet e përfshira.

Cila e drejtë zbatohet?

Rregullat që zbatohen në një konflikt të caktuar varet nga ajo nëse konflikti është ndërkombëtar ose jo-ndërkombëtar. Konfliktet e armatosura ndërkombëtare u nënshtrohen një spektri të gjerë rregullash, përfshirë edhe ato që nuk janë përcaktuar në katër Konventat e Gjenevës dhe Protokolli Shtesë I. Nga një komplet i kufizuar rregullat zbatohet në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare. Ato janë

përcaktuar në **Nenin 3** i cili është i përbashkët në të katër (4) Konventat e Gjenevës dhe në **Protokollin Shtesë II**.

- **Neni i përbashkët 3** zbatohet në “Konflikte të armatosura të cilat janë të karakterit jo-ndërkombëtar dhe që paraqiten në territorin e njëres nga palët në konflikt” (shih neni i përbashkët 3, alineja 1 e Konventave të Gjenevës). Këtu mendohet në konfliktet e armatosura ku janë përfshirë një ose më shumë grupe të armatosura të organizuara shtetërore. KAJN-të mund të rezultojnë ndërmjet forcave të armatosura shtetërore dhe grupeve të armatosura të organizuara jo-shtetërore ose vetëm ndërmjet këtyre grupeve.

Protokolli Shtesë II

Zbatohet në konflikte të armatosura “që ndodhin në territorin e Palës së Lartë Kontraktuese midis forcave të saj të armatosura dhe forcave të armatosura rebele ose grupeve të tjera të armatosura të organizuara, të cilat nën një komandë të përgjegjshme kanë një kontroll të tillë mbi një pjesë të territorit të saj që u lejon atyre të kryejnë operacione të pandërprera dhe të synuara ushtarake dhe të zbatojnë këtë protokoll”. (Shih Neni 1, alineja 1 e Protokollit Shtesë II). Definicioni i një konflikti të armatosur jo-ndërkombëtar ngushtohet në Protokollin Shtesë II, se sa në Nenin 3 të përbashkët. Për më shumë informacione, shihni “cili dhe si e mbron DHN-ja?”.

Zbrazëtira që paraqitet në mesin e rregullave që mbështeten në marrëveshje të aplikueshme në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe ato që zbatohen tek konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare gradualisht plotësohet me të drejtën zakonore, e cila përgjithësisht zbatohet në të gjitha llojet e forcave të armatosura. Marrëveshjet që kanë të bëjnë me armët gjithashtu zbatohen, pa marrë parasysh llojin e konfliktit të armatosur.

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë të Konventave të Gjenevës

Në hartën poshtë janë paraqitur vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe të Protokolleve Shtesë të Konventave të Gjenevës, deri në 31 dhjetor të vitit 2015. Gjithashtu në këtë hartë është paraqitur se cilat vende kanë dhënë deklaratë zyrtare në përputhje me Nenin 90 të Protokollit Shtesë I, me çka njihet kompetenca e Komisionit Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve.

Shënim. Emrat e vendeve të paraqitura në këtë hartë mund të dallojnë nga emrat zyrtarë të vendeve.

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949: **196**.

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokollit Shtesë I i vitit 1977: **174**.

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokollit Shtesë II i vitit 1977: **168**.

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I dhe II i vitit 1977: **168**.

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë III i vitit 2005: **72**.

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I dhe II i vitit 1977 dhe Protokolli Shtesë III i vitit 2005: **68**.


Vendet që kanë dhënë deklaratë në përputhje me Nenin 90 të Protokollit Shtesë I të vitit 1977: **76**.

Burimi: Raporti vjetor i KNKK për vitin 2015.

Listën e fundit të vendeve nënshkruese mund ta gjeni në <https://www.icrc.org/ihl>.


Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve Shtesë të Konventave të Gjenevës

Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949	196
Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I i vitit 1977	174
Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë II i vitit 1977	168
Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I dhe II i vitit 1977	168
Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë III i vitit 2005	72
Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I dhe II i vitit 1977 dhe Protokolli Shtesë III i vitit 2005	68
Vendet që kanë dhënë deklaratë në përputhje me Nenin 90 të Protokollit Shtesë I të vitit 1977	76



Protokollet shtesë të Konventave të Gjenevës

	Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949		Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I dhe II i vitit 1977		Vendet që kanë dhënë deklaratë në përputhje me Nenin 90 të Protokolli Shtesë I të vitit 1977
	Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I i vitit 1977		Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë III i vitit 2005		
	Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë III i vitit 2005		Vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolli Shtesë I dhe II i vitit 1977 dhe Protokolli Shtesë III i vitit 2005		



- | | | | | | | | | | | | |
|---|-------------|---|---------------|---|-----------|---|---------------------|----|-----------|----|-----------|
| 1 | Holanda | 3 | Zvicra | 5 | Sllovenia | 7 | Bosna e Hercegovina | 9 | Mali i Zi | 11 | Palestina |
| 2 | Luksemburgu | 4 | Lihtenshtajni | 6 | Kroacia | 8 | Serbia | 10 | Maqedonia | | |

Klasifikimi i llojeve të konflikteve nuk u lihet palëve në konflikt por varet nga faktorët objektivë; nuk është e nevojshme shpallja formale e luftës apo njohja e situatës. Ekzistimi i një konflikti të armatosur – dhe me këtë edhe zbatimi i DHN-së – varet nga *çfarë ndodh në terren*. Me përjashtim të disa rregullave të cilat tanimë janë zbatuar në kushte të pages, DHN-ja fillon të zbatohet me vetë paraqitjen e konfliktit të armatosur. Tek **konflikti i armatosur ndërkombëtar**, kjo do të thotë në momentin kur personi i parë i mbrojtur do preket nga konflikti, segmenti i parë i okupimit të territorit ose fillimi i sulmit të parë. Tek **konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare**, kjo do të thotë kur do të arrihet niveli i domosdoshëm i dhunës dhe organizimi i palëve në konflikt.

Neni 3 (4) i përbashkët i Konventave të Gjenevës qartë thekson se zbatimi i nenit 3 “nuk do të ndikojë në **statusin juridik të palëve në konflikt**”. Së këtijmi, zbatimi i DHN-së të konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare asnjëherë nuk e ndërkombëtarizon konfliktin ose nuk jep asnjë status për një palë të caktuar në konflikt (përveç gjendjes juridike ndërkombëtare që është e domosdoshme për të pasur të drejta dhe detyrime në përputhje me DHN-në).

Mirëpo, klasifikimi nëse një konflikt është ndërkombëtar ose jo-ndërkombëtar përfaqëson një sfidë të madhe. Viteve të fundit, po ndodhin situata kur zhvillohen njëkohësisht konflikte të armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare dhe në një territor të njëjtë. Numri i palëve dhe marrëdhëniet e tyre në konflikt janë një karakteristikë e rëndësishme e konflikteve të armatosura moderne. Nga ana e shtetit, numri i intervenimeve të jashtme në konfliktet e armatosura kontribuon për rritjen e faktorëve të përfshirë. Në rastin e faktorëve jo-shtetërorë, ndodh që të ketë prani të një numri të madh grupesh të ndryshme të armatosura, numri i të cilave rritet apo ulet.

Në shumë situata, intervenon vendi i tretë dhe/apo organizatat ndërkombëtare, dhe nganjëherë edhe vetë ato bëhen palë të konfliktit. Çështjet lidhur me klasifikimin shpeshherë paraqiten kur ka mungesë të informacioneve të sakta për natyrën e angazhimit të palëve të treta dhe kur palët e treta nuk pranojnë fare pjesëmarrjen e tyre në armiqësitë. Në raste të tilla ndryshimi i të drejtës varet nga natyra e marrëdhënieve të palëve në konflikt.

Si mund të përputhen forcat e armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare

Imagjinoni një situatë në të cilën:

- Shteti A është përfshirë në një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar (KAJN), me një grup të armatosur jo-shtetëror;
- Shteti B përfshihet në konflikt përmes kryerjes së veprave armiqësore në anën e grupit të armatosur jo-shtetëror;

Shteti A dhe grupi i armatosur jo-shtetëror megjithatë janë përfshirë në KAJN.

Vendet A dhe B tani janë përfshirë në konflikt të armatosur ndërkombëtar (KAN).


Situata thellohet dhe:

- Shteti C përfshihet në konflikt në anën e Shtetit A.

Shteti A dhe grupi i armatosur jo-shtetëror akoma janë të përfshirë në KAJN.

Shteti C dhe grupi i armatosur jo-shtetëror tani janë përfshirë në KAJN.

Vendet B dhe C tani janë përfshirë në KAN nëse ndodhin konfrontime ushtarake ndërmjet tyre.



Kë dhe si e mbron DHN-ja?

DHN-ja mbron një kategori të caktuar njerëzish nga efektet e armiqësive. Këtu janë përfshirë njerëzit që nuk janë pjesë apo që tanimë nuk janë pjesë e armiqësive, si për shembull:

- Të plagosurit, të sëmurët dhe ata që kanë pësuar një fundosje të anijes, pa marrë parasysh nëse janë të shërbimit ushtarak apo janë civilë;
- Personeli mjekësor apo fetar, pa marrë parasysh nëse janë të shërbimit ushtarak apo janë civilë;
- Personat e paraburgosur në lidhje me konfliktin e armatosur, përfshirë edhe të burgosurit e luftës; dhe
- Civilët.

Palët në konflikt detyrimisht duhet të respektojnë jetën e njerëzve, dinjitetin e tyre dhe integritetin mental dhe fizik, dhe t'u sigurojnë ndihmë materiale dhe t'i trajtojnë në mënyrë humane dhe pa diskriminim në të gjitha rrethanat. Kjo do të thotë:

- Ndalohet vrasja apo plagosja e armikut i cili është dorëzuar apo që nuk mund të mbrohet;
- Të plagosurit dhe të sëmurët duhet të grumbullohen dhe të tregohet kujdes për ta.
- Civilët nuk duhet të sulmohen qëllimisht;
- Patjetër të sigurohet qasja e civilëve për te ndihma humanitare; dhe
- Të burgosurit dhe personat e paraburgosur detyrimisht duhet të marrin ushqim, strehim dhe kujdes mjekësor përkatës dhe të jenë në gjendje për të këmbyer porosi me familjet e tyre, për ta patjetër duhet gjithashtu të sigurohet një siguri procedurale dhe garanci gjyqësore.

Pjesëmarrja direkt në armiqësitë.

Përfshirja e vetëm në lidhje me ndalesën për të sulmuar qëllimisht civilët ka të bëjë me rastet kur civilët marrin pjesë direkt në armiqësitë, si për shembull kur marrin armët për të luftuar me armikun. Në raste të tilla, ata mund të jenë objektiv i sulmeve, jo vetëm deri atëherë derisa marrin pjesë direkt në armiqësitë. Me qëllim që të përmbushet kushti për pjesëmarrës direkt në armiqësitë, akti duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

1. Akti duhet të arrijnë një **prag të caktuar të dëmit të shkaktuar**. Ky është rasti kur akti me gjasë do të ketë ndikim të pavorshëm në operacionet ushtarake apo në kapacitetin ushtarak të palës armiqësore. Gjithashtu mund të jetë në rastin kur akti me gjasë mund të shkaktojë lëndimin dhe vrasjen e civilëve apo të nxjerrë jashtë veprimit luftëtarët nga beteja (hors de combat) apo të rezultojë me shkatërrimin e objekteve civile.
2. Duhet të ekzistojnë një **lidhje shkakësore të drejtpërdrejtë** ndërmjet aktit/veprës dhe dëmit, që me gjasë do të jetë rezultat i asaj vepre apo i një operacioni të koordinuar ushtarak në kuadër të së cilit është ky akt.
3. Duhet të ekzistojë një **lidhje armiqësore**. Kjo do të thotë se akti duhet të jetë posaçërisht i orientuar drejt realizimit direkt të pragut/shkallës së nevojshme të dëmit si mbështetje për palën armiqësore apo për të dëmtuar palën tjetër.

Të plagosurit, të sëmurët dhe ata që kanë pësuar fundosje të anijes

DHN-ja përcakton trajtimin e mëposhtëm të të plagosurve, të sëmurëve dhe atyre që kanë pësuar fundosje të anijes, pa marrë parasysh nëse janë civilë apo të radhëve të shërbimit ushtarak:

- Ata duhet të trajtohen në mënyrë humane. Prandaj, është rreptësisht e ndaluar të vriten, të shkatërrohen apo t'i nënshtrohen një trajtimi jo human apo degradues, siç janë tortura apo eksperimentet mjekësore.
- Ata duhet të mbrohen nga rreziku dhe kërcënimet, veçanërisht nga reprezaljet, plaçkitjet, hakmarrja apo maltretimi.
- Ata duhet të kontrollohen dhe të mblidhen pa asnjë vonesë për t'i mbrojtur nga efektet e armiqësive.

- Ata duhet të marrin kujdesin e nevojshëm mjekësor sa të jetë e mundur më shpejtë. Kujdesi parësor duhet të sigurohet vetëm në bazë të nevojës mjekësore dhe askush nuk duhet të diskriminohet për shkak të arsyeve siç janë lojaliteti, përkatësia nacionale, gjinia, raca apo religjioni.

Përveç obligimit për sigurimin e kujdesit mjekësor për të plagosurit, të sëmurët dhe për ata që kanë pësuar fundosje të anijes, vendet nënshkruese të Konventave të Gjenevës detyrimisht duhet:

- T'u mundësojnë civilëve dhe njësive mjekësore ushtarake për të kryer punën e tyre në situatat e konfliktit;
- Të përmbahen nga sulmimi i njësive mjekësore për të qenë në gjendje ata të veprojnë në zonat e konfliktit (personeli mjekësor duhet të konsiderohet neutral);
- Të ndërmerren hapa të ngjashëm për të mbrojtur automjetet e ambulancës dhe spitalet, të cilat mund të identifikohen me emblemën e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe apo Kristalit të kuq.
- Të caktojnë prej më parë cilat anije do të përdoren si anije spitalore gjatë kohës së luftës, për arsye se është vështirë për t'u furnizuar dhe pajisur me anije të tilla pasi të ketë shpërthyer konflikti; dhe
- Të ndërmarrin masat e njëjta për avionët mjekësorë.

Njerëzit e paraburgosur apo të internuar në lidhje me një konflikt të armatosur

Përveç mbrojtjes së përgjithshme që duhet ta sigurojë DHN-ja për njerëzit të cilët nuk janë pjesë apo që tanimë nuk janë të përfshirë në armiqësitë, gjithashtu veçanërisht janë të mbrojtur njerëzit që janë të privuar nga liria e tyre. Dy format kryesore të paraburgimit afatgjatë në konflikte të armatosura me internim (paraburgim administrativ për arsye sigurie) dhe paraburgim (për shkak të ndjekjes penale).

Të burgosurit e luftës në konfliktet e armatosura ndërkombëtare

Të burgosurit e luftës zakonisht janë anëtarët e forcave të armatosura të njërës nga palët në konflikt të cilët janë të zënë robër nga armiku. Konventa e Tretë e Gjenevës gjithashtu përmend kategori të tjera njerëzish që kanë të drejtën e statusit për të burgosurit e luftës apo të trajtimit për të burgosurit e luftës, si anëtarët e milicëve dhe trupave vullnetare që janë pjesë e forcave të armatosura apo lëvizje të rezistencës. Nuk ekziston një status i të burgosurit të luftës në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare. Mirëpo, palët në një konflikt të tillë në mënyrë të përbashkët mund të vendosin në mënyrë analoge për të zbatuar rregullat që zbatohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare.

DHN-ja jep të drejta dhe mbrojtje të veçantë për të burgosurit e luftës. Ata duhet të trajtohen në mënyrë humane në të gjitha rrethanat dhe të mbrohen nga të gjitha aktet e dhunës, frikësimit, fyerjeve apo poshtërimit publik. Ata kanë të drejtën për të respektuar jetën e tyre, dinjitetin, të drejtat personale dhe bindjet politike, fetare dhe bindjet e tjera. DHN-ja gjithashtu përcakton kushtet minimale në lidhje me paraburgimin, duke përfshirë çështjet siç janë akomodimi, ushqimi, veshmbathja,

higjiena dhe kujdesi mjekësor. Të burgosurit e luftës kanë të drejtën të shkëmbejnë lajme me familjet e tyre.

Palët në konflikt duhet të lirojnë të gjithë të burgosurit e luftës pa asnjë prolongim pas përfundimit të armiqësive aktive përveç nëse nuk marrin vendim për t'i paditur dhe paraburgosur në bazë të krimeve të kryera të luftës apo shkelje të tjera të DHN-së. Mirëpo, në raste të tilla, për të burgosurit detyrimisht duhet të sigurohet një gjykim i drejtë dhe nuk mund të jepet aktgjykim jo human në qoftë se shpallen fajtorë.

Personat e internuar civilë në konfliktet e armatosura ndërkombëtare

Pala në konflikt mund të internojë civilë për shkak të arsyeve të sigurisë por duhet detyrimisht t'i lirojë ata menjëherë kur këto arsye tanimë nuk do të ekzistojnë.

Personat e internuar civilë duhet të jenë të informuar për arsyet për të cilat janë internuar dhe duhet që internimi i tyre të rishikohet pa asnjë prolongim nga ana e gjykatës apo trupit administrativ. Nëse internimi vazhdohet, personi i internuar ka të drejtë në rishikimin e këtij vendimi të paktën 2 herë në vit.

Rregullat që kanë të bëjnë me trajtimin e personave të internuar civilë janë shumë të ngjashme me rregullat që zbatohet me të burgosurit e luftës. Disa nga kushtet janë më të volitshme, si për shembull kur bëhet fjalë për bashkimin e anëtarëve të ndarë të familjes.

Njerëzit e privuar nga liria në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare

Njerëzit që janë privuar nga liria në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare duhet të trajtohen në mënyrë humane dhe pa diskriminim në çdo rrethanë. Statusi i tyre udhëhiqet sipas nenit 3 i përbashkët tek Katër Konventat e Gjenevës dhe nenet 4, 5 dhe 6 të Protokollit Shtesë II. Mbrojtja e cila sigurohet në Protokollin Shtesë II zbatohet tek njerëzit e internuar apo të paraburgosur për arsye të lidhura me konfliktin e armatosur, si dhe tek njerëzit që përballen me akuza për shkak të shkeljeve penale në lidhje me konfliktin e armatosur.

Këto rregulla, edhe pse janë me më pak hollësi dhe janë më pak të qarta se sa rregullat që i mbrojnë të burgosurit e armatosur dhe personat e internuar civilë në konfliktet e armatosur ndërkombëtare, megjithatë janë të obligueshme për të gjitha vendet dhe grupet e armatosura jo-shtetërore.

Mbrojtja e përgjithshme e civilëve

Në përputhje me DHN-në, palët në konflikt duhet të bëjnë përpjekje për të mbrojtur popullsinë civile dhe objektet civile dhe ato asnjëherë nuk duhet të jenë objektivi i tyre. Mirëpo, veçanërisht në konfliktet e armatosura moderne, civilët gjithnjë e më shpesh objekt dhe qëllim i lufta të armatosura.

Tek konfliktet moderne jo rrallë viktimat civile janë më të mëdha në numër se sa viktimat e luftës. Për të qenë situata edhe më e rëndë, kontrolli mbi popullsinë

shpeshherë është një nga çështjet kryesore kritike në konfrontimet, dhe civilët nganjëherë bëhen objektiv direkt. Situata e tillë paraqitet si rezultat i faktorëve të shumtë ndër të cilat është rritje e mos tolerancës fetare dhe etnike, mos funksionimi i strukturave shtetërore, lufta për kontroll mbi resurset natyrore, të qenit e armëve në dispozicion të gjerë, përhapja e terrorizmit, dhe numri gjithnjë e më i madh i konflikteve asimetrike (konflikte ku palët kanë kapacitete jo të barabarta ushtarake).

Mbrojtja e pamjaftueshme e civilëve në konfliktet e armatosura shpeshherë del nga mosrespektimi i DHN-së nga palët e konfliktit, dhe jo për shkak të thënies së paplotë të rregullave të DHN-së.

Mbrojtja e civilëve, në kuptim të gjerë, do të thotë sigurim që pushtetet dhe grupet e armatosura detyrimet e tyre në përputhje me DHN-në dhe ligjet e të drejtave të njeriut. Konventa e Katërt e Gjenevës dhe Protokolli Shtesë i vitit 1977, i kushtojnë vëmendje të veçantë civilëve që janë të lëndueshëm jo vetëm si rezultat i operacioneve ushtarake, por gjithashtu për shkak të keqpërdorimit të fuqisë dhe krimeve të tjera. Në këtë kuadër, DHN-ja garanton të drejtat themelore për çdo individ.

Mbrojtja e veçantë për civilët

Qytetarët e një vendi pjesëmarrës në konflikt të gjetur në territorin e armikut

Për njerëzit në situatë të tillë duhet të lejohet të kthehen në vendin e tyre përveç nëse në këtë mënyrë rrezikohet siguria apo ekonomia e vendit. Nëse ata vendosin për të mos u kthyer prapa apo nëse nuk u është dhënë e drejta për t'u kthyer në vendin e tyre, ata duhet të trajtohen si të huaj në kushte të paqes. Ata mund të internohen apo të lihen në paraburgim shtëpiak nëse është e domosdoshme, por duhet t'u jepet mundësi për të paraqitur ankesë për shkak të masave të tilla.

Civilët që jetojnë nën okupim të armatosur

Civilët që jetojnë nën okupim janë të mbuluar me rregulla të veçanta që kanë për qëllim të mbrojnë ata nga keqpërdorimet nga ana e forcave të okupatorit dhe për të mbajtur situatën në territorin e okupuar siç ishte në kohën në kohën e pushtimit. DHN-ja ka tendencë për të mbrojtur situatën status kuo, për shkak se sipas të drejtës ndërkombëtare, okupimi i armatosur konsiderohet të jetë një kohë e situatës. Në situata të tilla, për civilët jepen disa të drejta të caktuara dhe nuk mund të dënohen për shkak të statusit të tyre. Për këtë arsye, për shembull, është e ndaluar përndjekja e banorëve të territorit të okupuar apo të barten nga një pjesë e territorit në një tjetër. Forcat e okupatorit nuk duhet të vendosë qytetarët e saj në territorin e okupuar, as që duhet në mënyrë fizike të ndryshojë territorin duke shkatërruar shtëpitë apo infrastrukturën (përveç në qoftë se nuk ekzistojnë arsye ushtarake për të bërë këtë).

Gratë dhe fëmijët

Gratë dhe fëmijët janë veçanërisht të lëndueshëm në situatat e konflikteve të armatosura, dhe rregullat që kanë të bëjnë me trajtimin e tyre janë dizajnuar për të përfshirë nevojat e tyre specifike.

Fëmijët duhet të marrin kujdesin dhe vëmendjen e nevojshme. Për palët në konfliktin e armatosur, kjo do të thotë:

- Të sigurohet që fëmijët nën moshën 15-vjeçare të mos marrin pjesë direkt në armiqësitë;
- Nëse fëmijët mbesin pa prindër apo nëse janë ndarë nga familjet e tyre si rezultat i konfliktit të armatosur, atyre duhet t'u sigurohet një kujdes përkatës;
- Të sigurohet që fëmijët të mos mbesin të varur vetëm nga resurset e tyre, dhe të jenë në gjendje për të gëzuar në mënyrë të lirë lirinë e tyre fetare dhe për të vazhduar arsimin e tyre;
- Kur fëmijët duhet të burgosen, duhet të ruhen veças nga të rriturit (përveç në qoftë se janë së bashku me familjet e tyre);
- Të përmbahen nga zbatimi i dënimit me vdekje të çdo personi që është nën moshën 18-vjeç në kohën e sulmit.
- Nëse fëmijët evakuohen në një vend të huaj, të ndihmohet kthimi i tyre në vendin dhe familjet e tyre.

Për më shumë informacione, shihni kapitullin "Fëmijët" në pjesë 3.

Palët në konfliktin e armatosur gjithashtu duhet të kenë kujdes për kërkesat specifike të grave në lidhje me mbrojtjen, shëndetin dhe ndihmën e tyre. Për gratë shtatzëna dhe nënat e reja duhet të kushtohet një vëmendje e veçantë dhe gratë duhet të jenë të mbrojtura nga dhuna seksuale.

Gratë e burgosura duhet të jenë nën supervizion të drejtpërdrejtë nga një grua tjetër. Nëse burgosen gra shtatzëna dhe nëna të fëmijëve minoren në lidhje me konfliktin e armatosur, për rastet e tyre duhet të jepet përparësi dhe ata nuk duhet të dënohen me dënim me vdekje.

Garancitë themelore për çdo person të prekur nga konflikti i armatosur

Praktikat e mëposhtme janë të ndaluar në çdo rast:

- Veprat e dhunshme që kanë për qëllim të dëmtojnë jetën, shëndetin apo mirëqenien fizike ose mentale të personave, sidomos vrasjet, tortura, dënimi me vdekje dhe sakatimi;
- Krimet ndaj dinjitetit personal, sidomos trajtimi poshtërues apo degradues, përdhunimi, prostitucioni i dhunshëm dhe çdo formë e sulmit/ngacimit të pahijshëm;
- Marrja e pengjeve;
- Dënimi kolektiv;

- Kërcënimet për kryerjen e çdo vepre të sipërpërmendur.

Këto garanci themelore janë mbështetur nga garancitë gjyqësore që zbatohen në procedura penale, dhe mbrojtje procedurale që i mbrojnë të drejtat e njerëzve në çdo rrethanë, si për shembull internimi apo paraburgimi administrativ.

Garancitë gjyqësore dhe mbrojtja procedurale

Garancitë gjyqësore dhe mbrojtja procedurale të përcaktuara në DHN, janë një komplet rregullash të dizajnuara për të siguruar që individët në pushtet të palës në konflikt të marrin një gjykim korrekt dhe të mos jenë të privuar në mënyrë joligjore apo në mënyrë arbitrare nga të drejtat dhe liritë themelore njerëzore.

Këto rregulla janë të përcaktuara në Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë I dhe II, dhe zbatohen në konflikte të armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare. Ato janë normat minimale që në asnjë rast nuk pengojnë një trajtim më të volitshëm.

Këto rregulla zbatohen në çdo kohë dhe në çdo vend të shteteve nënshkruese të Konventave të Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë. Vendet duhet të sigurojnë që detyrimet e tyre në përputhje me këto instrumente janë inkorporuar në legjislacionin e tyre nacional, për shembull në kodin penal dhe rregullat procedurale dhe/ose në kushtetutën e tyre.

Nuk duhet të ketë asnjë përjashtim nga këto rregulla, edhe në rastet kur siguria shtetërore dhe domosdoshmëria ushtarake duket se kërkojnë atë. Mos përmbushja e garancive gjyqësore dhe procedurale, në shumicën e rasteve paraqet shkelje të rëndë të DHN-së.

Garancitë kryesore gjyqësore janë si vijon:

- Parimi i përgjegjësisë penale individuale;
- Parimi i mosekzistimit të veprës penale dhe mosekzistimit të dënimit pa zbatimin e ligjit;
- Parimi i mosekzistimit të rrezikut të dyfishtë (të gjykohet një person më shumë se një herë për të njëjtën vepër);
- E drejta e të pandehurit për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme dhe pa prolongime të panevojshme;
- E drejta e të pandehurit për të qenë i informuar për natyrën dhe arsyen e veprës së pretenduar;
- Të drejtat dhe mjetet e mbrojtjes, për shembull e drejta për të zgjedhur një avokat të lirë të kualifikuar;
- E drejta e ndihmës falas juridike;
- E drejta e të pandehurit për ndihmë nga interpretuesi;
- E drejta e të pandehurit për të komunikuar lirshëm me përfaqësuesin juridik;
- E drejta e të pandehurit për kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij/të saj;

- E drejta e të pandehurit për të marrë në pyetje dëshmitarët;
- Prezumimi i pafajësisë;
- E drejta e të pandehurit për të qenë i pranishëm në gjykimin e tij/të saj;
- E drejta e të pandehurit për të mos dëshmuar kundër vetes apo për të pranuar fajin;
- E drejta e të pandehurit për të shpallur publikisht aktgjykimin;
- E drejta e të pandehurit për të qenë i informuar për të drejtën e ankesës.

Mbrojtja procedurale përfshin:

- E drejta për informacion për arsyet e internimit/paraburgimit administrativ;
- E drejta për të regjistruar dhe mbajtur në një vend të njohur të internimit/paraburgimit administrativ;
- Shqyrtimi i ligjshmërisë së internimit/paraburgimit administrativ i zbatuar nga një trup i pavarur dhe i paanshëm;
- E drejta e shqyrtimit periodik të ligjshmërisë së paraburgimit të vazhduar;
- E drejta e kujdesit dhe vëmendjes mjekësore në përputhje me kërkesat shëndetësore të personit të internuar/të paraburgosurit administrativ.

Cilat vende dhe objekte janë mbrojtur me DHN dhe si?

Disa vende dhe objekte, si për shembull spitalet, automjetet e ambulancës dhe objektet e trashëgimisë kulturore (ndër të cilat janë vendet religjioze të adhurimit, veprat artistike dhe përmendoret historike), janë të mbrojtura me DHN dhe nuk duhet të sulmohen. DHN gjithashtu ndalon sulmin apo shkatërrimin e objekteve që janë me rëndësi thelbësore për mbijetimin e popullsisë civile (shembull, instalimet për ushqim dhe ujë të pijshëm) dhe objektet e rrezikshme (pendët dhe centralet nukleare).

DHN-ja përcakton disa “emblema mbrojtëse” qartë të njohura – si për shembull, Kryqi i kuq, Gjysmëhëna e kuqe dhe Kristali i kuq – që përdoren për identifikimin e personave dhe objekteve të mbrojtura.

Njësitë mjekësore dhe transportet

Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë përmbajnë edhe detyrimin e vendeve në lidhje me respektimin dhe mbrojtjen e kapaciteteve mjekësore, personelit dhe transportit të natyrës mjekësore në çdo rrethanë. Këto mbrojtje janë të domosdoshme për të siguruar të plagosurit dhe të sëmurët për të qenë në gjendje të marrin kujdesin e duhur mjekësor. Objektet mjekësore, personeli dhe mjetet e transportit mund të identifikohen me emblemën e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe apo Kristalit të kuq. Ato nuk duhet të sulmohen, përveç nëse përdoren për të kryer vepra armiqësore ndaj palës kundërshtare dhe pas paralajmërimit të dhënë.



Trashëgimia kulturore

Trashëgimia kulturore ka të bëjë me vendet dhe objektet kushtuar religjionit, artit, shkencës apo arsimit dhe përfshin gjithashtu përmendoret historike dhe arkitektonike. Shkatërrimi i trashëgimisë kulturore mund të interpretohet si përpjekje për të shkatërruar identitetin kulturore të gjithë shoqërisë. Përpjekjet për të mbrojtur trashëgiminë kulturore të popullsisë, dhe së këtijmi edhe promovimi i respektimit të dinjitetit të popullsisë, përfaqëson pjesë integrale të operacionit humanitar që ka për qëllim të mbrojë atë popullsi. Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Rast të një Konflikti të Armatosur i vitit 1954, së bashku me Protokollet e saja, u miratua për të mbrojtur të mirat kulturore që mund të identifikohen me emblema të përcaktuar nga kjo konventë, dhe kjo është shenja e bardhë-e kaltër për një përmendore të kulturës.



Mjedisi jetësor

Konflikti i armatosur mund të shkaktojë dëme të mëdha, afatgjate dhe serioze në mjedisin jetësor, si rezultat edhe i përdorimit të armëve të caktuara. DHN-ja tenton të mbrojë mjedisin jetësor nga dëmet e tilla.

Ndërtimet dhe instalimet që përmbajnë forca të rrezikshme

Ndërtimet dhe instalimet që përmbajnë forca të rrezikshme nënkuptojnë struktura të tilla si pendët, digat dhe centralet nukleare. Edhe nëse ato ri caktohen për qëllime ushtarake, ato nuk duhet të sulmohen për shkak se mund të lirojnë fuqi të rrezikshme dhe të shkaktojnë humbje të konsiderueshme për popullsinë civile. Ndërtimet dhe centralet që përmbajnë fuqi të rrezikshme mund të identifikohen me një simbol të përbërë nga 3 rrethë të ndritshëm portokalli.



Kush është i detyruar për të respektuar DHN-në?

Palët në një konflikt të armatosur

Të gjitha palët në një konflikt të armatosur duhet në çdo kohë të respektojnë DHN-në.

Vendet

Të gjitha vendet nënshkruese të marrëveshjeve dhe instrumenteve DHN, janë të detyruara formalisht të bëjnë respektimin, pa marrë parasysh nëse vendet janë palë në konfliktin e armatosur apo nuk janë. Ato duhet të bëjnë gjithçka që është në fuqinë e tyre për të respektuar dhe për të siguruar respektimin e DHN-së.

Grupe të armatosura jo-shtetërore

Grupe të armatosura jo-shtetërore, si palë në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare, obligohet me Nenin 3, i përbashkët tek Konventat e Gjenevës dhe Protokollin Shtesë II, nëse vendi të cilit i takojnë është nënshkruese e këtyre marrëveshjeve. Sidoqoftë, këto grupe janë të obliguara me rregullat zakonore të DHN-së që zbatohen në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare.

Lëvizjet nacionale çlirimtare

Lëvizjet nacionale çlirimtare që luftojnë kundër dominimit kolonial, okupimit të huaj, apo regjimit racist, në praktikimin e të drejtës për vetëvendosje, mund të marrin zbatimin e Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I nëpërmjet paraqitjes së një deklarate të njëanshme te depozitari i këtyre marrëveshjeve (Këshilli Federal Zviceran).

Operacionet e sigurisë kolektive

Forcat multilaterale të formuara nga ana e Kombeve të Bashkuara apo organizatave të tjera ndërkombëtare, janë të detyruara për të respektuar DHN-në që nga momenti i përdorimit të forcës kundër forcave të armatosura të vendit (në një konflikt të armatosur ndërkombëtar), ose të grupeve të armatosura jo-shtetërore (në një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar).

Individët

DHN-ja zbatohet ndaj secilit gjatë kohës së konfliktit – ndaj luftëtarëve dhe civilëve. Individët që nuk do të respektojnë DHN-në mund të përgjigjen penalisht nën rrethanat e caktuara. Një numër i caktuar i gjykatave nacionale dhe ndërkombëtare tanimë kanë njohur obligimin për të përndjekur individët që nuk kanë respektuar DHN-në.

Si parandalohen shkeljet e DHN-së?

Implementimi i DHN-së – shndërrimi i rregullave në veprim – është hapi i parë dhe më i rëndësishëm, dhe para së gjithash është përgjegjësi e vendeve nënshkruese të Konventave të Gjenevës dhe Protokolleve të tyre Shtesë. Kjo përgjegjësi është përcaktuar në Nenin 1, i përbashkët për katër Konventat e Gjenevës, që kërkon nga vendet për të respektuar dhe për të siguruar respektimin e Konventave në të gjitha rrethanat.

Disa masa të implementimit kërkojnë nga shtetet për të miratuar disa ligje apo rregullore. Të tjerat kërkojnë nga shtetet për të zhvilluar programe arsimore për forcat e armatosura dhe për publikun, të rekrutojnë dhe/ose të aftësojnë një personel, të përgatisin letërnjoftime apo dokumente të tjera, të vendosin struktura ad-hok dhe të miratojnë procedura të planifikimit dhe administrimit. Vendet duhet të përpiqen për të parandaluar dhunën.

Masat parandaluese përfshijnë:

- Përhapjen e njohurive për DHN-në (diseminimi);
- Përkthimin e marrëveshjeve DHN në gjuhën kombëtare (gjuhët);
- Transformimin e DHN-së në legjislacionin vendor gjithnjë kur është e mundshme dhe miratimin e dispozitave ligjore dhe statutore për të siguruar respektimin e DHN-së;
- Inkorporimin e DHN-së në doracakët ushtarakë;
- Aftësimin e njerëzve që do të lehtësojnë zbatimin dhe respektimin e DHN-së, dhe emërimin e këshilltarëve juridikë në forcat e armatosura;
- Sigurimin e respektimit të emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq;
- Parandalimin e krimeve të luftës dhe dënimin e personave që i kanë bërë ato; dhe
- Vendosjen e sanksioneve efektive për shkeljet tjera të DHN-së.

Si dënohen shkeljet e DHN-së?

DHN-ja përcakton rregulla të hollësishme që kanë për qëllim të mbrojnë viktimat e konflikteve të armatosura dhe të kufizojnë mjetet dhe metodat e luftimit. Gjithashtu përcakton mekanizma që ndihmojnë respektimin e këtyre rregullave. Veçanërisht, DHN-ja thirr në përgjegjësi individët që janë përgjegjës për shkeljet e ndodhura nga ana e tyre apo shkeljet të cilat ata kanë urdhëruar për t'u kryer. DHN-ja urdhëron që personat përgjegjës për shkeljet serioze të akuzohen dhe të dënohen si kryerës të veprës penale.

Krimet e luftës

Nga vendet kërkohet të parandalojnë apo të ndërpresin të gjitha shkeljet e DHN-së. Përveç kësaj, ato i nënshtrohen detyrimeve të posaçme kur bëhet fjalë për

“shkeljet e rënda” në konfliktet e armatosura ndërkombëtare. Shkeljet e rënda përfaqësojnë një nga shkeljet më serioze të DHN-së dhe janë numëruar si vepra të veçanta në Konventat e Gjenevës dhe Protokolli Shtesë I. Këtu janë menduar veprat siç janë vrasja, tortura, sjellja jo humane dhe shkaktimi i qëllimshëm i një vuajtje të madhe apo lëndimi serioz në trupin apo shëndetin e njeriut. Shkeljet e rënda konsiderohen si krime të luftës.

Krimet e luftës gjithashtu përmbajnë edhe shkelje të tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve të luftimit, përfshirë edhe ato që paraqiten gjatë kohës së konflikteve të armatosura jo-ndërkombëtare. Lista e plotë e kodifikuar e krimeve të luftës është përcaktuar në Nenin 8 të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare.

Kryerja e hetimeve kombëtare

Shtetet kanë përgjegjësi primare për burgosjen, kryerjen e hetimit dhe dënimin e kryerësve të krimeve të luftës. Me vetë nënshkrimin e Konventave të Gjenevës ose Protokollin Shtesë I, shtetet pajtohet për të sjellë ligjet e nevojshme në shtet për të përndjekur në mënyrë gjyqësore individët për të cilët ekziston një dyshim se kanë bërë shkelje të rënda të DHN-së apo që kanë urdhëruar kryerjen e shkeljeve të tilla. Nga shtetet gjithashtu kërkohet në mënyrë gjyqësore të përndjekin këta persona në gjykatat e tyre apo, nëse duhet, t'i dorëzojnë për t'u gjykuar në një shtet tjetër, dhe penalisht të përndiqen për krime të luftës. Në të vërtetë, në përputhje me Nenin 1, i përbashkët për të 4 Konventat e Gjenevës, shtetet kanë pranuar obligimin për të respektuar dhe siguruar respektimin e rregullave të DHN-së.

Në lidhje me determinizmin e shkeljeve serioze të DHN-së si vepra penale, çdo shtet nënshkruar i të 4 Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I, ka obligim “për të sjellë një rregullore ligjore të nevojshme për sigurimin e sanksioneve ndëshkuese efektive kundër personave që kanë kryer, apo kanë urdhëruar kryerjen e çdo shkelje të rënë”¹ të këtyre instrumenteve. Regjimi për shkelje të rënda përcakton se shtetet nënshkruese duhet të kërkojnë personat për të cilët ekziston dyshimi se kanë kryer apo kanë urdhëruar kryerjen e shkeljeve të tilla të konventave dhe Protokollit Shtesë I, të definuara si “shkelje të rënda”. Nga shtetet gjithashtu kërkohet për të nxjerrë këto persona, pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre, para gjykatave të tyre ose t'i dorëzojnë për t'u gjykuar nga një vend tjetër nënshkruar i Konventave të Gjenevës.

Në bazë të së drejtës zakonore shtetet kanë për detyrë të hetojnë të gjitha krimet e luftës për të cilat pohohet se janë kryer nga ana e shtetasve të tyre ose forcave të tyre të armatosura, apo në territorin e tyre, si dhe krimet tjera të luftës mbi të cilat kanë juridiksion, dhe nëse është e përshtatshme penalisht për të ndjekur të dyshuarit.²

Përveç obligimeve specifike në lidhje me shkeljet e rënda dhe krimet tjera të luftës, çdo shtet nënshkruar i të 4 Konventave të Gjenevës detyrimisht duhet gjithashtu

¹ Neni 49, KGJI; Neni 50, KGJII; Neni 129, KGJIII; Neni 146, KGJIV; dhe Neni 85(1), PSHI.

² Shih rregullin 158 në studimin e KNKK për DHN-në zakonore: Jean-Marie Henckaerts and Louise Doswald-Beck, E Drejta Zakonore Humanitare Ndërkombëtare, Libri I: Rregulla, KNKK, Gjenevë/Cambridge University Press, Cambridge, 2005, достапно на <http://www.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/home>.

“të ndërmerr masa që janë të domosdoshme për pengimin e të gjitha veprave në kundërshtim me dispozitat e Konventave përveç shkeljeve të rënda”.³ Pengimi mund të jetë, për shembull, në formë të sanksioneve ndëshkuese apo sanksioneve disiplinore.

Shembuj të krimeve të luftës

- Vrasja e qëllimshme.
- Tortura apo sjellja poshtëruese dhe degraduese, përfshirë dhe eksperimentet biologjike.
- Shkaktimi i qëllimshëm i një vuajtje të madhe apo lëndimi serioz në trupin ose shëndetin e njeriut.
- Ekspozimi i qëllimshëm i popullsisë civile ose individët në sulm.
- Përdorimi i njerëzve si mburojë.
- Deportimi i paligjshëm ose paraburgimi i paligjshëm.
- Marrja e pengjeve.
- Heqja e qëllimshme e së drejtës së një të burgosuri të luftës apo një personi tjetër të mbrojtur për gjykim korrekt dhe të rregullt.
- Përdorimi jo i përshtatshëm i emblemës së Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe apo Kristalit të kuq, ose shenjave të tjera mbrojtëse, që rezultojnë me vdekje ose lëndim serioz të individëve.
- Plagosja dhe vrasja tinëzare e individëve që i takojnë kombit ose armatës armike.
- Plaçkitja e pasurisë publike ose private.

Juridiksioni universal

Përgjithësisht, legjislacioni penal kombëtar zbatohet vetëm në veprat penale të kryera në territorin e shtetit ose nga qytetarët e shtetit. Mirëpo, disa vepra penale – përfshirë dhe krimet e luftës – janë aq serioze në mënyrë që çdo person për të cilin ekziston dyshimi se i ka kryer ato në një konflikt të armatosur ndërkombëtar ose jo-ndërkombëtar, duhet të kërkohet dhe të përndiqet në mënyrë gjyqësore pa marrë parasysh nacionalitetin e personit ose vendin ku është kryer vepra penale.

Ky parim, i njohur si juridiksioni universal, ka rëndësi thelbësore në përpjekjet për t'i dhënë fund krimeve të luftës, dhe për të parandaluar që të kalojnë pa u ndëshkuar dhe të refuzohet një strehim i sigurt për kryerësit e supozuar. Gjithnjë e më shumë shtete e kanë harmonizuar legjislacionin nacional për të mundësuar për gjykatat e tyre të përndjekin personat që kanë kryer vepra penale ndërkombëtare – si për shembull krime të luftës të kryera në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ose jo-ndërkombëtare – në një shtet tjetër, në bazë të juridiksionit universal.

³ Neni 49, KGJI; Neni 50, KGJII; Neni 129, KGJIII; Neni 146, KGJIV; dhe Neni 85(1), PSHI.

Implementimi efektiv i detyrimeve të shteteve në përputhje me DHN-në, urdhëron posaçërisht çdo vend nënshkrues të Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I, juridiksion universal, për të përfshirë listën e shkeljeve të rënda të këtyre instrumenteve në legjislacionin e tij nacional. Ky detyrim urdhëron shtetet për të ngritur hetim dhe nëse është e arsyeshme, të nxjerrin para gjykatës individët që ngarkohen se kanë kryer ose kanë urdhëruar kryerjen e shkeljeve të rënda të DHN-së, gjithmonë kur shtetet marrin vesh se individë të tillë ka në territorin e tyre apo në vendet që janë nën juridiksionin e tij.

Instrumente të tjera ndërkombëtare kërkojnë detyrim të ngjashëm nga vendet nënshkruese për të autorizuar një formë të caktuar të juridiksionit universal në gjykatat e tyre për shkeljet serioze të rregullave që i përmbajnë këto instrumente. Këtu mendohet para së gjithash për Konventën për Mbrotjtjen e Të Mirave Kulturore në Rast të një Konflikti të Armatosur i vitit 1954 dhe Protokollin e saj të Dytë të vitit 1999, Konventën Kundër Torturës dhe Sjelljes tjetër Jonjerëzore dhe Degraduese apo Dënimit të vitit 1984 dhe Konventën Ndërkombëtare për Mbrotjtjen e të gjithë personave nga zhdukja e detyrueshme.

Përveç kësaj, praktikat shtetërore dhe *Opinio juris* (pranimi i praktikës për të krijuar një detyrim juridik) kanë ndihmuar konsolidimin e të drejtës zakonore ku shtetet mund të autorizojnë gjykatat e tyre me juridiksionin universal ndaj shkeljeve të tjera të rënda të DHN-së.⁴ Këtu nënkuptojmë, shkeljet e rënda të Nenit 3, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës dhe të Protokollit Shtesë II, si dhe krime të tjera të luftës, si ato të përmendura në Nenin 8 të Statutit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare. Në shumë raste në 20 vitet e fundit, juridiksioni universal ka siguruar një bazë për gjykatat vendore, në shtetet ku është përgatitur një legjislativë e domosdoshme ligjore, të gjykojnë individë që ngarkohen për kryerje të krimeve të luftës dhe vepra të tjera penale në konflikte të armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare.

Nga vendet kërkohet për të marrë këto veprime të posaçme për përndjekjen penale dhe dënimin e krimeve të luftës:

Hapi 1— shteti duhet të sjellë legjislacion kombëtar me të cilin ndalohen dhe dënohen shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I, ose përmes miratimit të një ligji të posaçëm ose përmes ndryshimeve të kodit penal ekzistues. Legjislacioni i tillë duhet të përfshijë të gjithë njerëzit pa marrë parasysh nacionalitetin, që kanë bërë shkelje të rëndë ose që kanë urdhëruar për t'u bërë një shkelje e rëndë dhe duhet të përfshijë shkeljet që janë rezultat i mungesës së veprimit kur sipas detyrimit ligjor duhet të bëhet kjo. Legjislacioni duhet të përfshijë veprat brenda dhe jashtë territorit të shtetit. Gjithashtu duhet të sigurojë sanksione në përputhje me seriozitetin e veprës penale.

Hapi 2 – shteti duhet të kërkojë ata persona për të cilët ekziston dyshimi se janë përgjegjës për shkelje të rënda. Ai duhet në mënyrë gjyqësore të përndjekë personat e tillë para gjykatave të veta apo të ekstradojë ata për t'u gjykuar në një

⁴ Shih studimin e KNKK për DHN-në zakonore: Jean-Marie Henckaerts and Louise Doswald-Beck, E Drejta Zakonore Humanitare Ndërkombëtare, Libri I: Rregulla, KNKK, Gjenevë / Cambridge University Press, Cambridge, 2005, në dispozicion në <http://www.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/home>.

shtet tjetër. Gjithashtu duhet të merr hetim dhe, nëse gjendja imponon një gjë të tillë, penalisht të përndjekë të gjitha krimet e luftës për të cilët ekziston dyshimi se janë kryer nga qytetarët e tij apo nga forcat e armatosura, ose në territorin e tij, si dhe krimet tjera të luftës mbi të cilat shteti ka juridiksion.

Hapi 3 – shteti duhet të kërkojë nga komandantët e tij ushtarakë për të parandaluar shkeljet e rënda dhe krimet tjera të luftës dhe të ndërmerr veprim mbi ata persona nën kontrollin e tij që kanë kryer vepra të tilla.

Hapi 4 – shtetet duhet ndërmjet vete të ndihmohen në lidhje me procedurat penale në lidhje me shkeljet e rënda dhe krimet e tjera të luftës.

Hapi 5 – shteti duhet gjithashtu të ndërmerr masa që janë të domosdoshme për të penguar të gjitha veprat që janë në kundërshtim me dispozitat e DHN-së, të cilat nuk bëjnë pjesë në krimet e luftës. Pengimi mund të jetë, për shembull, në formë të sanksioneve ndëshkuese ose disiplinore.

Procedurat gjyqësore ndërkombëtare

Me qëllim që të vendoset një sistem më efektiv i ekzekutimit, me qëllim që të parandalohen, pengohen dhe ndëshkohen veprat penale më serioze ndërkombëtare – përfshirë dhe krimet e luftës – janë formuar disa gjykata penale ndërkombëtare.

Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka krijuar 2 gjykata penale ndërkombëtare për të gjykuar disa vepra penale – përfshirë dhe shkeljet e DHN-së – të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë dhe në lidhje me ngjarjet në Ruandë. Me mbylljen zyrtare të Gjykatës penale ndërkombëtare për Ruandën në fund të vitit 2015, dhe afrimit të fundit të mandatit të Gjykatës penale ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë, funksionet e tyre thelbësore do të ndërmerren nga Mekanizmi për Gjykatat Penale Ndërkombëtare.

Gjithashtu ka krijuar edhe gjykata “të përziera”, si për shembull Gjykata Speciale për Siera Leonen dhe Odat e Jashtëzakonshme në gjykatat në Kamboxha. Gjykatat e tilla kanë kombinuar karakteristikat e sistemeve gjyqësore ndërkombëtare dhe vendore.⁵ Akoma por formohen gjykata të tjera. Përveç kësaj me një marrëveshje ndërkombëtare në vitin 1998, është krijuar Gjykata Penale Ndërkombëtare e përhershme (GjPN) e cila ka kompetenca për të zhvilluar procese gjyqësore për shkelje serioze të DHN-së që janë në fushën e krimeve të luftës (Neni 8 i Statutit të GjPN-së). GjPN-ja filloi punën e saj në vitin 2002 pasi 60 shtete ratifikuan Statutin e GjPN-së.

Këto gjykata përfaqësojnë instrumente plotësuese të mekanizmave për pengim në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe janë një hap i madh përpara në përpjekjet për të parandaluar dhe ndëshkuar shkeljet serioze të DHN-së dhe të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Ekziston një vëmendje e vazhdueshme

⁵ Këtu bëjnë pjesë dhe Gjykata Penale Speciale në Republikën Qendrore Afrikane, Institucioni Gjyqësor i Specializuar i Zhvendosur për Kosovën dhe Dhomat e Jashtëzakonshme Afrikane në Senegal.

ndërkombëtare në lidhje me gjykatën dhe punën e saj, por siç është bërë qartë me dije në preambulën e Statutit të GjPN-së, shtetet janë përgjegjëse në mënyrë primare për veprat penale ndërkombëtare, përsirë dhe krimet e luftës.

Një Shtet i caktuar mund të thirret në juridiksionin e GjPN-së vetëm nëse shteti nuk është në gjendje ose nuk dëshiron për të zhvilluar në mënyrë autentike një hetim gjyqësor ndaj individëve që bëjnë pjesë nën juridiksionin e tij. Ky është parimi i komplementaritetit në përputhje me Statutin e GjPN-së. Nga shtetet nënshkruese të Statutit të GjPN-së pritet të miratojnë një ligj me të cilin autorizohet zhvillimi vendor i proceseve gjyqësore për veprat penale ndërkombëtare. Shtetet që janë nënshkruese të Statutit të VPN-së gjithashtu duhet të ndërmarrin hapa për sigurimin e bashkëpunimit gjyqësor me GjPN-në.

Veprat penale mbi të cilat ka juridiksion Gjykata Penale Ndërkombëtare

Gjenocidi (Neni 6)

Statuti i GjPN përcakton gjenocidin si cilado qoftë nga veprat e mëposhtme të kryera për shkatërrimin, të pjesshëm ose plotësisht, të një grupi kombëtare, etnik, racor apo religjioz:

- Vrasja e anëtarëve të grupit;
- Shkaktimi i dëmit serioz trupor ose mental tek anëtarët e grupit;
- Vendosja e qëllimshme e grupit në kushte jetësore që llogaritet se duhet të çojnë në shkatërrimin fizik të gjithë grupit apo të një pjese të grupit;
- Vendosja e masave dedikuar parandalimit të lindjes së fëmijëve në grupin;
- Transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga grupi në një grup tjetër.

Këtë definicion e potencon Neni 2 i Konventës për Parandalim dhe Ndëshkim të Veprës Penale Gjenocid i vitit 1948.

Krimi mbi njerëzimin (Neni 7)

Në përputhje me Statutin e GjPN-së, krimet mbi njerëzimin janë vepra të kryera si pjesë e një sulmi të shpërndarë ose sistematik i orientuar drejt çdo popullsie civile me dijeni se është duke u kryer sulm.

Veprat e përmendura në Nenin 7 janë:

- Vrasja;
- Shfarosja;
- Skllavëria;
- Skllavërimi;
- Deportimi apo transferimi i dhunshëm i popullsisë;
- Burgu ose privimi serioz i lirisë fizike duke lënduar rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare, në lidhje me çdo vepër që i referohet Nenit 7 ose çdo vepër penale në kuadër të juridiksionit të gjykatës;
- Tortura;
- Përdhunimi, skllavërimi seksual, prostitucioni i dhunshëm, shtatzënia e dhunshme, ose çdo formë e dhunës seksuale e natyrës së ngjashme;
- Përndjekja e çdo grupi të identifikuar apo kolektivi në bazë të përkatësisë kombëtare, etnike, kulturore, fetare, gjinore apo një përkatësie tjetër që janë të njohura në mënyrë universale si të palejuara në përputhje me të drejtën ndërkombëtare;
- Zhdukja e dhunshme e një personi;
- Vepra penale Aparteid; dhe

- Vepra të tjera johumane të natyrës së ngjashme të cilat qëllimisht shkaktojnë vuajtje të madhe apo lëndim serioz të trupit ose shëndetit mental ose fizik.

Krimet e luftës (Neni 8)

Në përputhje me Statutin e GjPN-së, kjo gjykatë ka juridiksion mbi krimet e mëposhtme të luftës, të kryera gjatë kohës së konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare:

- Shumica e shkeljeve të rënda të Konventave të Gjenevës të shkaktuara mbi personat dhe objektet e mbrojtura në përputhje me Konventat;
- Veprat që përbëjnë shkelje të tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve të luftimit që zbatohen në konflikte të armatosura ndërkombëtare;
- Shkeljet serioze të Nenit 3, i përbashkët për 4 Konventat e Gjenevës, respektivisht vepra të kryera kundër personave që nuk marrin pjesë aktive në armiqësitë, ose janë jashtë betejës (Horse de combat); dhe
- Veprat që përbëjnë shkelje të tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve të luftimit që zbatohen në konflikte të armatosura të karakterit jo-ndërkombëtare.

Lista e Nenit 8 përfshin veprat e tilla si: përdhunimin, skllavërimin seksual, prostitucionin e dhunshëm, shtatzëninë e dhunshme, sterilizimin dhe format e tjera të dhunës seksuale, si dhe përdorimin e fëmijëve të moshës nën 15 vjeç për të marrë pjesë në mënyrë aktive në armiqësitë.

Gjatë konferencës së rishikimit të GjPN, e mbajtur në Kampala në vitin 2010, Neni 8 u ndryshua për t'u përfshirë në definicionin e krimeve të luftës edhe armët kimike dhe plumbat dum-dum në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare. Përdorimi i armëve të tilla tek konfliktet e armatosura ndërkombëtare tanimë ishte krim i luftës në përputhje me Statutin.

Disa shkelje të rënda të Konventës së Gjenevës dhe Protokollit Shtesë nuk janë theksuar në mënyrë specifike në Nenin 8 të Statutit të GjPN-së. Kjo është një vonesë e pajustificuar në riatdhesimin e të burgosurve të luftës, praktika të lidhura me Aparteidin (edhe pse vetë Aparteidi konsiderohet krim kundër njerëzimit), dhe sulmet jo selektive mbi instalimet që përmbajnë fuqi të rrezikshme të cilat mund të prekin popullsinë civile apo objektet civile. Tabela në të cilën janë paraqitur krimet e luftës në përputhje me Statutin e GjPN dhe burimet e tij në DHN është në dispozicion të <https://www.icrc.org/en/document/war-crimes-under-rome-statute-international-criminal-court-and-their-source-international#.VM-YBuk5D5o>.

Vepra penale agresion (Neni 8 sërish)

Gjatë konferencës së rishikimit të GjPN, e mbajtur në Kampala në vitin 2010, janë miratuar amendamente me të cilat ishte shtuar vepra penale individuale e agresionit në Statutin e GjPN. Kjo vepër penale ka të bëjë me planifikimin, përgatitjen, iniciimin ose kryerjen e veprës agresion nga ana e personit në funksion udhëheqës.

Vepra e agresionit definohet si përdorim i forcës së armatosur nga ana e shtetit kundër sovranitetit, integritetit territorial ose pavarësisë politike të një shteti tjetër pa justifikim se është për shkak të vetëmbrojtjes ose pa ekzistimin e autorizimit të Këshillit të Sigurimit të KB-ve (për më shumë lidhur me këtë, shihni jus ad bellum dhe jus in bello në kapitullin “Çfarë është e drejta humanitare ndërkombëtare?”). Sipas amendamentit, një numër i caktuar veprash janë kualifikuar si agresion:

- Invadimi, okupimi ushtarak apo aneksimi (aneksimi i territorit të një shteti duke përdorur forcën);
- Bombardimi apo përdorimi i armëve kundër territorit të një shteti tjetër;
- Bllokimi i limaneve apo bregdetit të një shteti tjetër;
- Sulmi i forcave të armatosura nga ana e një shteti në tokë, det ose hapësirë ajrore, apo limanet ose aeroportet e një shteti tjetër;
- Përdorimi i forcave të armatosura të një shteti të cilat gjenden në territorin e një shteti tjetër në marrëveshje me shtetin nikoqir, në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në marrëveshje;
- Vendosja në dispozicion të territorit shtetëror të një shteti tjetër për kryerjen e veprës agresion kundër një shteti të tretë; dhe
- Dërgimi i bandave të armatosura, grupeve dhe ushtrisë së rregullt apo mercenarë për kryerjen e agresionit mbi një shtet tjetër.

Juridiksioni i GjPN për veprën penale agresion nuk hyn në fuqi derisa shtetet nënshkruese nuk e aktivizojnë, që mund të ndodhë nga 1 janari i vitit 2017.

Çfarë është dallimi ndërmjet DHN-së dhe DNDNj?

E Drejta Humanitare Ndërkombëtare (DHN) dhe E Drejta Ndërkombëtare për Të Drejtat e Njeriut (DNDNj), kanë për qëllim të mbrojnë jetën, shëndetin dhe dinjitetin e individëve.

DHN-ja dhe DNDNj janë dy degë komplementare por të ndara të së drejtës ndërkombëtare. Ato janë zhvilluar me kalimin e kohës në mënyrë të pavarur njëra nga tjetra dhe janë të përmbajtura në burime të ndryshme. Edhe pse fusha e zbatimit të tyre përkon, mekanizmat për pajtueshmërinë e tyre janë të ndryshme.

DHN-ja zbatohet vetëm gjatë kohës së një konflikti të armatosur ndërkombëtare ose jo-ndërkombëtar dhe ka për qëllim, për arsye humanitare, të kufizojë efektet e luftës mbi njerëzit dhe objektet. DNDNj-ja zbatohet në çdo kohë – në situata të një konflikti të armatosur dhe në paqe. DHN-ja është e detyrueshme për të gjitha palët në një konflikt të armatosur duke përfshirë dhe forcat e armatosura shtetërore dhe grupet e armatosura të organizuara jo-shtetërore. DNDNj është e detyrueshme vetëm për qeveritë në marrëdhëniet e tyre ndaj individëve.

Çdo njeri ka të drejtën e të drejtave të njeriut. Mirëpo, disa të drejta të njeriut mund të suspendohen përkohësisht në situatat kur kërcënohet ekzistenca e një kombi,

përfshirë dhe kushtet e luftës. DHN-ja, nga ana tjetër, nuk lejon asnjë shmangie sepse ajo i referohet vetëm situatës së jashtëzakonshme të një konflikti të armatosur.

DHN-ja dhe DNDNj-ja mbulojnë njëra-tjetrën në shumë zona:

- Mbrojtja e jetës së njeriut;
- Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, jonjerëzor dhe degradues;
- Ndalimi i skllavërisë dhe skllavërimit;
- Sigurimi i garancive themelore gjyqësore;
- E drejta e ushqimit;
- E drejta e kujdesit shëndetësor.

Edhe DHN-ja dhe DNDNj-ja njohin përgjegjësinë penale individuale për:

- Krime të luftës, në përputhje me definicionin në DHN; dhe
- Gjenocid dhe krim mbi njerëzimin, në përputhje me definicionin në DHN dhe DNDNj.

Pjesa 2: Roli i deputetëve në implementimin e DHN-së

Fotografia: Republika Xhonglai, Vaat, Sudani i Jugut. Një i plagosur në konflikt të armatosur nxirret nga avioni i KNKK-së pasi është evakuuar nga ekipi mjekësor. ©KNKK/ Jakov Zoherman



Si bëhet implementimi i DHN-së?

Implementimi i DHN-së është përgjegjësi kryesisht e shteteve. Kjo përgjegjësi është përcaktuar në Nenin 1 të përbashkët për Konventat e Gjenevës, i cili kërkon nga shtetet për të respektuar dhe për të siguruar respektimin e Konventave në të gjitha rrethanat. Kjo do të thotë se shtetet duhet të ndërmarrin një numër të madh masash juridike dhe praktike me qëllim që të sigurojnë respektimin e rregullave të DHN-së.

Cilat masa mund t'i ndërmarrin deputetët për të ndërtuar një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse nacionale për DHN?

Të bëheni nënshkrues i marrëveshjeve të DHN-së dhe instrumentet përkatëse

Duke u bërë nënshkrues të DHN-së apo të marrëveshjeve në lidhje me DHN-në, shtetet pajtohen për të qenë të detyruara ligjërisht me dispozitat saj. Fakti që çdo

shtet në botë është nënshkruar i Konventave të Gjenevës tregon se këto marrëveshje gëzojnë mbështetjen e gjithë komunitetit ndërkombëtar, që u jep autorizim aq të madh.

Deputetët luajnë rol kyç në procesin me të cilin shtetet bëhen nënshkruar të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në zbatimin nacional të rregullave dhe parimeve që ata i personifikojnë. Ekzistojnë disa punë që mund t'i bëni si deputet:

- Njihuni me procesin juridik për t'u bërë nënshkruar i marrëveshjeve ndërkombëtare dhe cilat vegla janë në dispozicionin tuaj.
- Shihni nëse shteti juaj është nënshkruar i DHN-së ekzistuese dhe i marrëveshjeve në lidhje me DHN-në.
- Nëse shteti juaj nuk i ka ratifikuar apo nuk i ka pranuar këto instrumente, bëni një pyetje me shkrim ose me gojë për Qeverinë.
- Nëse qeveria juaj nuk ka nënshkruar marrëveshje, përdorni procedurat parlamentare për të kërkuar nga qeveria juaj që të shpjegojë pse dhe ta inkurajojë atë për të nisur procesin e ratifikimit ose pranimin pa vonesë.
- Nëse qeveria juaj nuk ka nënshkruar marrëveshje por vonon procesin e ratifikimit, përdorni një procedura parlamentare për të parashtruar pyetjen pse qeveria juaj e vonon këtë çështje dhe inkurajoni përshpejtimin e procesit. Përdorni të drejtën tuaj për iniciativën legjislative për të paraqitur një propozim ligjor për këtë çështje.
- Nëse qeveria juaj kundërshton ratifikimin apo pranimin, përpquni të merrni vesh në hollësi çfarë është shkak. Nëse është e nevojshme, ndihmoni në eliminimin e dyshimeve, idetë paragjyquese dhe keqkuptimet, dhe përdorni rrjetin tuaj politik për të përshpejtuar procesin. Avokoni para elektoratit tuaj për të promovuar shkakun ratifikimit ose aderimit.
- Nëse shteti juaj është krijuar me ndarje ose me dezintegrimin e një shteti tjetër, marrëveshjet që i ka nënshkruar shteti i mëparshëm nuk janë me automatizëm të detyrueshme për shtetin tuaj. Shteti juaj mund të trashëgojë detyrimet e shtetit të mëparshëm, të pranojë DHN-në dhe marrëveshje në lidhje me DHN-në si shtet i ri, ose mund tregojë qëllimin e tij se nuk dëshiron të jetë i detyruar me marrëveshjet e lidhura nga shteti i mëparshëm.

Deputetët, gjithashtu mund të sigurojnë që ratifikimi ose aderimi në një marrëveshje DHN apo SHHN nuk shoqërohet me ndonjë rezervë për të kufizuar gamën e marrëveshjes, ose me ndonjë kundërshtim ose deklaratë mirëkuptimi. Çfarë mund të bëni varet kryesisht nga rasti i veçantë:

- Nëse qeveria paraqet kërkesë në parlament për ratifikim apo aderim, shoqëruar me hezitim për çështje caktuara që kufizojnë fushën e marrëveshjes, ankesat ose deklaratat e mirëkuptimit, dhe keni konstatuar se kufizimet e tilla janë të pabazuara, përdorni procedurën parlamentare për të kontestuar këtë qasje.
- Nëse hezitimi i qeverisë kufizon fushën e marrëveshjes, ankesat e saj ose deklaratat e saj të mirëkuptimit tanimë nuk janë të vlefshme, përdorni

procedurën parlamentare për të bërë pyetje për qëllimet e qeverisë dhe për të ndërmarrë veprim për të hequr kufizimet. Gjithashtu, mund të përdorni të drejtën tuaj për iniciativë për të propozuar që kufizimet e tilla të hiqen.

Deputetët, gjithashtu mund të sigurojnë deklarata të caktuara konkrete që mund të bëhen në lidhje me një marrëveshje DHN, për t'u dhënë me të vërtetë gjatë nënshkrimit, aderimit në marrëveshje ose më vonë.

Kur duhet të zbatohet DHN-ja?

DHN-ja zbatohet vetëm gjatë kohës së konflikteve të armatosura, por masat e nevojshme të zbatimit duhet të merren edhe në kohë të luftës dhe paqes. Veçanërisht duhet të ndërmerren masa parandaluese gjatë kohës së paqes. Kjo është mënyra më e mirë për të arritur një respektim të plotë të DHN-së në rast të një konflikti..

Deklaratat e veçanta që duhet të jepen në ratifikimin e marrëveshjeve të caktuara

Protokolli Shtesë I i Konventave të Gjenevës: Shtetet nënshkruese të Protokollit Shtesë I i Konventave të Gjenevës mund të pranojnë, në përputhje me Nenin 90 të Protokollit, kompetencën e Komisionit Humanitar Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve.

Konventa e Armëve të Caktuara Konvencionale: Shtetet duhet të deklarojnë pëlqimin se obligohen me të paktën dy nga pesë Protokollet e Konventave.

Protokolli IV i Konventave të Armëve të Caktuara Konvencionale: Shtetet që do të bëhen nënshkruese të Protokollit IV të Konventave për Armët e Caktuara Konvencionale (armët verbuese me laser) mund të japin deklaratë me të cilën do të specifikojnë se Protokolli zbatohet “në të gjitha rrethanat”, përfshirë dhe në konfliktet e armatosura ndërkombëtare.

Protokolli Opsional i Konventave për Të Drejtat e Fëmijëve në lidhje me përfshirjen e Fëmijëve në një Konflikt të Armatosur: Shtetet që kanë ratifikuar apo aderuar në Protokollin duhet të paraqesin deklaratë obliguese me të cilën përcaktohet mosha minimale në të cilën është i lejuar rekrutimi vullnetar në forcat e armatosura dhe përshkrimi i masave të sigurisë që janë miratuar për të siguruar që ky rekrutim të mos jetë i dhunshëm apo i detyruar.

Lista e kontrollimit për deputetët

- Sigurohuni se shteti juaj është nënshkrues i marrëveshjeve të përmendura në “Cilat janë marrëveshjet kryesore për marrëveshjet DHN dhe instrumentet përkatëse?” të këtij doracaku.
- Nëse shteti juaj është nënshkrues i këtyre marrëveshjeve, kontrolloni nëse i ka bërë deklarata e veçanta të sipërpërmendura.

- Kur shteti i juaj do të ratifikojë apo do të aderojë në një marrëveshje të caktuar, përkujdesuni për të mos pasur hezitim ndaj çështjeve të caktuara apo të bëhen deklarata mirëkuptimi të cilat:
 - janë në kundërshtim me lëndën dhe qëllimin e marrëveshjes;
 - minojnë thelbin e marrëveshjes.
- Rregullisht kontrolloni për të qenë të sigurt që kufizimet apo deklaratat e mirëkuptimit të bëra nga shteti juaj, kur kanë ratifikuar apo kanë aderuar në marrëveshjen, akoma janë të vlefshme ose nëse duhet të rishikohen.
- Për të gjitha këto çështje, mos u hamenduni:
 - pyetni shërbimin relevant qeveritar për më shumë informacione;
 - hapni një debat parlamentar;
 - kërkoni mbështetjen e publikut.

Miratimi i ligjeve të implementimit

Tek disa sisteme legjislative, një marrëveshje e caktuar DHN do të hyjë në fuqi në legjislativen nacionale me automatizëm, ose, me të shpallur shteti se ai është bërë nënshkrues i marrëveshjes. Në raste të tilla, legjislativi nacional, në një moment të caktuar duhet të harmonizohet me marrëveshjes, qoftë para ose pas hyrjes së saj në fuqi. Në disa vende, nga ana tjetër, marrëveshja nuk do të hyjë në fuqi derisa rregullat ndërkombëtare që i përmban ajo të mos inkorporohen në legjislativen nacionale.

Shteti nuk do të bëhet zyrtarisht nënshkrues i marrëveshjes deri në atë moment. Sidoqoftë, legjislativi nacional duhet të përshtatet pa vonesë. Kjo mund të kërkojë ndryshime të vogla apo të mëdha në ligjet ekzistuese, ose mund të kërkojë përgatitjen e ligjeve krejtësisht të reja. Këto ligje përbëjnë kornizën juridike, e cila pastaj duhet të plotësohet me rregulla të hollësishme.

Nëse është e nevojshme, deputetët mund të përdorin procedurën parlamentare për të siguruar që qeveria të paraqesë projekt-ligje apo ndryshime të legjislative ekzistuese në parlament në një afat të arsyeshëm. Në qoftë se dialogu nuk ka sukses, ata mund të përdorin të drejtën e tyre për të ngritur iniciativë dhe vetë të përgatisin një projekt-ligj. Kur ligjet propozohen nga qeveria në një mënyrë tjetër, deputetët mund të marrin pjesë në mënyrë aktive në diskutimet dhe në edukimin e qytetarëve për rëndësinë e çështjeve që janë objekte i interesit.

Nëse jeni të interesuar për të ditur më shumë informacione

Deputetët mund të kërkojnë këshillë dhe ndihmë nga ekspertët nacionalë dhe ndërkombëtarë për DHN-në.

Shërbimi Këshillëdhënës për DHN dhe KNKK është në dispozicion për të siguruar mbështetje për deputetë dhe për shërbimet parlamentare legjislative dhe administrative përmes sigurimit të informacioneve, këshillave dhe udhëzimeve.

Gjithashtu ekziston baza e të dhënave për implementimin nacional të DHN-së së bashku me legjislacionin vendor që janë në dispozicion në <https://www.icrc.org/ihl-nat>. Ligjet model për temat e lidhura me DHN-në janë në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/legal-fact-sheet/national-implementation-model-laws.htm>.

Në nivel nacional, shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, si dhe Komitetet Nacionale për DHN (në vendet ku ekzistojnë), mund të sigurojnë mbështetjen shtesë (shihni “Cili është roli i deputetëve në promovimin e implementimit nacional të DHN-së?”)

Cilat masa praktike mund t’i ndërmarrin deputetët për të siguruar zbatimin e DHN-së në nivel nacional?

Miratimi i mjeteve të domosdoshme financiare

Nga deputetët mund të kërkohej të miratojnë mjetet financiare për përgatitjen e planit nacional të veprimit për promovimin e respektimit të DHN-së ose për programin që është i lidhur me zbatimin e DHN-së ose trajnimet e lidhura me zbatimin e DHN-së.

Mjetet e miratuara duhet të jenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të trajnimit të forcave të armatosura dhe të sigurimit, autoritetet administrative dhe personelin shëndetësor në fushën e rregullave të DHN-së. Kur shpërthen një konflikt i armatosur, pasojat për popullsinë mund të jenë katastrofale nëse këto shërbime nuk janë të aftësuara në mënyrë përkatëse.

Gjykatat gjithashtu duhet të kenë resurse të nevojshme për ndërmarrjen e rolit të tyre nëse janë shkelur rregullat e DHN-së.

Shihni “Si deputetët mund të ulin prekshmërinë në vendet e prekura nga konflikti përmes fondeve fleksibile, të parashikuara dhe të qëndrueshme për veprim humanitar?”. Më poshtë për më shumë informacione në lidhje me mjetet financiare në dispozicion.

Mbrojtja e emblemave

Në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë, shtetet nënshkruese të Protokollit Shtesë III duhet të mbrojnë dhe rregullojnë përdorimin e emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kryqit të kuq Kristal, veçanërisht në formë të sjelljes së një kornize përkatëse ligjore për këtë qëllim.

Emblemat përdoren gjatë kohës së luftës për të identifikuar dhe mbrojtur shërbimet mjekësore të forcave të armatosura dhe të spitaleve të civilëve, për të qenë në gjendje në mënyrë të papenguar të sigurojnë ndihmë për viktimat. Pa shenja të tilla treguese shërbimet mjekësore lehtë mund të identifikohen gabimisht nga luftëtarët.

Emblemat gjithashtu përdoren për të identifikuar njerëzit dhe objektet që i takojnë shoqërive të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Federatës Ndërkombëtare

të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Komitetit Ndërkombëtare të Kryqit të kuq gjatë kohës së paqes dhe luftës.

Kush ka të drejtë për të përdorur emblemën e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq?

Gjatë një konflikti të armatosur mund të kenë dedikim mbrojtës dhe të përdoren si **mjetet mbrojtëse** nga ana e:

- Shërbimeve mjekësore dhe personelit fetar të forcave të armatosura shtetërore;
- Spitalet e civilëve;
- Shërbimet mjekësore të shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
- Gjithë personeli civil mjekësor dhe fetar i territorit të okupuar, në zonat ku ndodhin luftërat, ose pas marrjes së autorizimit nga organet e autorizuar për të theksuar emblemën;
- Asociacione të tjera të njohura dhe të autorizuar të vullnetarëve, nën kushtet e njëjta si ato që janë zbatuar për shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
- Federata Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
- Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq.

Gjatë kohës së paqes, emblemat mund të përdoren për objektiva tregues nga ana e:

- Subjekteve, njerëzve apo objekteve që i takojnë njërës nga komponentët e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, Federatës Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq);
- Automjetet e ambulancës dhe ambulantat, nën kushte të caktuara.

Për të qenë DHN-ja më efektive, emblemat e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq duhet të përdoren në mënyrën e duhur. Çdo keqpërdorim i emblemave mund të dobësojë efektin e tyre mbrojtës gjatë kohës së konfliktit të armatosur, dhe në këtë mënyrë të dobësojë efektivitetin e ndihmës humanitare e cila sigurohet për viktimat. Për këtë arsye, nuk duhet të tolerohet asnjë keqpërdorim i emblemave. Konventat e Gjenevës kërkojnë nga shtetet për të sjellë ligje përkatëse nacionale për këtë qëllim.

Çfarë përfaqëson keqpërdorimi i emblemës?

- **Imitimi**, ose përdorimi i shenjës që për shkak të formës dhe/ose ngjyrës, mund të sjellë hutim në lidhje me emblemën.
- **Uzurpimi**, ose përdorimi i emblemës nga subjektet ose personat që nuk të drejtë për këtë, si për shembull kompanitë, barnatoret dhe ordinancat private.
- **Tinëzia**, ose përdorimi i emblemës gjatë kohës së një konflikti për mbrojtjen e luftëtarëve ose të materialit ushtarak.

Shtetet janë përgjegjëse për të përgatitur rregullore në lidhje me përdorimin e emblemës. Prandaj, çdo shtet duhet të miratojë masa për mbrojtjen e emblemës dhe krijimin e një organi shtetëror që është përgjegjës për rregullimin e përdorimit të tij, dhe të përgatisë listë të subjekteve që kanë të drejtë për ta përdorur.

Shtetet gjithashtu duhet të miratojnë një legjislativë nacionale që ndalon dhe ndëshkon përdorimin e paautorizuar të emblemave, veçanërisht në lidhje me përdorimin e tyre tinëzar, që është krim i luftës. Parlamentarët luajnë një rol kyç në gjithë këtë proces. Nga diskutimet me personat nga të cilët janë zgjedhur dhe si liderë të komunitetit, politikanët kanë mundësi për të promovuar informacione për emblemat madje edhe të përfshihen në gjetjen e zgjidhjeve pozitive për zgjidhjen e situatave të lidhura me keqpërdorimin e emblemave. Është përgatitur një ligj model i cili mund të shërbejë si dokument i dobishëm i referimit në përgatitjen e ligjit nacional për Kryqin e kuq (Aneksi 4).

Lista e kontrollimit për deputetë

- Kontrolloni nëse ekziston legjislativë në lidhje me mbrojtjen e emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq.
- Nëse nuk ekziston një ligj i tillë përkujdesuni për të miratuar atë me një ligj përkatës.
- Nëse legjislativi ekzistues është i papërshtatshëm apo me afat të skaduar, përkujdesuni për të harmonizuar atë.
- Nëse keni ndonjë dyshim në lidhje me llojin e ligjit që duhet të miratohet, lirisht kontaktoni Shërbimin Këshillëdhënës të KNKK-së. Gjithashtu mund të shihni Pjesën 4 të këtij doracaku, i cili përmban ligjin model.
- Përkujdesuni për të miratuar rregulloret e domosdoshme për të qenë në gjendje të zbatohet ligji.
- Përkujdesuni që ligji dhe rregulloret përkatëse të implementimit:
 - të përcaktojnë dhe njohin një emblemë mbrojtëse;
 - të përcaktojnë një subjekt nacional i cili është përgjegjës për përgatitjen e rregulloreve në lidhje me përdorimin e emblemës;
 - të përcaktohen subjektet që janë përgjegjëse për përdorimin e emblemës si mjet mbrojtës dhe që kanë të drejtë për ta përdorur si mjet tregues (shih listën më sipër);
 - të sigurohen masat për identifikimin e fushave në të cilat mund të përdoren emblemat;

- të sigurohen masat për identifikimin e një trupi/disë trupave, që do të jenë përgjegjës për respektimin e keqpërdorimit të emblemës;
- të përcaktohen sanksionet që do të zbatohen në rast të imitimit, uzurpimit dhe përdorimi tinëzar.
- Ju si deputet duhet:
 - të kujdeseni që pushteti ekzekutiv të përcaktojë një mënyrë të sigurt për zbulimin e keqpërdorimit të emblemës;
 - në rast të një konflikti të armatosur të përkujdeseni që dispozitat për mbrojtjen e emblemës me të vërtetë të përdoren dhe çdo keqpërdorim i emblemës të ndëshkohet në mënyrë efektive.

Përhapja e njohurive për DHN-në

Marrëveshjet DHN kërkojnë nga shtetet për të përhapur njohuritë për marrëveshjet sa të jetë e mundur më shumë tek forcat e armatosura dhe publiku i përgjithshëm. Ky proces diseminues duhet të nis në paqe për të siguruar që parimet humanitare të jenë të mirënjohura për të gjithë.

Integrimi i DHN-së në një doktrinë, edukim dhe trajnim, dhe instruksionet për forcat e armatosura

DHN-ja ndihmon në sjelljen e drejtë në armiqësitë. Për t'u respektuar plotësisht, ata që udhëheqin luftën duhet të jenë të ndërgjegjshëm për rregullat dhe parimet e saj për t'i inkuorporuar në sjelljen e tyre. Prandaj me rëndësi thelbësore është që çdo pjesëtar i forcave të armatosura të jetë i aftësuar në sferën e DHN-së.

Pjesëtarët e forcave të armatosura pa marrë parasysh gradën apo funksionin e tyre, duhet të marrin instruksione të plota në lidhje me DHN-në. Nuk është e mjaftueshme për ata që herë pas here të takohen me lëndën në kurse të shkurta. Parimet e DHN-së duhet të integrohen plotësisht në kodin ushtarak, doktrinat dhe programet e trajnimit. Një nga mënyrat më të mira për të aftësuar trupat për DHN-në, është inkorporimi i "dimensionit humanitar" në manovrat, në lidhje me ballafaqimin e ushtarëve me llojet e situatave me të cilat ata duhet të përballen.

Sipas DHN-së, duhet të aftësohen këshilltarë juridikë gjatë kohës së paqes, për të qenë në dispozicion në kushte të një konflikti për të qenë në gjendje të sigurojnë këshilla për komandantët ushtarakë lidhur me zbatimin e rregullave të DHN-së. Prania e ekspertëve të tillë është me rëndësi gjithnjë e më të madhe si rezultat i ndërlikueshmërisë së kësaj dege të së drejtës. Këta ekspertë gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në diseminimin e instruksioneve adekuate për forcat e armatosura.

DHN-ja dhe forcat e armatosura

KNKK ka përgatitur programe të trajnimit për DHN në nivele të ndryshme si përgjigje nda kërkesave të forcave të armatosura shtetërore. Ato janë në formë të:

- Fjalimeve/ligjëratave të shkurta në akademitë ushtarake;

- Punëtori për instruktorë;
- Seminare për oficerët e lartë ushtarakë dhe këshilltarët juridikë;
- Kurse ushtarake për nivelin ndërkombëtar;
- Module online për trajnim.⁶

Më shumë informacione në këtë temë keni në: <https://www.icrc.org/en/what-we-do/building-respect-ihl/dialogue-weapon-bearers>.

Ngritja e ndërgjegjes së popullsisë dhe e publikut të specializuar për DHN-në

Nëse duhet të respektohet rregullat e DHN-së, ato duhet të jenë të mirënjohura jo vetëm për ata që duhet t'i zbatojnë direkt, por me to duhet të jetë e njohur popullsia e përgjithshme. Me rëndësi thelbësore është promovimi i rregullave të DHN-së para nëpunësve shtetërorë, përfaqësuesit e qeverisë, përfaqësuesit e qarqeve akademike, në shkollat fillore dhe të mesme, në qarqet mjekësore dhe para medimeve, me qëllim të ndërtimit të kulturës për DHN-në dhe respektimi i saj.

Ka shumë mënyra si të aftësohet publiku i përgjithshëm për DHN-në. Mënyrat efektive mund të jenë: posterët, spotet televizive dhe reklamat e kinemasë, ligjëratat dhe seminarët. Gjithashtu, mund të përdoren edhe librat shkollorë për të njohur nxënësit me këtë trup të së drejtës.

Për më shumë informacione dhe resurse për mësimin për DHN-në

KNKK siguron një numër të madh resursesh për mbështetjen e diseminimit të DHN-së:

- e-kurse për mësimin e DHN-së (<https://www.icrc.org/eng/war-and-law/law-and-policy/online-training-centre.htm>);
- e-kurse për mësimin e kornizës juridike për mbrojtjen e qendrave dhe personelit shëndetësor (<http://www.icrcproject.org/elearning/health-care-in-danger/beta/>);
- libra online me shembuj me material mësimor që është i nevojshëm për një kurs të DHN-së duke përdorur praktikat (<https://www.icrc.org/casebook/index.jsp>).

Roli i deputetëve

Mund të miratohet një rregullore ligjore në të cilën janë përcaktuar drejtimitet e përgjithshme në lidhje me diseminimin e DHN-së. Si alternativë e kësaj, në disa ligje (shembull, për mediumet apo për mbrojtjen) mund të përfshihen dispozitat e lidhura me promovimin e DHN-në.

⁶ Për zgjedhjen e materialit mësimor, shihni: <https://www.icrc.org/en/online-training-centre>.

Mirëpo, në numrin më të madh rastesh, diseminimi është përgjegjësi kryesore e ministrive përgjegjëse (zakonisht kjo është ministria e mbrojtjes) dhe pushteti i përgjithshëm ekzekutiv. Prandaj, në raste të tilla, roli i parlamentarëve është monitorimi i diseminimit. Ata duhet të përkujdesen që pushteti ekzekutiv të ketë bërë gjithçka që është e mundur për të aftësuar forcat ushtarake dhe për të ngritur ndërgjegjen e publikut për DHN-në.

Parlamentarët gjithashtu duhet të përkujdesen për të ekzistuar buxhetet adekuate në të cilat ka mjetet qartazi të shënuara për trajnimin e forcave të armatosura dhe për instruksione për publikun e përgjithshëm për DHN-në.

Në bazë të funksionit publik, deputetët shpeshherë janë të autorizuar dhe posedojnë mjetet edhe vetë të promovojnë DHN-në, për shembull, përmes mbajtjes së fjalimeve për rëndësinë e legjislatives nacionale lidhur me zbatimin e DHN-së, interesin afatgjatë të vendit për respektimin e rregullave të DHN-së dhe rreziqet që dalin në qoftë se shkelen këto rregulla. Ata gjithashtu mund të shkruajnë artikuj në gazeta dhe të punojnë me sektorin qytetar, gjithnjë kur është e mundur, duke promovuar një implementim rigoroz kombëtar të DHN-së.

Lista e kontrollimit për deputetët

- Përkujdesuni që pushteti ekzekutiv të bëjë atë që është e nevojshme për të njohur forcat e armatosura me DHN-në.
- Përkujdesuni për të mëposhtmen:
 - të gjithë pjesëtarët e forcave të armatosura të trajnohen për DHN, e cila është përshtatur në përputhje me aktin apo funksionin e ri;
 - të gjithë pjesëtarët e forcave të armatosura të kenë qasje të informacionet kur janë mbledhur parimet themelore të DHN-së;
 - pjesëtarët e forcave të armatosura duhet të marrin pjesë në manovra ku në mënyrë eksplicite merret parasysh dimensionin humanitar;
 - të gjithë pjesëtarët e forcave të armatosura të angazhohen në konflikt apo të dërguar jashtë, përfshirë edhe ata për arsye të operacioneve paqësore, të trajnohen në mënyrë përkatëse për DHN-në, e cila do të përshtatet në përputhje me nevojat e misionit të tyre;
 - programet për mësimdhënien ushtarake të shprehin parimet e DHN-së;
 - këshilltarët juridikë plotësisht duhet të jenë të aftësuar për të zbatuar DHN-në dhe të jenë në dispozicion për nevojat e forcave të armatosura.
- Përkujdesuni kodi dhe doktrina ushtarake të jenë në përputhje me obligimet e DHN-së dhe në të qëndrojnë qartë se:
 - njerëzit që nuk janë pjesë, ose që tanimë nuk marrin pjesë në armiqësitë, të trajtohen në mënyrë humane dhe pa diskriminim;
 - të sigurohet ndihmë për të plagosurit, të sëmurët dhe personat që kanë pësuar fundosje të anijes pa asnjë diskriminim;

- aktivitetet mjekësore gjatë konflikteve të armatosura janë përcaktuar dhe mbrojtur;
- njësitë ushtarake dhe/ose civile mjekësore janë të autorizuar për të punuar në situatat të konfliktit dhe janë të mbrojtura nga sulmet;
- është i ndaluar çdo sulm mbi personelin apo pajisjen mjekësore;
- është i ndaluar çdo detyrim apo trajtim i dhunshëm i popullsisë civile;
- civilët që gjykohen kanë të drejtën e garancive të caktuara procedurale, dhe aktgjykimet verifikohen në përputhje me ligjin;
- të burgosurit e luftës trajtohen pa diskriminim dhe mirëmbajtja e tyre është e garantuar dhe falas;
- të burgosurit e luftës kanë qasje në marrëveshjet relevante të fushës së DHN-së;
- të burgosurit e luftës që gjykohen kanë të drejtën e garancive të caktuara procedurale, dhe aktgjykimet përcaktohen në përputhje me ligjin;
- kufiri minimal ligjor për rekrutim në forcat e armatosura nuk duhet të jetë nën moshën 18 vjeç;
- civilët dhe objektet civile janë të mbrojtura nga operacionet ushtarake;
- grave dhe fëmijëve duhet t'u kushtohet respekt dhe mbrojtje e veçantë;
- armët që janë dispozicionin e forcave të armatosura nuk duhet të jenë të ndaluara me DHN;
- shëndeti dhe integriteti fizik ose mental i personave të internuar nuk duhet të rrezikohet;
- pamja e luftëtarëve detyrimisht duhet të dallojë nga popullsia civile;
- civilët dhe ushtarët gëzojnë garanci themelore;
- gjatë zbatimit të armiqësive duhet pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit jetësor;
- janë të ndaluara sulmet mbi ndërtimet dhe centralet që përmbajnë fuqi të rrezikshme;
- gazetarët janë të mbrojtur dhe mbajnë letërnjoftime të veçanta.
- Përkujdesuni që publiku i gjerë të njihet me DHN-në.
- Përkujdesuni, gjithmonë kur është e mundshme, që kategoritë e mëposhtme të popullsisë të marrin informacione për DHN-në:
 - nëpunësit shtetërorë dhe nëpunësit qeveritarë;
 - gjykatësit dhe personat juridikë;
 - qarqet akademike;
 - fëmijët dhe të rinjtë në shkollat e mesme dhe në universitetet;
 - qarqet mjekësore;
 - mediumet.

- Nëse pushteti ekzekutiv nuk siguron rezultate konkrete mos u hamenduni dhe ndërmerrni hapat e mëposhtme:
 - inicioni këtë çështje para qeverisë;
 - prezantoni çështjen para anëtarëve të qeverisë dhe inkurajoni ata për të zgjeruar aktivitetet diseminuese;
 - kërkoni të votohet për një ligj kornizë i cili do të përmbajë udhëzime për diseminimin.
- Në rast të një konflikti të armatosur përkujdesuni për të intensifikuar dhe mbajtur përpjekjet për promovimin e njohurive për DHN-në.

Cilat masa mund t'i ndërmarrin deputetët për të siguruar ndëshkimin e shkeljeve të DHN-së

Nënshkrimi i marrëveshjeve për DHN-në dhe instrumentet përkatëse, dhe miratimi i masave përkatëse ligjore të implementimit për fat të keq nuk është i mjaftueshëm për të garantuar respektimin e DHN-së. Shtetet detyrimsht duhet të kenë kapacitet, në përputhje me legjislacionin nacional, në mënyrë gjyqësore të përndjekin dhe ndëshkojnë ata që janë përgjegjës për shkeljet serioze të DHN-së. Shtetet gjithashtu duhet të ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për pengimin dhe ndalimin e dhunës gjithmonë kur ato paraqiten, përmes sigurimit të mekanizmave efektivë sanksionues.

Mënyra më e mirë është që palët ndërluftuese të respektojnë DHN-në që nga fillimi, por përvojat nga luftërat tregojnë se njohja e rregullave dhe vullneti i mirë nuk janë të mjaftueshëm. Prandaj, gjykimi dhe ndëshkimi i njerëzve që seriozisht kryejnë shkelje të DHN-së, përmes kryerjes së krimeve të luftës, jo vetëm që është detyrim ligjor dhe moral, por gjithashtu është një mjet efektiv për të parandaluar ndodhjen e shkeljeve. Mos ndëshkimi është ftesë për mizori të reja.

Me qëllim që shkeljet e DHN-së të mund të përndiqen në mënyrë gjyqësore, legjislativi penal duhet të përcaktojë veprat penale dhe ndëshkime përkatëse për këto vepra. Me të vërtetë parimi i kodit penal është se askush nuk duhet të ndëshkohet për një vepër që nuk ka qenë vepër penale në momentin kur është kryer. Për këtë arsye është absolutisht e domosdoshme për të përgatitur një kornizë ligjore që përfshin shkeljet serioze të DHN-së dhe që siguron respektimin e garancive gjyqësore. Në lidhje me ndëshkimin, shihni gjithashtu “si ndëshkohen shkeljet e DHN-së?”.

Marrëveshjet DHN, edhe pse edhe vetë përmendin se shkeljet e DHN-së duhet të ndëshkohen, nuk përcaktojnë dënimet dhe nuk përcaktojnë juridiksionin. Prandaj, mbetet që shtetet të zgjedhin mjetet duke pasur parasysh kushtet specifike në përputhje me DHN-në dhe kulturën e tyre nacionale ligjore.

Deputetët duhet fillimisht të sigurojnë që vendi i tyre i posedon mjetet ligjore për ndëshkimin e shkeljeve të DHN-së. Nëse nuk është rasti i tillë, ato duhet të sigurojnë – me mundësi në kohë të paqes – që ligjet dhe rregullat e shtetit, dhe zbatimi i tyre, të jenë në përputhje me normat e DHN-së. Nëse nuk ekziston një

kornizë ligjore ose nëse korniza ligjore dhe rregullat ekzistuese janë të papërshtatshme, deputetët mund t'i iniciojnë këto çështje para qeverisë, ose të përdorin të drejtën e tyre për të ngritur një iniciativë parlamentare për të korrigjuar situatën.

Debati parlamentar në lidhje me përmbajtjen e ligjit mund vendosë cilat gjykata do të jenë kompetente për të gjykuar shkeljet e DHN-së dhe gamën e juridiksionit, dhe llojin e dënimeve që do të zbatohen.

Parlamenti luan një rol të rëndësishëm në lidhje me administrimin e së drejtës, sidomos në aspekt të:

- Sigurimit që anëtarët e pushtetit gjyqësor të marrin instruksione adekuate për DHN-në;
- Dhënia e mjeteve për gjykatën për të kryer misionin e saj;
- Në rast të krimeve të luftës, të kihet kujdes që sistemi gjyqësor të funksionojë mirë dhe të mos jetë objekt i presionit ose të ketë përzierje nga ana e pushtetit ekzekutiv, dhe drejtësia të administrohet në një afat të arsyeshëm kohor.

Lista e kontrollimit për parlamentarët

- Përkujdesuni që vendi juaj të ketë sjellë një kornizë ligjore për dënimin e shkeljeve të DHN-së dhe kjo kornizë ligjore të jetë e mirënjohur, për shembull duke e shpallur në gazetën zyrtare.
- Përkujdesuni që kjo kornizë ligjore të jetë në përputhje me rregullat e DHN-së. Nëse nuk është kështu, mos hezitoni:
 - t'ju drejtoheni shërbimeve relevante qeveritare për këtë çështje;
 - të parashtroheni pyetje për qeverinë lidhur me këtë çështje;
 - të filloni një debat parlamentar për nevojën e ndëshkimit të shkeljeve të përgjithshme të DHN-së, si dhe shkeljet specifike të cilat nuk janë përfshirë ose nuk janë përfshirë mjaftueshëm me legjislacionin nacional;
 - të njoftoni pushtetin ekzekutiv për nevojën e përndjekjes gjyqësore të shkeljeve të DHN-së;
 - të nisni një diskutim në lidhje me atë se çfarë duhet të përmbajë rregullore ligjore për dënimin e shkeljeve të DHN-së.
- Nëse shteti juaj është nënshkruar i Konventave të Gjenevës, përkujdesuni që të jetë sjellë një kornizë ligjore, e cila:
 - liston dhe dënon shkeljet që përfaqësojnë shkelje të rënda në përputhje me kushtet e përmendura në Konventat;
 - kërkon që njerëzit për të cilët ekziston dyshimi se kanë kryer, urdhëruar apo toleruar shkelje të rënda të Konventave, detyrimisht të kërkojnë, gjykojnë apo ekstradojnë, pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre apo vendin ku është kryer vepra penale.

- Nëse shteti juaj është nënshkruar i Protokollit Shtesë I, përkujdesuni të jetë sjellë korniza ligjore, e cila:
 - liston dhe dënon shkeljet që përfaqësojnë shkelje të rënda në përputhje me kushtet e përmendura në Protokollin I;
 - kërkon që njerëzit për të cilët ekziston dyshimi se kanë kryer, urdhëruar apo toleruar shkelje të rënda të Protokollit I, detyrimisht të kërkojnë, gjykojnë ose ekstradojnë, pa marrë parasysh nacionalitetin e tyre ose vendin ku është kryer vepra penale.
- Nëse vendi juaj është nënshkruar i marrëveshjeve që kufizojnë apo ndalojnë përdorimin e disa armëve, të përkujdesen për t'u miratuar një kornizë ligjore për ndëshkimin e shkeljeve të këtyre marrëveshjeve.
- Në çdo rast dhe pa marrë parasysh kornizën ligjore, përkujdesuni që ligji i miratuar të përmbajë elementet e mëposhtme:
 - të garantojë për çdo person që është gjykuar dhe dënuar për shkelje të DHN-së, të ketë të drejtën e gjyimit korrekt nga një gjykatë e paanshme dhe e rregullt në përputhje me procedurat standarde në përputhje me garancitë gjyqësore të njohura gjerësisht;
 - të përcaktojë natyrën dhe seriozitetin e sanksioneve penale që janë duke e zbatuar;
 - të emërojë trupat përgjegjëse për definimin e aktgjyqimeve dhe për zbatimin e dënimeve; dhe
 - të njohë përgjegjësinë penale individuale, jo vetëm të atyre që kanë kryer shkelje, por edhe të atyre që kanë urdhëruar kryerjen e tyre dhe të atyre që nuk kanë marrë masa adekuate për të penguar personat e rangut më të ulët për t'i kryer ato.

Cili është roli i deputetëve në promovimin e implementimit nacional të DHN-së?

Formimi i trupave nacionale të DHN-së

Komiteti nacional i DHN-së

Implementimi i DHN-së është detyrë e rëndësishme për të cilën janë të nevojshme përpjekje afatgjata. Për këtë qëllim duhet të emërohet një subjekt përgjegjës nacional. Për këtë arsye shumë shtete me sukses kanë formuar trupa specifike të DHN-së, shpeshherë të quajtur komitete nacionale për DHN-në. Për shkak se implementimi i DHN-së është përgjegjësi primare e pushtetit ekzekutiv, këto komitete shpeshherë janë të përbërë nga grupe punues ndër-ministore.

Ato kanë rol konsultativ, pa autorizim për të marrë vendime. Qëllimi i tyre është të japin këshilla dhe të ndihmojnë qeverinë në implementimin dhe përhapjen e njohurive për DHN-në. Në disa vende pushteti legjislativ dhe gjyqësor gjithashtu janë përfaqësuar në këto trupa.

Komitetet nacionale të DHN-së apo trupat e ngjashëm, sigurojnë strukturën formale që garanton koordinimin e përpjekjeve të ministrive të ndryshme (Mbrojtja, Shëndeti dhe Drejtësia) dhe këto iniciativa të ndihmojnë për të harmonizuar legjislacionin nacional me DHN-në në një mënyrë gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe konsekuente.

Nuk ekzistojnë rregulla specifike si të formohet një komitet nacional i DHN-së apo një trup i ngjashëm. Gjëja kryesore është se komiteti duhet të jetë në gjendje për të siguruar këshilla dhe ndihmë efektive për qeverinë lidhur me implementimin dhe politikën nacionale për DHN-në. Kjo mund të bëhet përmes evalvimit të ligjeve ekzistuese, vendimeve gjyqësore dhe dispozitave administrative, paraqitjes së mendime këshillëdhënëse dhe formulimit të rekomandimeve. Komitetet nacionale të DHN-së gjithashtu mund të luajnë një rol të rëndësishëm, duke promovuar dhe përhapur njohuritë për DHN-në.

Një nga mënyrat më të mira për të siguruar efektivitet të komitetit për DHN është të përbëhet nga përfaqësues të domosdoshëm të pushtetit, ndër të cilët, përfaqësues të ministrive që kanë pika takimi me DHN-në, personelin ushtarak, përfaqësues të shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe gjysmëhënës së kuqe dhe ekspertët e DHN-së, të tillë si këshilltarët, doktorët, profesorët universitarë dhe përfaqësuesit e sektorit civil.

Gjithashtu me rëndësi është që komiteti nacional i DHN-së të ketë një status të përhershëm, metoda të punës të përcaktuara qartë dhe resurse të mjaftueshme për të qenë në gjendje që të zbatojë aktivitetet e tij në një plan afatgjatë.

Shtetet nuk kanë detyrim ligjor për të formuar një komitet nacional për DHN-në, por përvoja tregon se trupat e tillë mund të ndihmojnë në mënyrë të konsiderueshme implementimin e DHN-së.

Kontaktimi i komiteve të tjera nacionale të DHN-së

Me dobi të veçantë mund të jetë të kontaktohen komitetet tjera nacionale të DHN-së, sidomos ato që janë në rajonin e njëjtë apo në shtetet me sistem të ngjashëm juridik dhe politik.

KNKK mban listë të komiteve nacionale të DHN-së dhe të trupave të ngjashëm, që është në dispozicion në: https://www.icrc.org/en/document/table-national-committees-and-other-national-bodies-international-humanitarian-law#.VD0gfmd_tWI.

Iniciativa për formimin e një komiteti nacional të DHN-së mund të dalë dhe nga vetë pushteti ekzekutiv. Në këtë rast deputetët thjeshtë duhet të sigurojnë që komiteti të punojë mirë dhe atij t'i sigurohen resurset e nevojshme.

Nëse pushteti ekzekutiv nuk formon një komitet, deputetët mund të marrin aksion për formimin e një trupi të tillë me mjete ligjore ose me presion ndaj pushtetit ekzekutiv për të formuar një trup të tillë.

Lista e kontrollimit për deputetët

- Inkurajoni fuqishëm pushtetin ekzekutiv për të formuar një komitet nacional të DHN-së apo të një trupi të ngjashëm;
- Nëse nuk e bën këtë mos hezitoni dhe:
 - informoni shërbimeve relevante qeveritare;
 - paraqitni çështjen para qeverisë;
 - kërkoni nga përfaqësuesit e qeverisë për të formuar një komitet të tillë.
- Nëse përpjekjet tuaja janë të pasuksesshme, përpiquni për të formuar komitetin me mjete ligjore;
- Nëse shteti juaj ka një komitet nacional të DHN-së, kontrolloni nëse në mandatin e tij janë përfshirë aspektet e mëposhtme, dhe mos hezitoni për të iniciuar këtë çështje dhe për të inkurajuar përfshirjen e këtyre aspekteve nëse tanimë nuk janë përfshirë:
 - detyrimi për të paraqitur raport për çështjet e DHN-së para parlamentit;
 - mundësia për të rekomanduar miratimin e masave ligjore në lidhje me DHN-në;
 - mundësia për të monitoruar implementimin e dispozitave ligjore të DHN-së.
- Pa marrë parasysh se çfarë është situata, lirisht kontaktoni me:
 - komitetin ndërkombëtar të Kryqit të kuq, i cili ka listën e komiteteve nacionale të DHN-së;
 - parlamentet tjerë, që mund të ndajnë përvojat e tyre.

Trupi parlamentar i DHN-së

Për të ndërtuar kapacitetet parlamentare për çështjet e lidhura me DHN-në, deputetët mund të inkurajojnë formimin e një trupi parlamentar që do të punojë në çështjet e lidhura me DHN-në. Nëse nuk është e mundur për të formuar një lloj të tillë të komitetit parlamentar, parlamentarët mund të inkurajojnë formimin e një nënkomiteti apo të ndonjë trupi tjetër në përputhje me procedurën ekzistuese, mandatin dhe procedurat që duhet të përcaktohen qartë. Çështjet që do të shqyrtohen mes tjerash janë çdo aksion që duhet të ndërmerret me komitetet tjera parlamentare (në lidhje me natyrën shumëdisiplinore të DHN-së), lidhjet e veçanta me komitetin nacional të DHN-së dhe mundësia për të zhvilluar seanca.

Parlamentarët gjithashtu mund të inkurajojnë formimin e një grupo jo formal të parlamentarëve, të cilët janë veçanërisht të interesuar për çështjet e lidhura me DHN-në, dhe ky grup të veprojë si forcë lëvizëse për një aksion parlamentar ose si mbrojtës parlamentarë të kësaj fushe. Më në fund, deputetët mund të promovojnë kontakt me trupat tjerë parlamentarë në vende tjera për të ndarë përvojat dhe për të përmirësuar aksionin nacional të përdorimit të praktikave të mira nga të tërët. Bashkimi Ndërparlamentar mund të ndihmojë në këtë aspekt.

Ndërtimi i partneritetit me faktorët relevantë

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Në përputhje me Nenin 1, i përbashkët për Konventat e Gjenevës, shtetet nënshkruese marrin detyrimin për të “respektuar dhe siguruar respektimin e” rregullave të Konventave. Kjo do të thotë se jo vetëm që shtetet duhet të respektojnë DHN-në në kuadër të kufijve të tyre, por ato gjithashtu duhet të sigurojnë respektimin e saj në mbarë botën. Prandaj, bashkëpunimi ndërkombëtar, krahas implementimit nacional, është shumë i rëndësishëm për të siguruar zbatimin e rregullave të DHN-së në veprim.

Në këtë kontekst anëtarët e parlamentit jo vetëm që duhet të kenë parasysh rregullat e përcaktuara në marrëveshjet ndërkombëtare, por ata duhet gjithashtu të debatojnë rreth çështjeve të formave politike multilaterale (shembull, organizatat parlamentare rajonale dhe universale). Kjo është veçanërisht e rëndësishme për zhvillimin e DHN-së. Kjo gjithashtu mund të ndihmojë, direkt ose indirekt, në përgatitjen e rregullave ndërkombëtare.

Komiteti i Bashkimit Ndërparlamentar për promovimin e respektimit të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare – mobilizimi i parlamenteve të mbarë botës për DHN.

Komiteti i Bashkimit Ndërparlamentar për promovimin e respektimit të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare është formuar pas miratimit të rezolutës për respektimin e Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe mbështetjen e veprimit humanitar në konflikte të armatosura në vitin 1993. Qëllimi nismëtar i komitetit ishte të mobilizohen parlamentet dhe komuniteti parlamentar në lidhje me ratifikimin e konventave dhe protokolleve ndërkombëtare të lidhura me DHN-në, dhe implementimi i domosdoshëm që është i nevojshëm në nivel nacional.

Në të vërtetë, komiteti punon në forcimin e veprimit parlamentar, ndërtimin e partneritetit dhe solidaritetit ndërmjet anëtarëve të parlamenteve nëpër tërë botën. Komiteti i Bashkimit Ndërparlamentar ka për qëllim promovimin e respektimit të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare dhe të sigurojë mbrojtje për refugjatët. Ai monitoron ratifikimin e instrumenteve relevante ndërkombëtare dhe implementimin e tyre në nivel nacional. Ai ua bën me dije parlamenteve çështjet që kërkojnë aksion parlamentar dhe mbështet aksionin parlamentar në nivel ndërkombëtar dhe nacional.

Me kalimin e viteve, theks të veçantë vë në çështjet që lidhen me zbutjen e Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, çështjen e personave të zhdukur, mbrojtjen dhe respektimin e refugjatëve dhe të drejtat e tyre; rumbullakimin e çështjes së pa shtetësisë, personat e zhvendosur brenda vendit dhe minat kundër këmbësorisë.

Komiteti përgatit vegla për parlamentet për t'u siguruar atyre mbështetje në punë, si për shembull doracakun për deputetë i përgatitur në bashkëpunim me KNKK ose UNHCR dhe partnerët, që nga fillimi i punës së tij. Kryen misione për thellimin

e të kuptuarit të situatës në terren tek disa kriza humanitare, ku promovohet një përgjigje efektive parlamentare.

Zhvillon seanca me delegacionet parlamentare të vendeve në zonat e krizës ose për çështje specifike që lidhen me DHN-në. Për mobilizimin e komunitetit parlamentar, përgatit raporte vjetore që prezantohen para trupave udhëheqës të Bashkimit Ndërparlamentar dhe mbështet zhvillimin dhe përgatitjen e rezolutave për çështjet që lidhen me DHN-në.

Për të ndihmuar veten në punën e tyre, deputetët mund të gjejnë më shumë informacione për ligjet që lidhen me DHN-në dhe të drejtën zakonore të shteteve nënshkruese të Konventave të Gjenevës në bazën e të dhënave për implementimin nacional të KNKK-së <https://www.icrc.org/ihl-nat>.

Ndihma në efektivitetin e mekanizmave ndërkombëtarë të harmonizimit

Përpjekjet për të siguruar garancitë e nevojshme për viktimat e konflikteve të armatosura gjithashtu mbështeten edhe me mekanizma ndërkombëtarë. Qëllimi i tyre është të sigurohet respektimi i DHN-së dhe ndëshkimi i shkeljeve të DHN-së.

Krahas marrëveshjeve që sigurojnë mbrojtje me gjykatat penale dhe tribunalët ndërkombëtarë ose hibridë (shih “si dënohen shkeljet e DHN-së?” në pjesën 1), Konventat e Gjenevës dhe Protokolli I sigurojnë mekanizma të harmonizimit në rast të një konflikti të armatosur ndërkombëtar. Këto mekanizma përfshijnë edhe sistemin e Forcave Mbrojtëse, procedurën hetimore dhe Komisionin Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve në përputhje me Nenin 90 të Protokollit Shtesë I (shih më poshtë).

Marrëveshjet për armët, përfshirë Konventën për ndalimin e minave kundër këmbësorisë, Konventën për Ndalimin e Disa Armëve Konvencionale dhe Konventën për Municionin Thërrmues, sigurojnë mekanizma raportimi që synojnë harmonizimin e shteteve nënshkruese në lidhje me detyrimet e tyre në përputhje me këto marrëveshje.

Mekanizmat e monitorimit të harmonizimit me DHN-në

Forcat mbrojtëse janë shtete neutrale ose shtete që nuk marrin pjesë në konflikt, dhe janë emëruar nga anash në konflikt dhe janë pranuar nga pala kundërshtare, që kanë pranuar të kryejnë funksione të caktuara për forcën mbrojtëse në përputhje me DHN-në. Këto detyra përfshijnë vizitën e personave të mbrojtur, mbikëqyrjen e misionëve për ndihmën humanitare dhe evakuimet, pranimi i aplikimeve të personave të mbrojtur, sigurimi i ndihmës në procedurat gjyqësore kundër personave të mbrojtur, bartja e informacioneve, dokumenteve dhe ndihmës humanitare, dhe ofrimi i mbështetjes së zyrës. .

Duhet të iniciohen **procedura hetimore** si përgjigje e pohimeve se ekzistojnë shkelje të DHN-së nëse kjo kërkohet nga ndonjëra palë në konflikt dhe nëse palët në fjalë pajtohen në lidhje me procedurën që duhet të ndiqet.

Komisioni Humanitar Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve i formuar në përputhje me Nenin 90 të Protokollit Shtesë I, mund të ngrejë hetim në lidhje me pohimet për shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I dhe të sigurojë ndihmë përmes zyrave të tij në lidhje me ripërtëritjen e respektimit të DHN-së. Komisioni mund të veprojë vetëm nëse shtetet që janë pjesë e procedurës pranojnë kompetencën e Komisionit nëpërmjet dhënies së deklaratës përkatëse. Në situata tjera, Komisioni mund të iniciojë hetim me kërkesë të shtetit palë në konflikt, por vetëm me miratimin e shtetit tjetër ose shteteve në fjalë. Raportet që i paraqet deri te shtetet janë të natyrës së besueshme. Për më shumë informacione për punën e Komisionit, shihni <http://www.ihffc.org/index.asp?Language=EN#page=home>.

Në rast të shkeljeve serioze të DHN-së, shtetet nënshkruese të Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I, duhet **të bashkëpunojnë me Kombet e Bashkuara** dhe të veprojnë në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara.

KNKK gjithashtu luan rol të rëndësishëm në monitorimin e pajtueshmërisë me forcën e mandatit të tij.

Deputetët luajnë një rol të rëndësishëm në lidhje me sigurimin që mekanizmat e pajtueshmërisë të zbatohen në mënyrë aktive në vendin e tyre, veçanërisht përmes inkurajimit të shtetit për të zbatuar këto mekanizma.

Nëse vendi i tyre është nënshkrues i Protokollit Shtesë I, deputetët mund të kujdesen që shteti të japë deklaratë me të cilën pranohet kompetenca e Komisionit Humanitar Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve. Nëse nuk është kështu, deputetët mund t'i parashtrojnë pyetje qeverisë në lidhje me këtë temë, të hapin diskutim parlamentar në lidhje me nevojën për paraqitjen e deklaratës së njohjes (që në mënyrë të konsiderueshme mund të ndihmojë në implementimin e DHN-së), dhe të informojnë publikun për rolin e Komisionit.

Ndërmarrja e hapave praktikë për të siguruar respektimin universal të DHN-në

Mund të ndërmerren një sërë masash të rëndësishme së ndryshme për të siguruar respektimin e DHN-së:

- **Verifikimi i fakteve:** kur rajonet bëhen të paarrtshëm si rezultat i konflikteve, dhe për të shmangur situatën e mos dënimit për shkak të mungesës së informacionit, duhet të bëhen përpjekje për të zbuluar në kuptimin praktik dhe objektiv, nëse DHN-ja është duke u respektuar ose duke u shkelur. Në rastin e dytë duhet të verifikohet, kur, në çfarë rrethanash dhe ku. Një nga mënyrat për të përkujtuar palët në konflikt për detyrimet e tyre, është t'u bëhet me dije se sjellja e tyre është duke u monitoruar dhe vlerësuar në lidhje me Të Drejtën Ndërkombëtare për të verifikuar shkeljet e DHN-së. Në këtë kontekst kredibiliteti politik varet nga besueshmëria e informacioneve. Nuk duhet të ketë asnjë grimë njëanshmëri.

- **Zbatimi i hetimit:** krahas burimeve tradicionale të informimit (dëshmitë e dëshmitarëve, mediumet), mjeti më i sigurt për të vërtetuar pohimet për shkeljet e DHN-së është nëpërmjet fillimit të hetimit. Hetimi mund të jetë në disa forma. Ai mund të jetë një hetim i thjeshtë administrativ ose të rezultojë me krijimin e një komisioni hetues parlamentar.

Komisioni hetues gjithashtu mund të formohet nga organizata rajonale ose universale ndërparlamentare, siç është Bashkimi Ndërparlamentar.

Komisioni Hetues parlamentar gjithashtu mund të formohet për të zbatuar misionet e grumbullimit të informacionit, me ftesën e një shteti tjetër, me qëllim që të fitohet një pasqyrë për një situatë të caktuar.

- **Veprimi pas marrjes së informacionit të besueshëm për të rimëkëmbur situatën:** pasi të janë marrë informacione të besueshme, mund të nis dialogu diplomatik me palët në bazë të këtyre informacioneve. Në të vërtetë, informimi i një shteti se nuk është duke i përmbushur detyrimet në përputhje me DHN-në – ndoshta për shkak se nuk është i vetëdijshëm për këtë ose i mungojnë mjetet për këtë qëllim, mund të jetë hapi i parë në lidhje me ndryshimin e sjelljes.

Nëse dialogu rezulton me korrigjim të situatës, respektimi dhe përfundimet mund të shpallen publikisht për të parandaluar shkelësit e DHN-së të besojnë se shkeljet e DHN-së nuk kanë asnjë ndikim politik. Shpallja publike e pohimeve për shkelje të DHN-së, mund të nxisë pushtetet politike për të vepruar në mënyrë më të përgjegjshme. Përgjithësisht, duhet të inkurajohet debati politik dhe ngritja e ndërgjegjes publike në lidhje me nevojën për të parandaluar shkeljet e DHN-së dhe mënyrën e realizimit të këtyre qëllimeve.

Inkurajimi i pushteteve politike për t'i dhënë fund shkeljeve të DHN-së: parlamentarët mund të luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë aspekt. Ata, për shembull, mund të dënojnë shkeljet e DHN-së me deklarata publike. Megjithatë, debatet publike dhe dënimet nuk janë gjithnjë të mjaftueshme. Nganjëherë nevojitet masa shtrënguese. Këtu përgjegjësinë duhet ta marrin shtetet palë të treta dhe të shfrytëzojnë ndikimin e tyre për të siguruar respektimin e DHN-së. Për shembull, hapi i parë që mund të merret nga një shtet për të ndaluar shkeljet e DHN-së është të bëhet presion diplomatik në formë të protestave. Pasi masat shtrënguese mund dhe duhet të merren në një fazë të mëvonshme.

Roli që e luajnë deputetët ndryshon nga lloji i masave të marra, por deputetë mund të përfshihen në çdo hap të sipërpërmendur.

Lista e kontrollimit për deputetët

- Kontrolloni nëse shteti juaj ka paraqitur deklaratë me të cilën njihen kompetencat e Komisionit Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve (shih deklaratat model në Aneksin 3). Kushtojini vëmendje të veçantë respektimit

të DHN-së në ndonjë konflikt pa marrë parasysh nëse shteti juaj është përfshirë në konfliktin.

- Për këtë arsye mos hezitoni në lidhje me formimin e një “komiteti parlamentar për mbrojtje”, një trup parlamentar (komision apo nënkomision) ose një grup anëtarësh të parlamentit që kanë për detyrë të sigurojnë se:
 - urdhrat e dhëna dhe deklaratat politike nuk përmbajnë asgjë që mund të interpretohet si nxitje të kujtudo për shkelje të DHN-së;
 - çdo shkelje do të dënohet me respektimin e duhur të garancive procedurale.
- Nëse ekziston mundësia, e madje edhe gjasat më të vogla, që DHN është shkelur nga një ose më shumë shtete në një konflikt, merrni parasysh mundësinë:
 - Të kërkonti nga qeveria juaj të kërkojë shpjegim nga shteti për të cilin pohohet se ka kryer shkelje të DHN-së;
 - Të propozojë formimin e një komisioni neutral ose ndërkombëtar parlamentar, me gjasë përmes Bashkimit Ndërparlamentar apo një organizate rajonale ndërparlamentare;
 - Nëse shteti juaj dhe shteti për të cilin ekziston pohimi se ka kryer shkelje të DHN-së kanë paraqitur deklaratë me të cilën pranojnë kompetencën e Komisionit Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve, duhet të kërkonti nga shteti juaj për të thirrur një komision që të zbatojë hetim;
 - Të inkurajoni qeverinë ekzekutive për t'u angazhuar në dialogun diplomatik me shtetin në fjalë në lidhje me informacionet e mbledhura.
- Nëse keni informacione të sigurta për shkeljet e DHN-së, mos hezitoni dhe:
 - Filloni dialogun me autoritetet në bazë të informacioneve të marra.
 - të përfshihen në debatin politik për mënyrën më të mirë për t'i dhënë fund shkeljeve të DHN-së;
 - të nisni një debat parlamentar, përfshirë edhe në kuadër të Bashkimit Ndërparlamentar apo një organizate të caktuar rajonale, për të marrë pikëpamjet e tyre për shkeljet e DHN-së.
- Nëse çdo gjë tjetër dështon, mos hezitoni për të kërkuar nga pushteti ekzekutiv të dalë para shtetit që ka bërë shkelje të DHN-së për të kërkuar respektimin e rregullave të DHN-së.
- Nëse këto përfaqësime dështojnë, mos hezitoni për të kërkuar nga pushteti ekzekutiv të miratojë masa shtrënguese më të forta, të tilla si:
 - forma të ndryshme të presionit diplomatik;
 - mos-rinovimi i privilegjeve ose marrëveshjeve tregtare;
 - zvogëlimin ose suspendimin e ndihmës publike për shtetin për të cilin bëhet fjalë;
 - pjesëmarrjen në çdo masë tjetër të ndërmarra nga organizatat relevante multilaterale rajonale ose universale.

Cilat janë masat tjera të implementimit në përputhje me DHN-së?

Marrëveshjet DHN detyrojnë shtetet për të ndërmarrë një numër të caktuar masash plotësuese për zbatimin në kuptimin e gjerë të fjalës. Kjo reflekton nevojën e përkthimit të DHN-së në legjislacionin nacional, procedurat, politikën dhe infrastrukturën. Këto masa përfshijnë:

- përkthimin e marrëveshjeve të DHN-së në gjuhën nacionale (gjuhët);
- marrja parasysh e DHN-së në zgjedhjen e lokaliteteve ushtarake dhe zhvillimin e armëve dhe taktikave ushtarake;
- të sigurohet që personat e mbrojtur, pasuria dhe vendet të jenë të identifikuar, të shënuara dhe të mbrojtura në mënyrën përkatëse;
- përpunimi i letërnjoftimeve dhe dokumenteve të tjera për personat e mbrojtur;
- sigurimi i lokacioneve për vendosjen e zonave spitalore, zona të neutralizuara dhe zona të demilitarizuara;
- sigurimi i parakushteve për formimin dhe rregullimin e punës së shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëmehënës së kuqe dhe shoqata të tjera të vullnetarëve, organizata të mbrojtjes civile dhe byrove informative civile.

Edhe pse përgjegjësia për miratimin e dispozitave përkatëse qëndron në pushtetin ekzekutiv dhe në ministri të ndryshme, deputetët duhet të përkujdesen për të ndërmarrë masat e domosdoshme në afat të arsyeshëm dhe rregullisht të rivlerësohen, dhe nëse është e nevojshme, të rinovohen.

Lista e kontrollimit për deputetët

- Nëse është e domosdoshme, përkujdesuni për t'u përkthyer të gjitha marrëveshjet DHN, në gjuhën tuaj kombëtare (gjuhët).

Nëse vendi juaj është nënshkrues i Konventave të Gjenevës dhe Protokollet Shtesë:

- Përkujdesuni që personeli mjekësor të jetë identifikuar në mënyrën e duhur dhe:
 - personat të kenë shirita në duart për t'u shënuar se i takojnë personelin mjekësor;
 - personat të kenë letërnjoftime dhe pllaka speciale personale në të cilat do të qëndrojnë emblema.
- Zbuloni sa është përshtatur mirë infrastruktura nacionale për të harmonizuar nevojat e DHN-së, duke u përkujdesur për si vijon:
 - zonat dhe institucionet mjekësore janë të shënuara si të tilla dhe janë identifikuar me ndihmë të emblemës, dhe janë të vendosura në zona që nuk janë në rrezik për të qenë të goditura nga frocat e armatosura;
 - anijet që funksionojnë si anije-spitale gjatë kohës së një konflikti të armatosur janë shënuar si të tilla;
 - avionët mjekësorë janë identifikuar në mënyrën e drejtë;
 - vendet e internimit janë zgjedhur në përputhje me DHN-në;
 - dispozitat e organizimit dhe funksionimit të kampeve të internimit janë në përputhje me DHN-në;
 - rregullimi i brendshëm i kampeve është përcaktuar në përputhje me DHN-në;
 - lokalitetet dhe objektivat ushtarakë nuk gjenden në afërsi të popullsisë civile;
 - zonat ushtarake dhe të sigurisë janë identifikuar si të tilla;
 - automjetet e ambulancës dhe spitalet janë identifikuar qartë me emblemën e Kryqit të kuq ose Gjysmëhënës së kuqe;
 - në rast të konflikteve, menjëherë formohen byro informative për të burgosurit e luftës dhe personat e mbrojtur;
 - ekziston procedurë për të siguruar që armët e reja që janë vënë në përdorim janë në përputhje me DHN-në;
 - ndërtimet dhe instalimet që përmbajnë fuqi të rrezikshme janë identifikuar në mënyrën e drejtë dhe kur është e mundur, nuk janë në afërsi të ndonjë objekti ushtarak;
 - popullsia civile është e larguar nga objektivat ushtarakë;
 - në rast të një konflikti, zonat e demilitarizuara janë shënuar në përputhje me palën armike.
 - bëhuni të sigurt se janë ndërmarrë masat e domosdoshme me arsye

- Përkujdesuni që personeli i kualifikuar dhe këshilltarët juridikë në forcat e armatosura të aftësohen për DHN.

Nëse vendi juaj është nënshkruar i Konventës për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore në Rast të Konfliktit të Armatosur:

- Përkujdesuni që kodi dhe doktrina ushtarake të integrohen në dispozitat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore.
- Përkujdesuni që në mënyrë të duhur të rregullohet përdorimi i shenjës mbrojtëse për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.
- Kontrolloni nëse infrastruktura është adaptuar në mënyrën e duhur dhe përkujdesuni që të mirat kulturore të jenë shënuar në mënyrën përkatëse.

Në të gjitha rastet:

- Nëse përpjekjet e pushtetit ekzekutiv nuk janë të mjaftueshme, mos hezitoni dhe:
 - Parashtroni pyetje për qeverinë;
 - Kërkoni nga pushteti ekzekutiv dhe ministritë relevante për të përshpejtuar procesin e përshtatjes së infrastrukturës;
 - Ndërmerrni edhe masa të tjera përkatëse.
- Nëse është e nevojshme, kërkoni të votohet për një ligj kornizë i cili jep udhëzime për veprim rregullator nga ana e pushtetit ekzekutiv.
- Përkujdesuni që të miratohet një buxhet përkatës për çdo masë për të cilën janë të nevojshme shpenzimet.
- Në rast të një konflikti, përkujdesuni që masat që kanë të bëjnë me zbatimin e DHN-së edhe më tej të respektohen në mënyrë rigoroze.

Çfarë mund të bëjnë deputetët për të ndihmuar aksionin humanitar?

Operacionet humanitare ndërkombëtare zbatohen për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave dhe për zbutjen e vuajtjeve të tyre.

Sipas së drejtës ndërkombëtare, shtetet mbajnë përgjegjësinë themelore për sigurimin e nevojave themelore të civilëve nën kontrollin e tyre. Mirëpo, në qoftë se shtetet nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë për t'i përmbushur detyrimet e tyre, DHN-ja parasheh që aksionet për sigurimin e ndihmës humanitare të ndërmerren nga të tjerët, siç janë për shembull organizatat humanitare, me miratimin e shtetit të prekur. Për të kryer detyrat e tyre, organizatat humanitare duhet të marrin një qasje të shpejtë dhe papenguar për te personat e prekur.

Korniza juridike që ka të bëjë me ndihmën humanitare mund të gjendet në Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë të vitit 1977, si dhe në DHN-në zakonore. Rregullat e DHN-së për qasjen dhe ndihmën humanitare fillimisht bëjnë

verifikimin se veprimet për sigurimin e mbështetjes humanitare duhet të miratohen – por në situatë të okupimit ato duhet të autorizohen – kur popullsia civile nuk ka mjete përkatëse për të mbijetuar. Si e dyta, DHN-ja hollësisht i verifikon kushtet në lidhje me zbatimin e operacioneve të tilla, në lidhje me sigurimin e ndihmës humanitare për popullsinë e prekur.

Detyrimi për të ndërmarrë aksion për sigurimin e ndihmës humanitare

Dispozitat relevante të Protokolleve Shtesë I dhe II theksojnë se aktivitetet për sigurimin e ndihmës humanitare “do të ndërmerren” atëherë kur popullsisë i mungojnë rezervat e domosdoshme për mbijetesën e saj, me çka qartë vendoset detyrimi ligjor. Mirëpo, ato edhe më tej parashikojnë se detyrimi i tillë është objekt i miratimit të shtetit të prekur (përveç gjatë okupimit).

Prandaj, duhet të gjendet balancë ndërmjet dy parakushteve qartë kundërthënëse: nga njëra anë, duhet të ndërmerren masa për sigurimin e ndihmës humanitare, dhe nga ana tjetër duhet të merr pëlqim nga shteti i prekur.

Kushtet për dhënien e pëlqimit dallojnë varësisht nga konteksti:

- Në konfliktet e armatosura ndërkombëtare – kur ato nuk zhvillohen në territoret e okupuara – palët e prekura nuk duhet të heqin dorë nga pëlqimi për shkak të arsyeve të pabaza: çdo pengim i aktiviteteve për ndihmë humanitare duhet të bazohet në arsye të vlefshme. Sidomos, nëse verifikohet se popullsisë civile i kanoset uria dhe nëse organizata humanitare e cila siguron ndihmë humanitare, në bazë jo të njëanshme dhe jo diskriminuese, mund të riparojë situatën, pala e prekur është e obliguar për të dhënë pëlqim.
- Në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare, vlejnë rregullat e njëjta të përmendura më lart. Mirëpo, mbetet të diskutohet nëse do të jetë i nevojshëm pëlqimi nga shteti territorial, nëse ndihma është për civilë në territorin e kontrolluar nga një grup i armatosur jo-shtetëror.
- Në territoret e okupuara, forca okupatore është e detyruar për të siguruar që popullsia të ketë ushqim dhe materiale mjekësore. Veçanërisht, duhet të sigurojë produktet e nevojshme ushqimore, barnatore, dyqane dhe produkte të tjera në qoftë se resurset e territorit të okupuar janë të papërshtatshme. Nëse e tërë popullsia apo një pjesë e saj në territorin e okupuar nuk është furnizuar mjaftueshëm me rezerva, forca okupatore është e detyruar për të dhënë pëlqim për sigurimin e një plani për ndihmë humanitare për popullsinë.

Cilat janë kushtet sipas së cilave duhet të sigurohet ndihma humanitare?

Kompleti i dytë i rregullave ka të bëjë me kushtet nën të cilat duhet të dërgohet ndihma humanitare. Ato janë si vijon:

- **Humaniteti, paanshmëria dhe mos diskriminimi:** dispozitat e DHN-së kërkojnë një ndihmë humanitare që është e paanshme dhe humanitare për nga karakteri dhe që zbatohet pa asnjë diskriminim. Kjo do të thotë,

veçanërisht, se ndihma humanitare duhet t'u jepet gjithë personave që kanë një nevojë të tillë, pa marrë parasysh partinë së cilës i takojnë, dhe pa marrë parasysh religjionin e tyre, gjininë etj.

- **Kontrolli:** palët që nuk lejojnë qarkullimin e ndihmës humanitare mund të kontrollojnë dërgesën e saj, sidomos duke vendosur norma teknike, përfshirë duke përcaktuar dispozita të inspektimit, që rregullojnë këtë qarkullim.

Çfarë mund të bëjnë deputetët për të lehtësuar aksionin humanitar në një konflikt të armatosur?

Ata duhet të bëjnë gjithçka që është e mundshme për të lehtësuar operacionet humanitare të cilat i ndërmarrin organizatat e paanshme humanitare, siç është KNKK. Praktikisht, kjo do të thotë se deputetët duhet:

- të kujdesen që vendi i tyre të përshpejtojë procedurat për personelin humanitar;
- të lehtësojnë transportin në ajër, tokë dhe det;
- të ofrojnë lirime përjashtime nga taksat;
- të sigurohet mbrojtja e personelit humanitar, objektet e tyre dhe ndihma humanitare;
- të hiqen të gjitha pengesat burokratike që pengojnë efikasitetin humanitar;
- të mbështeten operacionet humanitare me para, mallra dhe shërbime.

Si deputetët mund të ulin prekshmërinë e vendeve të prekura nga konfliktet duke siguruar një financim fleksibil, të parashikuar dhe të qëndrueshëm për aksionin humanitar?

Shpërndarja dhe specifika e rritur e nevojave gjatë një aksioni humanitar, që mund të shihet përmes numrit gjithnjë e më të madh të kategorive përfituese (persona të zhvendosur brenda vendit dhe refugjatë) dhe grupe të rrezikuara (viktima të dhunës seksuale, migrues, persona të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuar), shtyu KNKK-në dhe faktorët tjerë humanitarë të ndërmarrin hapa për realizimin e një përgjigjeje përkatëse për nevojat e ndryshme emergjente dhe humanitare. Por gjithsesi do të jetë një sfidë e madhe të realizohet kjo ambicie në vitet e ardhshme, dhe njëkohësisht të respektohen parimet që udhëheqin aksionin e saj neutral, të paanshëm dhe të pavarur humanitar.

Në DHN, aksioni humanitar është përmbledhje e të gjitha aktiviteteve të mbrojtjes dhe bartjes së ndihmës humanitare për personat e prekur nga konfliktet dhe situata të tjera të dhunës. Qëllimi përfundimtar i aksionit humanitar është shpëtimi i jetëve, zbutja e vuajtjeve dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor. Kjo nënkupton aksione afatshkurta dhe afatgjata dhe aktivitete të cilat në rrethana të tjera mund të kuptohen si aktivitete zhvillimore, por të cilat në të vërtetë përfaqësojnë aktivitete për ndihmë humanitare në situata komplekse dhe afatgjata të konflikteve.

Rritja e fundit e financimit të aksionit humanitar u reflektua në nevojat e rëndësishme që dalin nga konfliktet aktuale, por gjithashtu përfaqësojnë një simptomë të pamundësisë së bashkësisë ndërkombëtare për të kapërcyer në

mënyrën e duhur këto konflikte përmes zgjidhjeve të realizueshme, të qeta dhe të qëndrueshme politike. Rezultati është një rreth vicioz i paqëndrueshmërisë dhe konflikteve të përsëritura. Konfliktet krijojnë presione intensive mbi shtetet tanimë të brishta, rrisin prekmërinë e tyre ndaj shokëve (që mund të gjenerohen nga dhuna ose fatkeqësitë natyrore) dhe sjellin gjithnjë e më shumë varfëri, paqëndrueshmëri, kriminalitet dhe dhunë.

Duke marrë parasysh kompleksitetin e tillë, dallimi i rreptë ndërmjet përgjigjes emergjente gjatë kohës së situatave të jashtëzakonshme, rimëkëmbja e hershme pas konfliktit dhe aktivitetet zhvillimore janë kundër-produktive, për shkak se nuk janë në hap me mënyrën në të cilën shumë konflikte përparojnë dhe me situatat e prekshme të cilat i lënë pas vetes. Prandaj, vija e ndarjes ndërmjet ndihmës humanitare dhe mbështetjes zhvillimore është gjithnjë e më shumë artificiale, e madje edhe e dëmshme; nuk pasqyron nevojat dhe rreziqet reale me të cilat përballet popullsia e prekur dhe komunitetet e prekura.

Përgjigjja efektive përbëhet nga reagimi i shpejtë për t'iu përgjigjur nevojave në situatat të jashtëzakonshme, dhe njëkohësisht, investimi në infrastrukturën dhe shërbimet kryesore për të parandaluar përkeqësimin e mëtejshëm të kushteve të popullsisë së prekur. Në shumë situata, aktivitetet për reagim në katastrofa dhe aktivitetet zhvillimore nuk duhet të jenë pasuese, por të njëkohshme. Ato duhet të implementohen në afat të gjatë, me qëllim që të ndërtohen kapacitete të qëndrueshme për ballafaqim.

Sa i takon KNKK, një nga parakushtet më të rëndësishme qëndron në faktin që qeveritë donatore vazhdojnë të bëjnë dallime ndërmjet ndihmës humanitare dhe programet e zhvillimit dhe financimit. Në të vërtetë, aktivitetet afatshkurta dhe afatmesme të organizatës në fushën e shëndetësisë, ushqimit, ujit, sanitetit, institucionet juridike dhe infrastruktura luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e kthimit të problemeve zhvillimore afatgjata, si në shtetet e brishta, ashtu edhe në pjesët e pafavorizuara të shteteve me nivel mesatar të të ardhurave. KNKK i është përkushtuar kësaj qasje të kombinuar në konfliktet afatgjata, duke u përpjekur për të plotësuar nevojat urgjente për shpëtimin e jetëve njerëzore, por njëkohësisht duke bërë përpjekje për të forcuar sistemet e përmbushjes së nevojave afatgjata të njerëzve.

Me qëllim që qasja e kombinuar e KNKK të jetë efektive, sidomos në konflikte të komplikuar, afatgjate, organizata duhet të jetë shumë fleksibile në operacionet e veta. Për të mundur këtë fleksibilitet janë të nevojshme, ndër tjerash, kontribute të papërcaktuara financiare. Mirëpo, presionet e rritura mbi buxhetet nacionale, së bashku me theksimin e dallimit ndërmjet çështjes humanitare dhe financimit zhvillimor, bëhet sfidë kritike në aspektin e sigurimit të përgjigjes humanitare për nevojat gjithnjë e më të mëdha dhe në rritje në planin humanitar.

KNKK-ja është e gatshme për t'u rishikuar, së bashku me pushtetet (për shembull, në bashkëpunim me qeveritë donatore, deputetët), në lidhje me atë si shtetet mund të investojnë në mënyrë më të mençur në ndihmën humanitare. Ekziston një nevojë e qartë për modele të reja të financimit afatgjatë, që do të ndihmojnë në uljen e situatave të prekshme të njerëzve nga situatat e gjata dhe të komplikuar të konflikteve.

Lista e kontrollimit për deputetë

- Njihet nevoja për të riformuluar diskutimin rreth financimit humanitar dhe për të shkuar më larg se ndarja ideologjike dhe teorike ndërmjet ndihmës humanitare dhe asaj zhvillimore. Një diskurs më pragmatik rreth nevojave humanitare afatshkurta dhe afatgjate do të jetë më i përshtatshëm dhe do të ndihmojë për të kapërcyer mjetet për dedikim humanitar dhe për zhvillim.
- Promovimi i nevojës së financimit efektiv humanitar (mjete të papërcaktuara) për mbrojtjen e organizatave humanitare parimore nga kufizimet nga ana e agjendave politike. Mjetet duhet të paguhen në bazë të nevojës dhe në përputhje me një agjendë ekskluzivisht humanitare.
- Mbështetja e aksionit të qëndrueshëm humanitar në konfliktet e armatosura afatgjata për të përmbushur nevojat urgjente për mbijetesën e njerëzve, si dhe mirëmbajtja e nivelit minimal i shërbimeve themelore dhe infrastrukturës (uji, ushqimi, institucionet shëndetësore dhe energjia elektrike) të nevojshme për të siguruar nevojat afatgjata.
- Përmirësimi i njohurive për sfidat humanitare me qëllim të vendimmarrjes më të mirë në lidhje me buxhetet humanitare dhe zhvillimore (shpërndarje, miratime, rritje ose ulje).
- Inkurajimi i debateve parlamentare për çështjet humanitare kyç dhe monitorimi i qëndrimeve të udhëheqjes së KNKK për ndikimin potencial direkt ose indirekt që vendimet tuaja do t'i kenë mbi komunitetet e prekshme në një konflikt të armatosur dhe në situata të tjera të dhunës.
- Njohja e rolit të qasjes së kombinuar humanitare/zhvillimore në parandalimin e humbjes së përfitimeve zhvillimore dhe rëndësia e qasjes së tillë në përmirësimin e gjendjes së komuniteteve të prekshme dhe përmbushja e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm.

Pjesa 3: Qasja e bazuar në temën

Spitali Panzi, Bukavu, Republika Demokratike Kongo. Gra-viktima të dhunës seksuale presin të bisedojnë me një psikolog..©KNKK/ Vojtek Lembrik



DHN-ja dhe terrorizmi

Si DHN-ja trajton terrorizmin?

DHN-ja nuk siguron një definicion për “terrorizmin”, por ndalon shumicën e aksioneve që kryhen në një konflikt të armatosur që zakonisht konsiderohen si “terroriste” nëse kryhen në kohë paqeje. Ato përfaqësojnë vepra të qarta të dhunës, sulme të qëllimshme mbi civilët dhe objektet civile, përdorimi i “mburojës njerëzore”, sulmi mbi faltoret, dhe marrja e pengjeve. Në të vërtetë, gjëja më e rëndësishme për personat që marrin pjesë në një konflikt të armatosur është të bëjnë dallimin ndërmjet civilëve dhe luftëtarëve, që përfaqëson themelin e DHN-së. Përveç kësaj, DHN-ja veçanërisht ndalon “dënimet kolektive dhe masat e ngjashme të (...) terrorizmit” (Neni 33 i Konventës së Katërt të Gjenevës), “veprat terroriste” (Neni 4 i Protokollit Shtesë II) dhe veprat që kanë për qëllim përhapjen e terrorit tek popullsia civile.

Këto dispozita nuk ndalojnë sulmet e lejuara mbi objektivat civile që mund të përhapin frikë tek civilët, por janë të ndaluara sulmet që kanë qëllim veçanërisht për të terrorizuar popullsinë civile. Veprat që janë përmendur më lart gjithashtu mund të përfaqësojnë krime të luftës që në mënyrë universale duhet të përndiqen nëpërmjet rrugës gjyqësore. Duhet të theksohet se rregullat DHN që ndalojnë llojet e sulmeve mbi civilët dhe objektet civile e sipërpërmendura, zbatohen në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare. Veprat terroriste mund të ndodhin gjatë kohës së një konflikti të armatosur ose në kohë paqeje.

Për shkak se DHN-ja zbatohet vetëm gjatë kohës së një konflikti të armatosur, ajo nuk përshin veprat terroriste apo mënyrën në të cilën shtetet reagojnë ndaj veprave terroriste të kryera në kohë paqeje. Veprat e tilla janë objekt i së drejtës nacionale

dhe ndërkombëtare, sidomos Ligji i Të Drejtave të Njeriut. Mirëpo, nëse lufta kundër veprave të terrorizmit merr formën e një konflikti të armatosur (ose, arrin shkallën e një konflikti të armatosur), atëherë DHN-ja zbatohet mbi veprat e kryera në lidhje me atë konflikt të armatosur, dhe reagimi i shteteve duhet të jetë i harmonizuar me rregullat e DHN-së. Në të vërtetë, si pjesë e detyrimeve të tija DHN, shtetet duhet të pengojnë dhe dënojnë veprat terroriste që përfaqësojnë krime të luftës.

Pikëpamja e KNKK-së në lidhje me “luftën kundër terrorizmit”

Kur përdoret forca e armatosur, vetëm faktet në terren janë relevante për të përcaktuar klasifikimin juridik të situatës së dhënë. Disa situata mund të klasifikohen si konflikt i armatosur ndërkombëtar, dhe të tjerat si konflikt i armatosur jo-ndërkombëtar, ndërsa disa vepra të dhunës ndoshta nuk do të ngjisin prapën për t'u kualifikuar si konflikte të armatosura. KNKK nuk ndan pikëpamjen se masat dhe operacionet që ndërmerren në nivel ndërkombëtar për të parandaluar dhe luftuar sulmet terroriste, shpeshherë të quajtura “lufta globale kundër terrorizmit”, me të vërtetë përfaqësojnë luftë globale.

Në bazë të fakteve në dispozicion dhe zbatimin e DHN-së në lidhje me këto fakte, KNKK beson se nuk është duke u zhvilluar në momentin, e as që ka pasur viteve të fundit një konflikt të armatosur të karakterit global, e as ndërkombëtar ose jo-ndërkombëtar. KNKK përdor qasjen për të rishikuar dhunën sipas parimit rast pas rasti dhe kujdeset që DHN-ja të zbatohet vetëm aty ku dhuna arrin shkallën e konfliktit të armatosur. Aty ku nuk është kështu, zbatohet degë të tjera të së drejtës. Në të vërtetë, KNKK nuk ndan pikëpamjen se zbatimi i DHN-së shkon jashtë territorit të palëve në konflikt në mënyrën që u mundëson targetimin e individëve të bëjnë pjesë në forca të armatosura të caktuara anembanë botës.

Për shkak se “terrorizmi” është dukuri komplekse që nuk është e thënë të jetë e lidhur, e as të dalë nga një konflikt i armatosur, më e përshtatshme është të flitet për një “luftë në shumë aspekte kundër terrorizmit”. Shikuar përgjithësisht, shtetet mund të ndërmarrin disa masa për të parandaluar dhe dënuar veprat terroriste, si për shembull mbledhjen e informacioneve të kundërzbulimit, bashkëpunimi gjyqësor dhe policor, ekstradimi, sanksionet penale, hetimet financiare, ngrirjen e mjeteve dhe presionin diplomatik dhe ekonomik mbi shtetet e akuzuara për ndihmën që ua japin terroristëve të dyshuar. Shumica e këtyre masave, zakonisht nuk konsiderohen si veprime të luftës.

Terrorizmi dhe aksioni humanitar

Disa grupe jo-shtetërore të përfshira në konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare, janë vënë në listën e shteteve, organizatave rajonale ose Kombeve të Bashkuara si organizata terroriste. Për të çrregulluar financimin e organizatave të tilla, shtetet kanë miratuar ligje dhe politika ndërkombëtare dhe nacionale që thonë se është vepër penale sigurimi i “mbështetjes”, “shërbimit” dhe/ose “ndihma” për njerëzit ose grupet e përfshira në veprat terroriste, ose “qëllimisht të jesh në lidhje me” njerëz ose grupe të tilla.

Edhe pse përmbajtja dhe fusha e saktë e shkeljeve penale në lidhje me këtë çështje dallon nga njëri shtet në tjetrin, shumica e shteteve kanë miratuar një definicion të gjerë për veprat e tilla penale, që mund të zbatohet në çdo aktivitet humanitar që përfshin kontakt me njerëz ose organizata që vihen në lidhje me terrorizmin. Kjo ka një efekt të ftohtë mbi aktivitetet humanitare, me çka potencialisht inkriminohen disa faktorë humanitare dhe krijohen pengës për financimin e punës humanitare.

Inkriminimi i aksionit humanitar është veçanërisht i papajtueshëm me mandatin e KNKK-së, i cili në përputhje me Nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës, mund të ofrojë shërbimet e veta për palët në një konflikt të armatosur jo-ndërkombëtar, përfshirë dhe grupet e armatosura jo-shtetërore. Përveç kësaj, kjo është në kundërshtim me parimin e neutralitetit të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (KNKK dhe komponentët tjerë të Lëvizjes nuk do të jenë neutralë nëse duhet të marrin anë në një konflikt të armatosur) dhe parimi i paanshmërisë (për shembull, nëse KNKK apo një shoqatë nacionale e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe nuk është në gjendje për të siguruar shërbime mjekësore për njerëzit që i përkasin ose që janë nën kontrollin e një grupi “terrorist” jo-shtetëror). Masat që miratohen nga qeveritë për dënimin penal të veprave terroriste duhet të përgatiten në mënyrën që nuk pengon aksionin humanitar.

- Legjislacioni që formulon veprat penale në “mbështetje materiale”, “shërbim” dhe “ndihmë” ose “asociacion” me personat ose grupet e përfshira në terrorizëm, nga fusha e veprave duhet të përjashtojë aktivitetet që janë dedikuar vetëm për qëllime humanitare dhe që zbatohen pa bërë dallime armiqësore.
- Kur shtetet fusin klauzola anti-terroriste në marrëveshjet e financimit, ato duhet t’i formulojnë ato në mënyrë që nuk çon në kufizimin e financimit të organizatave humanitare dhe me qëllim që të mundësohet puna e papenguar e faktorëve neutralë, të pavarur dhe të paanshëm humanitarë.
- Duhet të dihet se mandati i KNKK-së mundëson kontakte me grupet e armatosura jo-shtetërore dhe se masat për ndëshkimin e aktiviteteve ose ligjeve të tilla, me të cilat përgjithësisht inkriminohet “shërbimi” ose “mbështetja” e terrorizmit, mund të dëmtojnë aksionin humanitar të KNKK në situatat ku forcat e armatosura janë pjesë e një konflikti të armatosur jo-ndërkombëtar, janë etiketuar si “organizata terroriste”.

Cili është roli i deputetëve?

Deputetët duhet të sigurojnë që ligjet dhe rregullat për implementimin e tyre në vendin të jenë në përputhje me normat e DHN-së lidhur me vepra të terrorizmit. Veçanërisht, duhet të sigurohet që shteti të ketë ligje efektive me të cilat do të dënohen shkeljet e DHN-së, përfshirë dhe krimet e luftës, dhe legjislacioni nacional të sigurojë përgjigje të duhur të shtetit kundër veprave terroriste në përputhje me rregullat e DHN-së.

Deputetët gjithashtu duhet të kujdesen që legjislacioni i tyre në luftën kundër terrorizmit të jetë mjaftueshëm specifik për të mos inkriminuar apo penguar

aksionin humanitar dhe për të siguruar mbështetje përkatëse, përshirë dhe mjetet financiare nga an e qeverisë për të mbështetur aktivitetet e faktorëve humanitarë.

Nëse nuk ekziston një kornizë ligjore ose nëse rregullat ekzistuese nuk janë të përshtatshme, deputetët duhet të ndërmarrin të gjitha masat relevante për të përmirësuar situatën, përfshirë dhe ngritje të procedurës te qeveria, iniciativa parlamentare dhe debate në lidhje me përmbajtjen e ligjit.

Në lidhje me masat joligjore të luftës kundër terrorizmit, edhe pse përgjegjësia për miratimin e dispozitave qëndron tek pushteti ekzekutiv dhe ministritë e ndryshme që janë përgjegjëse për këtë qëllim, deputetët mund të kujdesen që masat e ndërmarra të jenë të kënaqshme, në pajtueshmëri me detyrimet e shtetit në përputhje me DHN-në dhe DNDNj-në, dhe të kujdesen për një rishikim të rregullt, dhe nëse është e nevojshme ripërtëritjen e tyre.

Lista e kontrollimit për deputetë

- Përkujdesuni që vendi juaj të ketë miratuar kornizën ligjore anti-terroriste, që është në përputhje me rregullat e DHN de DNDNj, veçanërisht në lidhje me dënimin e shkeljeve të DHN-së, përshirë dhe veprat e terrorizmit që përfaqësojnë krime të luftës.
- Përkujdesuni që korniza juaj ligjore anti-terroriste të mos pengojë aksionin humanitar, dhe:
 - të përjashtojë një numër të caktuar shkeljesh në lidhje me “mbështetjen materiale”, “shërbimin” dhe “ndihmën” ose “asociacionin” me persona dhe grupe të përfshira në terrorizëm, aktivitete që janë vetëm për qëllime humanitare dhe që zbatohen pa bërë dallime armiqësore.
 - të njeh mandatin e KNKK-së në lidhje me grupet e armatosura jo-shtetërore dhe veçanërisht të përjashtojë aktivitetet e KNKK-së në fushën e shkeljeve penale të përmendura më lart.
- Nëse nuk ekziston një kornizë ligjore ose ajo është e pamjaftueshme, mos hezitoni të:
 - inicioni këtë çështje para shërbimeve relevante qeveritare;
 - të parashtroni pyetje për qeverinë në këtë temë;
 - të filloni një debat parlamentar në lidhje me nevojën për lehtësimin e aksionit humanitar dhe për të dënuar veprat e terrorizmit si shkelje të DHN-së në mënyrë që është konsekuente me rregullat e DHN-së;
 - të nisni një diskutim në lidhje me përmbajtjen që duhet të përmbajë korniza ligjore për çështjen e veprave të terrorizmit.
- Përkujdesuni që masat e ndërmarra nga pushteti ekzekutiv për luftë kundër terrorizmit të jenë të përshtatshme në lidhje me DHN-në dhe DNDNj-në.
- Përkujdesuni që të sigurohet një mbështetje e kënaqshme për organizatat humanitare. Sidomos, sigurohuni që qeveria juaj të mos vendosë kushte “anti-terroriste” ose kufizime për financimin e kontratave të donatorëve. Nëse futen dispozita të tilla, përkujdesuni që të inkorporohen klauzola që të

mund të futen përjashtime për të mos u penguar sigurimi i shërbimeve humanitare.

- Nëse përpjekjet e pushtetit ekzekutiv nuk janë të mjaftueshme, mos hezitoni dhe:
 - paraqitni çështjen para qeverisë;
 - iniciatori çështjet para pushtetit ekzekutiv dhe ministritë relevante në lidhje me rregullat e DHN-së të rregullojnë veprat terroriste;
 - ndërmerri çdo masë tjetër adekuate..
- Nëse është e domosdoshme kërkon që të votohet ligji kornizë në të cilin do të përmbahen udhëzimet e aksionit rregullativ për pushtetin ekzekutiv.

Përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale gjatë kohës së konflikteve të armatosura

Ndalesa kundër dhunës dhe formave të tjera të dhunës seksuale në përputhje me DHN-në

Nëpër tërë historinë, dhuna seksuale është e përhapur gjerësisht në konfliktet e armatosura dhe në të shpesh shihet si një pasojë e pashmangshme e luftimit. Përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale vazhdojnë të jenë një fenomen tmerrues me pasoja të dëmshme për viktimat – gra, burra, djem dhe vajza – si dhe për familjet e tyre dhe komunitetet e tëra. Termi “dhunë seksuale” përdoret për të përshkruar veprat e natyrës seksuale të imponuara me forcë, ose detyrim siç është frika nga dhuna, detyrimi, parburgimi, dhuna psikologjike ose keqpërdorimi i fuqisë drejtuar ndaj çdo viktime, burrë, grua, djalë ose vajzë. Shfrytëzimi i avantazhit të mjedisit të detyrueshëm ose pamundësia e viktimës për të dhënë miratimin e vërtetë gjithashtu është një formë e detyrimit. Dhuna seksuale përfaqëson përdhunimin, skllavërinë seksuale, prostitucionin e detyruar, shtatzëninë e detyruar, sterilizimin e dhunshëm dhe forma të tjera të dhunës seksuale të vëllimit të konsiderueshëm.

Veprat e tilla rrallë përfaqësojnë një rast të izoluar. Ato shpeshherë paraqiten në prani të keqpërdorimit dhe dhunës më të madhe, ndër të cilat dhe vrasja, rekrutimi i fëmijëve, shkatërrimi i pasurisë dhe plaçkitja. Dhuna seksuale mund të përdoret si formë e reprezaljeve, për të shkaktuar frikë ose si formë e torturës. Gjithashtu mund të përdoret në mënyrë sistematike, si metodë e luftimit, dedikuar shkatërrimit të strukturës shoqërore.

Përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale, kur kryhen në kontekst të një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose jo-ndërkombëtar, përfaqësojnë shkelje të DHN-së. Në përputhje me detyrimin e tyre për të respektuar dhe siguruar respektimin e DHN-së, shtetet duhet të pengojnë dhe të inkriminojnë përdhunimin tek format tjera të dhunës seksuale në sistemet nacionale juridike. Shtetet gjithashtu kanë për detyrë të hetojnë dhe të zhvillojnë procedura gjyqësore, ose nëse është i tillë rasti, të ekstradojnë kryerësit e veprave të tilla penale, dhe të sigurojnë për viktimat qasje deri te kujdesi shëndetësor, drejtësia dhe rimëkëmbja.

Përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale janë të ndaluara me të drejtën e marrëveshjes (Konventa e Katërt e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë I dhe II) dhe me të drejtën zakonore që zbatohet në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare.

Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare përfshin përdhunimin dhe format tjera të dhunës seksuale në listën e krime të luftës dhe në listën e veprave që përbëjnë krime kundër njerëzimit kur kryhen si pjesë e një sulmi të gjerë dhe sistematik drejtuar ndaj çdo popullsie civile.

Përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale gjithashtu mund të përbëjnë edhe vepra të tjera penale ndërkombëtare. Përdhunimi zakonisht përbën torturim, për shembull kur qëllimisht imponohet nga ana e një nëpunësi shtetëror me qëllim që të detyrojë viktimën për të pranuar një gjë.

Dhuna seksuale gjithashtu mund të përbëjë vepër të gjenocidit, kur imponohet si masë për parandalimin e lindjeve në kuadër të grupit, për shembull përmes gjymtimit seksual ose sterilizimit. Përdhunimi gjithashtu mund të jetë masë e dedikuar për parandalimin e lindjes së fëmijëve, siç është rasti me shoqëritë patriarkale ku gruaja qëllimisht lihet shtatzënë nga një burrë i një grupi tjetër etnik me qëllim që të lind fëmijë që nuk i përket grupit të nënës.

Shtetet duhet të ndërmarrin masa për të siguruar ndalesë kundër përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale dhe kjo të inkorporohet në sistemin vendor juridik. Kur vepra e dhunës ose një formë tjetër e dhunës seksuale përkon me shkeljet e rënda të Konventave të Gjenevës ose Protokollit Shtesë I (si për shembull, torturimi, trajtimi jonjerëzor ose shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha ose të lëndimit serioz në trupin dhe shëndetin e njeriut), deputetët duhet të kërkojnë hetim dhe ngritjen e procesit gjyqësor kundër kryerësve të këtyre veprave në përputhje me sistemin për trajtimin e shkeljeve të rënda të kësaj natyre.

Më tej, në përputhje me DHN-në zakonore, shkeljet serioze të DHN-së në konfliktet e armatosura ndërkombëtare ose jo-ndërkombëtare, përfaqësojnë krime të luftës me ç'rast shtetet nënshkruese të 4 Konventave të Gjenevës kanë të drejtë për t'u thirrur në juridiksionin universal. Për këtë arsye, deputetë kanë të drejtë të kërkojnë thirrjen dhe zbatimin e një juridiksioni të tillë.

Cili është roli i deputetëve?

Me qëllim që të sigurohet pajtueshmëri me detyrimin për të respektuar DHN-në, nga shtetet kërkohet të kryejnë diseminimin e DHN-së, përfshirë dhe ndalesën kundër përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale. Deputetët duhet të marrin pjesë në këtë proces. Diseminimi duhet të zbatohet në kohë paqeje dhe në kohë lufte, dhe duhet të përfshijë të paktën, personelin ushtarak, nëpunësit shtetërorë dhe nëpunësit policorë. Ndalimi i përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale duhet të ligjërohet në kuadër të trajnimeve ushtarake dhe të jetë e përfshirë në doracakët ushtarakë dhe policorë ose në dokumente ekuivalente me to.

Është shumë e rëndësishme të sigurohet për viktimat që kanë përjetuar përdhunim ose forma të tjera të dhunës seksuale, qasje për te ndihma mjekësore psikosociale dhe psikologjike. Deputetët nëpërmjet masave të ndryshme duhet të ndihmojnë për të siguruar shërbime të tilla pa ndërhyrje dhe duke respektuar parimin e besueshmërisë mjekësore. Përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale janë gjendje emergjente mjekësore me pasoja potencialisht të rënda fizike dhe psikologjike për viktimat. Prandaj, është shumë e rëndësishme për viktimat të sigurohet qasje e pakusht për te kujdesi i mirë, cilësor, në kohë të duhur dhe i paanshëm mjekësor në afat prej 72 orësh për të ulur, për shembull rrezikun nga infektimet.

Deputetët gjithashtu duhet të kujdesen për të siguruar ndihmë ekonomike për viktimat për të siguruar një përmbushje të drejtpërdrejtë të nevojave themelore për shkak se përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale në një konflikt të armatosur mund të kenë efekte katastrofale mbi jetën e viktimave, përfshirë dhe aftësinë e tyre për të fituar dhe për të siguruar ekzistencën e mëtejshme normale.

Deputetët duhet të punojnë për t'u siguruar viktimave që kanë përjetuar përdhunim dhe forma të tjera të dhunës seksuale që të mund të kërkojnë të drejtën pa asnjë pasojë të padëshiruar për ta. Për këta persona duhet të sigurohet qasja për te avokati dhe të jenë në gjendje për të iniciuar seanca – në rrethana ideale, falas, por nëse kjo është e mundshme, për një çmim të arsyeshëm. Shërbimet policore, prokuroria dhe gjykatat duhet të aftësohen në mënyrë përkatëse për të qenë në gjendje që të përballen me prekmërinë specifike të viktimave nga përdhunimi dhe format tjera të keqpërdorimit seksual.

Deputetët duhet të kujdesen për të siguruar masa mbrojtëse, të tilla si seanca të mbylla dhe deklarata me shkrim për viktimat që të sigurohet një gjykim i drejtë dhe një proces në kohë të duhur. Në përputhje me DHN-në dhe DNDNj-në, varësisht nga zbatimi, duhet të sigurohet rimëkëmbja e viktimave.

Lista e kontrollimit për deputetë

- Përkujdesuni që përdhunimi dhe format tjera të dhunës seksuale të ndalohen në nivel nacional.
- Përkujdesuni që ligjvënia vendore të sigurojë hetim efektiv dhe dokumentim etik të dhunës seksuale me qëllim që të sigurohet qasja për te drejtësia për viktimat dhe të nxirren kryerësit e veprës para drejtësisë.
- Përkujdesuni që shteti juaj të kryejë disemnimin e DHN-së, përfshirë dhe ndalesën kundër përdhunimit dhe dhunës seksuale.
- Përkujdesuni që legjislacioni vendor të urdhërojë shërbimet policore, prokurorinë dhe gjykatat për t'u aftësuar në mënyrë përkatëse që të jenë në gjendje për t'u ballafaquar me gjendjet e prekshme specifike të viktimave të përdhunimit dhe të formave të tjera të dhunës seksuale. Përkujdesuni që të bëhet implementimi i masave në nivel nacional për të siguruar një mbrojtje dhe ndihmë efektive për viktimat që kanë mbijetuar një përdhunim dhe forma të tjera të dhunës seksuale. Masat duhet të sigurojnë si vijon:

- sigurimin e qasjes së papenguar për te shërbimet mjekësore, psikosociale dhe psikologjike, pa ndërhyrje dhe duke respektuar besueshmërinë mjekësore;
- mbrojtja nga përdhunimi dhe format tjera të dhunë seksuale sigurohet përmes adresimit në aspekt të sigurisë;
- siguri i ndihmës dhe programeve socio-ekonomike për rimëkëmbjen e viktimave;
- qasja e viktimave që kanë përjetuar një përdhunim apo formë të tjerë të dhunës seksuale për të drejtësi pa pasoja të padëshiruara.

Për më shumë informacione për keqpërdorimin seksual në konflikte të armatosura, ju lusim shihni në:

KNKK, “parandalimi dhe përndjekja penale e përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale gjatë kohës së një konflikti të armatosur”, në dispozicion në: <https://www.icrc.org/en/document/prevention-and-criminal-repression-rape-and-other-forms-sexual-violence-during-armed>

KNKK, “pyetje dhe përgjigje: dhuna seksuale në një konflikt të armatosur”, në dispozicion në: <https://www.icrc.org/en/document/sexual-violence-armed-conflict-questions-and-answers>

Mbrojtja e shëndetit në situatat e konfliktit

Standardet juridike të mbrojtjes për sigurimin e kujdesit shëndetësor

Gjatë kohës së një konfliktit të armatosur, DHN-ja siguron rregulla për sigurimin e qasjes për te kujdesi shëndetësor. Këto rregulla janë të detyrueshme për shtetet dhe grupet e armatosura jo-shtetërore. Në situatat që nuk e kanë arritur shkallën e një konflikti të armatosur, zbatohen vetëm DNDNJ-ja dhe legjislacioni nacional. Në parim, DNDNJ-ja zbatohet në çdo kohë, edhe pse shtetet mund të heqin dorë nga përdorimi i saj..

Dhuna – dhuna e kryer dhe kanosja për dhunë – kundër personelit shëndetësor, objekteve dhe transporteve mjekësore gjatë kohës së një konfliktit të armatosur, dhe situatat tjera emergjente, është e përhapur gjerësisht dhe ka pasoja për individët, familjet dhe komunitetet e tëra. Duke pasur parasysh numrin potencial të njerëzve të prekur dhe efektet në lidhje me nevojat afatgjata dhe akute, kjo është me gjasë një nga çështjet më serioze humanitare që duhet të zgjidhet nga bashkësia ndërkombëtare.

Sipas DNDNJ-së, shtetet nënshkruese të marrëveshjeve relevante, në të gjitha rrethanat (në kohë paqeje dhe në kohë të një konflikti të armatosur), kanë për detyrë të respektojnë funksionimin e sistemit shëndetësor. Ato gjithashtu duhet të sigurojnë qasje të duhur për te institucionet më të rëndësishme shëndetësore, mallrat dhe shërbimet, qasje për te ushqimi, strehimi themelor, strehimi dhe saniteti, dhe siguri i sasive të përshtatshme të ujit të pijshëm të sigurt dhe ilaçeve

të nevojshme. Në këtë rast, ato duhet të respektojnë parimet e mos diskriminimit dhe të qasjes së barabartë. Shtetet duhet të dizajnojnë dhe implementojnë strategji për shëndetin publik. Dispozita të ngjashme ekzistojnë në DHN me të cilat kërkohet nga shtetet për të siguruar ushqim dhe ilaçe për popullsinë.

Edhe pse DHN-ja dhe DNDNj-ja u mundësojnë shteteve për të përmbushur detyrimet e tyre në përputhje me resurset e arritshme, mungesa e resurseve nuk arsyeton mos ndërmarrjen e aksionit. Kur resurset janë të kufizuara në mënyrë ekstreme, shtetet duhet të miratojnë programe që nuk kushtojnë shumë para dhe me të cilat mund të përfshijnë anëtarët më të prekshëm dhe më të marginalizuar të popullsisë.

Të plagosurit dhe të sëmurët dhe personeli shëndetësor nuk duhet në mënyrë arbitrare të vriten ose të trajtohen në mënyrën e padëshiruar. Sipas DHN-së, të gjitha palët në konfliktin e armatosur kanë detyrim themelor për të siguruar për të plagosurit dhe të sëmurët kujdes dhe vëmendje mjekësore aq sa lejon situata pa bërë asnjë lloj diskriminimi dhe me vonesa sa më të vogla të mundshme.

Nga kjo del se kujdesi dhe vëmendja mjekësore duhet të sigurohen pa marrë parasysh palën të cilës i takon i plagosuri ose i sëmuri dhe pa marrë parasysh racën, religjionin, bindjen politike dhe përkatësinë tjetër të personit. Dallimi mund të bëhet vetëm në bazë mjekësore. Në fund, askujt nuk duhet qëllimisht të mos i jepet ndihmë mjekësore.

Mbrojtja specifike që sigurohet me DHN-në për personelin mjekësor, njësitë dhe mjetet e transportit, del nga detyrimet themelore për respektimin, mbrojtjen, mbledhjen dhe kujdesin e personave të plagosur dhe të sëmurë. Për shembull, për shkak se detyrimi për të siguruar kujdes adekuat për të plagosurit dhe të sëmurët nënkupton dhe dorëzimin e tyre deri te njësia mjekësore ose transferimi deri te vendi ku ata mund të trajtohen siç duhet. Ndërmarrja e masave arbitrare që pengojnë qasjen e tyre për te kujdesi shëndetësor, shkelin këtë detyrim.

Personeli mjekësor, objektet mjekësore dhe shërbimet e transportit – ushtarake ose civile – të angazhuara vetëm për detyra humanitare, nuk duhet sulmuar, dëmtuar apo lënduar në asnjë mënyrë dhe në asnjë kohë. Prandaj gjatë armiqësive, sulmet e qëllimshme ndaj tyre dhe sulmet jo diskriminuese ndaj tyre janë të ndaluara në bazë të detyrimit për respektimin dhe mbrojtjen e tyre.

Ndalohen gjithashtu sulmet që mund të shkaktojnë lëndimeve të tepërta të incidenteve për personelin mjekësor, objektet dhe mjetet e transportit lidhur me qëllimin të bëhet avantazh direkt dhe konkret ushtarak. Shtetet të cilat janë nënshkruese të marrëveshjeve të DHN-së kanë për detyrë të parandalojnë dhe dënojnë këto sulme kundër personave të mbrojtur dhe instalimeve.

Qasja për te objektet shëndetësore dhe transportet mjekësore nuk duhet të jetë e kufizuar në mënyrë arbitrare dhe qasja nuk duhet të refuzohet për sa të jetë e mundur kjo. Sipas DHN-së, detyrimi për të respektuar personelin mjekësor, objektet dhe mjetet e transportit që kanë funksion vetëm mjekësor, gjithashtu do të thotë se aftësia për të kryer këto funksione nuk është penguar në mënyrë të

tepruar; kjo nënkupton ndalim të pengimit arbitrar të qarkullimi të personelit mjekësor dhe mallrave.

Në fund, shtetet gjithashtu duhet të sigurojnë implementimin nacional dhe diseminimin e ligjeve dhe rregulloreve ndërkombëtare me përdorimin tregues dhe mbrojtës së emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq, përfshirë dhe rregullat për parandalimin dhe dënimin e keqpërdorimit të emblemave.

Cili është roli i deputetëve?

Shumica e vendeve konsiderojnë kujdesin shëndetësor si të drejtë kushtetuese dhe kanë miratuar rregullore ligjore për qasje për te kujdesi shëndetësor, si dhe rregullore për funksionimin e sistemit të mbrojtjes shëndetësore dhe ligje e akte përkatëse që zbatohen në situata specifike, të tilla si katastrofat natyrore dhe situatat tjera emergjente. Mirëpo, në shumicën e rasteve, kornizat normative nuk përcaktojnë fushën e zbatimit, për shkak se në mënyrë eksplicite nuk kanë të bëjnë me situatat e konfliktit të armatosur dhe situatat tjera emergjente, prandaj mbasin përgjithësisht të përgjithshme në qëllimin e tyre.

Deputetët së këtejmi kanë rol kyç në propozimin e amendamenteve të kornizës ekzistuese ligjore, dhe futjen e projekt-propozimeve dhe parashtrimin e pyetjeve për qeverinë në temën mbrojtja e kujdesit shëndetësor në situata të një konflikti të armatosur dhe në situata të tjera emergjente. Masat e ndryshme në të cilat mund të marrin pjesë ata janë përshkruar më poshtë.

Duhet të bëhet implementimi i masave juridike dhe rregullatore në lidhje me mbrojtjen e emblemave në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë, por gjithashtu edhe në lidhje me mbrojtjen në nivel vendor të të plagosurve dhe të sëmurëve, personelit shëndetësor dhe objekteve shëndetësore dhe transportit mjekësor.

Kur është fjala për përdorimin e emblemave mbrojtëse të mbrojtura me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë, shteti është përgjegjës për parandalimin e keqpërdorimit dhe autorizimin e përdorimit të emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq. Shteti duhet të rregullojë përdorimin e tyre në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë. Për këtë arsye, shtetet duhet të bëjnë implementimin e ligjeve dhe rregulloreve ndërkombëtare me rolin mbrojtës dhe tregues të emblemave dhe të bëjnë promovimin e këtyre ligjeve dhe rregulloreve. Ato gjithashtu duhet të forcojnë masat e kontrollit për përdorimin e emblemave dhe mekanizmave për parandalimin e keqpërdorimit të tyre. Shtetet gjithashtu duhet të ndërmarrin masa të caktuara për të parandaluar keqpërdorimin e emblemave nga ana e forcave të armatosura.

Deputetët duhet të kujdesen për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme lidhur me përdorimin e emblemave mbrojtëse.

Lista e kontrollimit për deputetë

Të plagosurit dhe të sëmurët, personeli shëndetësor, objektet shëndetësore dhe mjetet e transportit

- Inkurajoni organet kompetente relevante për të vendosur një sistem nacional për mbledhjen e të dhënave për shembuj të dhunës mbi personelin shëndetësor, objektet shëndetësore, transportin mjekësor dhe pacientët.
- Kërkoni nga pushteti ekzekutiv dhe deputetët tjerë të përfshihet e drejta e kujdesit shëndetësor në kushtetutën e shtetit.
- Përkujdesuni që kodi penal dhe e drejta administrative të dënojnë shkeljet e së drejtës ndërkombëtare lidhur me mbrojtjen e kujdesit shëndetësor dhe të ekzistojnë sanksione përkatëse për çdo sulm apo vepra të tjera të dhunës mbi punonjësit shëndetësorë.
- Përkujdesuni që masat të implementohen në nivel nacional për të siguruar një sistem efektiv për ngritjen e përgjegjësisë penale individuale dhe për dënimin e veprave penale të kryera mbi të plagosur dhe të sëmurë, personelin mjekësor, njësitë mjekësore dhe transportet mjekësore.
- Përkujdesuni që legjislacioni nacional të kërkojë identifikimin e duhur për personelin mjekësor, dhe veçanërisht ata:
 - të kenë shirita në krah me të cilat do të identifikohen si personel mjekësor;
 - të keni pllaka të veçanta identifikimi në të cilat do të qëndrojnë emblema mbrojtëse.
- Përkujdesuni legjislacioni nacional të sigurojë që infrastruktura nacionale të jetë në përputhje me DHN-në dhe:
 - zonat dhe objektet mjekësore të shënohen dhe identifikohen në mënyrën e duhur me ndihmën e emblemes, dhe të vendosen në zonat ku nuk janë në rrezik për të qenë të goditur nga operacionet ushtarake dhe struktura e tyre të jetë e përgatitur siç duhet;
 - anijet që funksionojnë si anije-spitale gjatë një konflikti të armatosur të shënohen qartë për këtë qëllim;
 - avionët mjekësorë duhet të identifikohen qartë;
 - mjetet e ambulancës dhe spitalet qartë të identifikohen me emblema.
- Kërkoni nga pushteti ekzekutiv dhe deputetët tjerë të bëjnë implementimin e masave për të siguruar që forcat e armatosura dhe të sigurisë, nëpunësit shtetërorë, personeli shëndetësor dhe popullsia përgjithësisht të aftësohen ose në një mënyrë tjetër të njihen me çështjet lidhur me DHN-në dhe dispozitat përkatëse të legjislacionit vendas.

Emblemat (shih “cilat masa praktike mund të ndërmarrin deputetët për të siguruar implementimin e DHN-së në nivel nacional?”)

- Përkujdesuni për të miratuar masat e brendshme, përfshirë dhe ato ligjore, të identifikimit dhe rregullimit të përdorimit të emblemeve mbrojtëse që janë

të mbrojtura me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë që janë të njohura dhe të mbrojtura nga shteti; verifikoni cilat organe të pushteti janë kompetente për të rregulluar dhe ndjekur përdorimin e emblemave; vendosni cilat subjekte kanë të drejtë për të përdorur emblemën; dhe identifikoni nevojën për të cilën është e nevojshme marrja e lejes.

- Përkujdesuni për të miratuar rregulloren ligjore me të cilën ndalohet dhe dënohet përdorimi i paautorizuar i emblemave mbrojtëse dhe emrat e tyre në çdo kohë të çdo forme të përdorimit personal ose komercial dhe të ndalohet imitimi ose dizajnët që mund të çojnë në gabim në lidhje me emblemat.
- Nëse shteti juaj ka ligj për emblemën nacionale:
 - përkujdesuni ligji nacional të mos përfshijë vetëm mbrojtjen e emblemave por gjithashtu edhe mbrojtjen e të plagosurve dhe të sëmurëve, punonjësit shëndetësorë dhe objektet shëndetësore, dhe transportet mjekësore.
- Përkujdesuni për të siguruar trajnim për zbatimin e DHN-së dhe DNDNj-së për personelin e kualifikuar dhe këshilltarët juridikë të forcave të armatosura.
- Nëse përpjekjet e pushtetit ekzekutiv nuk janë të mjaftueshme, mos hezitoni dhe ndërmerrni hapat e mëposhtme:
 - iniciatori çështjet te qeveria;
 - hapni një debat parlamentar;
 - kërkon mbështetje nga publiku;
 - qasuni pushtetit ekzekutiv dhe ministrive relevante me qëllim që të përshpejtohet përshtatja e infrastrukturës së nevojshme;
 - ndërmerrni çdo masë të nevojshme.
- Nëse është e domosdoshme bëni thirrje që të votohet një ligj kornizë për sigurimin e udhëzimeve për aksionin rregullator për mbrojtjen e kujdesit shëndetësor, veçanërisht në situata të konfliktit, nga ana e pushtetit ekzekutiv.
- Përkujdesuni për të miratuar një buxhet të mjaftueshëm për çdo masë për të mbuluar shpenzimet e nevojshme.
- Në rast të një konflikti përkujdesuni që masat e vendosura për zbatimin e DHN-së të zbatohen në mënyrën e duhur dhe të respektohen në mënyrë konsekuente.

Për më shumë informacione në lidhje me implementimin nacional të rregullave për mbrojtjen e sigurimit të kujdesit shëndetësor në konflikt të armatosur dhe situata të tjera emergjente, ju lusim të shihni dokumentet e mëposhtme:

KNKK, "Implementimi i rregullave për mbrojtjen e sigurimit të kujdesit shëndetësor në një konflikt të armatosur dhe situata të tjera emergjente", Aneksi 0 i udhëzimit, Implementimi Nacional i DHN-së në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/implementation-rules-protecting-provision-health-care-armed-conflicts-and-other-emergencies>

KNKK, Korniza vendore normative për mbrojtjen e kujdesit shëndetësor, në dispozicion në

<https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/p4215.htm>

KNKK, “Respektimi dhe mbrojtja e kujdesit shëndetësor në një konflikt të armatosur dhe në situata që nuk janë përfshirë me të drejtën humanitare ndërkombëtare, në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/respecting-and-protecting-health-care-armed-conflicts-and-situations-not-covered>

KNKK, “Mbrojtja e emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq”, në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/protection-red-cross-red-crescent-and-red-crystal-emblems-factsheet>.

DHN-ja dhe sfida e teknologjive të reja

Viteve të fundit shumë teknologji të reja janë futur në fushëbetejë, që çoi në paraqitjen e mjeteve dhe metodave të reja të luftimit siç janë sulmet Sajber, dronët dhe robotët e armatosur (që përfshijnë armë autonome). Ndonëse, nuk duhet të ketë dyshim se DHN-ja i referohet atyre, zbatimi i rregullave të mëparshme ligjore ekzistuese për teknologjitë e reja rezulton me sfida të reja që lidhen me pajtueshmërinë.

Shqyrtimet e reja juridike të mjeteve dhe metodave të reja të luftës

Në përputhje me Nenin 36 të Protokollit Shtesë I, çdo shtet që është palë në konflikt është e nevojshme për të bërë vlerësim nëse përdorimi i armëve dhe metodave të reja të luftës që i studion, zhvillon, i merr dhe i miraton, në ndonjë mënyrë është i ndaluar me të drejtën ndërkombëtare, përfshirë dhe DHN-në. Ky detyrim zbatohet në të gjitha armët e reja si dhe në mënyrën në të cilën ato duhet të përdoren. Gjithashtu, kjo çështje është veçanërisht relevante duke pasur parasysh zhvillimin e shpejtë të teknologjive të reja të luftës sidomos të atyre që mbështeten mbi teknologjitë informative dhe robotikën.

Qëllimi i Nenit 36 është të parandalohet përdorimi i armëve që shkelin të drejtën ndërkombëtare në çdo rrethanë dhe të imponohen kufizime në lidhje me përdorimin e armëve që shkelin të drejtën ndërkombëtare në disa rrethana, përmes verifikimit të ligjshmërisë së tyre para se të jenë zhvilluar, marrë apo inkorporuar në një mënyrë tjetër në arsenalin ushtarak shtetëror.

Neni 36 është plotësuar me Nenin 82 të Protokollit Shtesë I që kërkon këshilltarët juridikë të jenë gjithmonë në dispozicion për sigurimin e këshillave të komandantëve ushtarakë në lidhje me rregullat që dalin nga DHN-ja dhe “sigurimin e instruksioneve të duhura për forcat e armatosura në këtë temë”.

Shtetet kanë interes për të bërë vlerësimin e ligjshmërisë së armëve të reja, përfshirë dhe teknologjitë e reja të luftimit, pa marrë parasysh nëse janë nënshkruese të Protokollit Shtesë I. Shqyrtimet legale janë të rëndësishme thelbësore dhe një masë e domosdoshme që u mundëson shteteve për t’u harmonizuar me

DHN-në nëpërmjet sigurimit që forcat e tyre të armatosura të jenë në gjendje për të kryer veprimet ndaj kundërshtarit në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare. Kjo qasje gjithashtu mund të ndihmojë për të siguruar që armët e reja të mos përdoren para kohe nën kushte që nuk mund të garantojnë respektimin e DHN-së.

Për më shumë informacione në lidhje me atë se si shtetet mund të vendosin apo të përmirësojnë procedurat e verifikimit të ligjshmërisë së armëve dhe metodave të reja të luftimit në përputhje me Nenin 36 të Protokollit Shtesë I të Konventave të Gjenevës, shihni *Udhëzimin për shqyrtimin legal të armëve, mjeteve dhe metodave të reja të luftës: masat për implementimin e Nenit 36 të Protokollit Shtesë I të vitit 1977, në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/p0902.htm>.*

Lufta Sajber

Nuk ekziston një definicion profesional për termin “Luftimi Sajber”, që përdoret nga ana e njerëzve të ndryshëm për të shënuar gjëra të ndryshme. Termi Luftimi Sajber përdoret në këtë rast për operacionet kundër një kompjuteri ose një sistemi kompjuterik nëpërmjet bazës së të dhënave kur përdoret si mjet apo metodë e luftimit në kontekst të një konflikti të armatosur në përputhje me DHN-në.

Deri sot, Lufta Sajber për fat të mirë nuk ka pasoja humanitare katastrofale. Mirëpo, nëse sulmohen, infiltrohen ose ndërmjetësohen kompjuterët ose rrjetat e shtetit, popullsia civile mund të jetë privuar nga nevojat thelbësore siç janë uji i pijshëm, kujdesi mjekësor dhe energjia elektrike. Edhe pse potenciali ushtarak në hapësirën Sajber akoma nuk është kuptuar plotësisht mirë, duket se në mënyrë teknike janë të mundshme sulmet Sajber kundër instalimeve infrastrukturore që janë të rëndësishme për mirëqenien e popullsisë, ose kundër sistemeve të transportit, pendëve ose centraleve bërthamore. Sulmet e tilla mund të kenë pasoja me ndikim të gjerë mbi mirëqenien, shëndetin dhe jetën e qindra mijëra njerëzve.

Përveç kësaj, duke pasur parasysh lidhshmërinë e hapësirës Sajber, pala sulmuese nuk do të jetë në gjendje për të bërë dallimin ndërmjet sistemeve kompjuterike ushtarake dhe civile në fillimin e një sulmi Sajber. Në të vërtetë, do të jetë e pamundshme të kihet për qëllim vetëm rrjetat kompjuterike ushtarake. Gjithashtu mund të jetë vështirë për të vlerësuar efektet e shkaktuara mbi rrjetat civile në një sulm të rrjetave kompjuterike ushtarake.

Lidhshmëria e rrjetave ushtarake dhe civile është një sfidë praktike në lidhje me mbrojtjen e civilëve nga rreziku nga Lufta Sajber. Kjo sfidë potencon rëndësinë, shtetet të kenë kapacitete të caktuara për luftimin Sajber – për qëllime ofensive ose defensive – për të bërë vlerësimin e ligjshmërisë në përputhje me DHN-në. Fundja, fakti që një kapacitet ose aftësi ushtarake nuk është rregulluar në mënyrë specifike, nuk do të thotë se mund të përdoret pa asnjë kufizim. Si tek çdo teknologji e re që përdoret si mjet ose metodë e luftës në një konflikt të armatosur, Lufta Sajber i nënshtrohet kufizimeve që dalin nga DHN-ja, veçanërisht në lidhje me ndalesën e sulmeve të drejtpërdrejta mbi objektet civile dhe ndalesën e sulmeve selektive dhe jo proporcionale. Kjo nuk do të thotë se shtetet nuk duhet

të zhvillojnë më tej ligjin për shkak se teknologjitë evoluojnë. Këtë duhet ta përcaktojnë shtetet.

Armët autonome

Gjatë 15 viteve të fundit, ka një zhvillim të rëndësishëm dhe përdorim të sistemeve robotike nga ana e forcave të armatosura. Këtu janë përfshirë sistemet e ndryshme ushtarake pa njeri që veprojnë në ajër, në tokë dhe në ujë (në dhe nën det). Ndonëse rritja e vazhdueshme në sofistikimin e makinerisë ushtarake dhe distanca fizike e ushtarëve në fushëbetejë është dukuri e vjetër pothuaj sa edhe luftërat, zhvillimi i fundit i robotikës dhe kompjuterëve kombinuar me nevojat operative ushtarake, gjithnjë e më shumë zvogëlon nevojën e pranisë së drejtpërdrejtë të njeriut dhe kontrollit mbi sistemet e armatosura dhe përdorimit të forcës.

Nuk ekziston një definicion i përbashkët çfarë janë sistemet autonome të armëve⁷, por propozohen definicione të ndryshme për një sistem armësh që mund të përzgjedhë dhe të sulmojë objektivat në mënyrë të pavarur. Në bazë të kësaj, KNKK propozoi “sisteme autonome të armëve” si term ombrellë që do të përfshinte çdo sistem të armëve, pa marrë parasysh nëse funksionon në ajër, në tokë ose det, në mënyrë autonome me “funksionet e veta thelbësore” – që do të thotë se arma mund të përzgjedhë (kërkojë ose zbulojë, identifikojë dhe monitorojë) dhe të angazhohet në (zbulon, përdor forcë kundër, neutralizon, dëmton ose shkatërron) caqe pa intervenimin e njeriut. Pas aktivizimi inicial, vetë sistemi i armëve, duke përdorur sensorë, programe dhe armë, zbaton vënien në shënjestër dhe ndërmarrjen e aksionit që normalisht kontrollohen nga ana e njeriut.

Duke pasur parasysh teknologjinë momentale robotike vështirë është të supozohet që sistemet autonome të armëve mund të përdoren në përputhje me DHN-në. Kjo veçanërisht është e vërtetë në qoftë se këto armë duhet të kryejnë detyra më komplekse dhe të shpërndahen në mjedise dinamike që deri tani nuk është kështu.

Sfidat kryesore janë nëse këto sisteme të armëve do të jenë të aftë në mënyrë autonome të bëjnë dallimin ndërmjet caqeve ushtarake dhe objekteve civile, ndërmjet luftëtarëve dhe civilëve dhe luftëtarëve aktivë dhe ata që tanimë nuk janë pjesë e konfliktit të armatosur. Një sfidë tjetër kyç është nëse armët mund të programohet për të zbuluar dhe vlerësuar shumë fakte dhe variabla kontekstuale që janë të nevojshme për të verifikuar nëse sulmi mund të rezultojë me viktima civile të incidentit dhe/ose dëm të objekteve civile ose kombinimin e gjërave të tilla, që do të tejkalonte nevojat në lidhje me realizimin e një avantazhi konkret dhe direkt ushtarak, në përputhje me rregullin e proporcionalitetit. Gjithashtu, mbetet një sfidë e madhe të programohet arma për të anuluar ose për të ndaluar sulmin nëse bëhet e qatë se objektivi nuk është cak ushtarak por objekt i mbrojtjes së veçantë dhe se sulmi mund të pritët se do të çrregullojë rregullin e proporcionalitetit në përputhje me rregullat për masat e kujdesit gjatë sulmit.

Prandaj, në lidhje me sistemet ushtarake autonome dedikuara për përdorim në situatat kur ekzistojnë gjasat të hasin në persona dhe objektiva të mbrojtur,

⁷ Terminologjia që përdoret për të përshkruar sistemet e tilla përfshin dhe “sisteme autonome vdekjeprurëse të armëve”, “robotët vdekjeprurës autonomë” dhe “robotët vrasës”

ekzistojnë dyshime serioze nëse është teknikisht e mundshme të programohen armët për të zbatuar vlerësime komplekse që varen nga konteksti në përputhje me rregullat e DHN-së për distinkcion, proporcionalitet dhe masa të kujdesit gjatë sulmit. Këto janë vlerësime cilësore natyrale ku rezonimi dhe gjykimi i njeriut do të vazhdojnë të jenë të nevojshëm.

Duke pasur parasysh këto sfida, aftësia për të zhvilluar dhe përdorur sistemet ushtarake autonome që i plotësojnë rregullat DHN në të gjitha skenarët dhe situatat e mundshme është shumë larg që të ndodh në të ardhmen e afërt. Prandaj duket se është e qartë se do të jetë i nevojshëm një kontroll dhe mbikëqyrje e plotë e njeriut në lidhje me selektimin e objektivave dhe sulmeve për të siguruar respektimin e DHN-së. Shkalla dhe lloji i kontrollit të njeriut për të siguruar një mbikëqyrje të duhur që të sigurohet se sistemi autonom i armëve është në përputhje me DHN-në, do të varet nga disa faktorë, përfshirë ndër ta dhe llojin e sistemit, detyrat që duhet t'i kryejë, mjedisi në të cilin duhet të përdoret dhe lloji i caceve për të cilat është programuar për t'i sulmuar.

Pa marrë parasysh pajtueshmërinë në lidhje me DHN-në, çështja themelore në diskutimet rreth sistemeve autonome të armëve është nëse parimi i humanitetit dhe ndërgjegjja publike do të lejojnë që makinat të marrin vendime për jetën dhe vdekjen në një konflikt të armatosur pa angazhimin e njeriut. Debatet që po zhvillohen viteve të fundit ndërmjet shteteve, ekspertëve, sektorit civil dhe publikut, tregojnë se ka pakënaqësi të madhe me idenë për sistem armësh që nuk kontrollohet nga njeriu.

Dronët

Duhet bërë dallimin ndërmjet armëve autonome dhe dronëve – gjithashtu të njohur si automjete ajrore pa pilot ose fluturake të pilotuara me telekomandë – të cilat janë armë që kontrollohen me telekomandë. Dronët zakonisht i drejton dhe kontrollojnë një ekipi i cili ndodhet jashtë zonës së luftës. Për momentin për të funksionuar droni është e nevojshme të ekzistojnë operatorë njerëzorë për të selektuar caqet dhe për të aktivizuar, drejtuar dhe gjuajtur me këtë armë.

Përdorimi i dronëve inicioi shumë çështje dhe debate. Ithtarët për përdorimin e tyre pohojnë se ata i bëjnë sulmet më precize që rezultojnë me më pak viktima dhe më pak shkatërrime. Por gjithashtu konfirmohet se sulmet me dron gabimisht vrasin ose lëndojnë civilë në shumë raste. Kjo çështje akoma është objekt i debatit para së gjithash për shkak të mungesës së informacionit në lidhje me efektet e shumicës së sulmeve me dron. Më tej, ndikimi potencial psikologjik i dronëve sjell brengosje tek shumica e organizatave humanitare, ndër të cilat dhe KNKK.

Cili është niveli i stresit që e imponojnë dronët? Cilat janë pasojat e ekzistimit të tyre të vazhdueshëm në qiell mbi shëndetin mental të njerëzve që jetojnë në zonën? Për fat të keq, jo gjithmonë janë në dispozicion informacionet e dorës së parë, sidomos kur dronët përdoren në zona ku për shkak të sigurisë është vështirë për të bërë një vlerësim të pavarur dhe bazik në lidhje me ndikimin e tyre.

Sipas DHN-së, nuk ekziston një rregull ose ndalesë specifike për fluturaket e pilotuara me telekomandë. Si tek fluturaket e luftës të cilat i drejtojnë njerëzit,

përdorimi i tyre udhëhiqet nga rregullat për sjellje në armiqësi, dhe nuk ka asgjë specifike për dronët që do të pengojë këto rregulla që të zbatohen në përdorimin e dronëve në një konflikt të armatosur.

Përgjegjësia për respektimin e DHN-së qëndron tek operatorët e dronëve, komandantët e tyre dhe pala në konflikt të cilës i përkasin. Për dallim nga kjo duke se përdorimi i dronëve në fushën e punës policore mund të lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, duke pasur parasysh kufizimet rigoroze në lidhje me përdorimin e forcës së ushtruar nga ana e policisë..

Cili është roli i deputetëve?

Në Protokollin Shtesë I të Konventave të Gjenevës, nuk është përcaktuar si do të kryhet shqyrtimi i armëve dhe metodave të reja të luftës. Prandaj, çdo shtet është përgjegjës për miratimin e masave të domosdoshme administrative, rregullatore dhe masa të tjera. Pa dallim të mekanizmit të shqyrtimit që do të zgjidhet, shtetet inkurajohen për të miratuar një qasje shumëdisiplinore që do të marrë parasysh, në përputhje me situatat, sigurimin e këshillave nga ekspertë ushtarakë, juridikë, mjekësorë, shkencorë dhe ekspertë përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Ata gjithashtu duhet të zbatojnë këtë shqyrtim qysh në fazën më të hershme të mundshme, si për shembull gjatë studimit dhe zhvillimit të armës ose metodës së re të luftës, ose gjatë sigurimit ose miratimit të armës ose metodës së re të luftës. Sido që të jetë, shqyrtimi duhet të ndodhë para se arma ose metoda të fillojë të përdoret.

Në vendet ku ekzistojnë komitetet nacionale të DHN-së, deputetët mund të inkurajojnë komitetin për të mbështetur miratimin e procedurave nacionale të shqyrtimit (shih “cili është roli i deputetëve në inkurajimin e implementimit nacional të DHN-së?” në pjesën 2).

Çështje të konsiderueshme procedurale që duhet marrë parasysh gjatë vendosjes së mekanizmit për shqyrtim, janë verifikimi i çështjes cili organ shtetëror do të jetë përgjegjës për shqyrtimin, kush duhet të marrë pjesë në procesin e shqyrtimit, fazat e procesit zhvillimor kur planifikohet shqyrtimi, dhe procedurat lidhur me vendimmarrjen dhe mbajtjen e të dhënave. Verifikimi i procedurës formale do të thotë vendosja e një mekanizmi të përhershëm që do të jetë i gatshëm për t’u përdorur për zbatimin e shqyrtimeve të armëve të reja gjithmonë kur armët e tilla do të studiohen, merren ose miratohen. Deputetët duhet të kujdesen që të gjitha çështjet relevante të merren parasysh kur do të përcaktohen mekanizmat e shqyrtimit.

Mekanizmi i shqyrtimit mund të vendoset nga ana e një reparti qeveritar dhe të jep llogaridhënie për të, repart ky që do të jetë përgjegjës për studimin, zhvillimin, marrjen ose miratimin e armëve të reja, dhe kjo zakonisht është ministria e mbrojtjes ose një shërbim ekuivalent. Nga ana tjetër mekanizmi i shqyrtimit mund të formohet nga ana e vetë qeverisë dhe të zbatohet nga ana e një trupi ndërmjet agjencive. Pa marrë parasysh cili është trupi që do të krijojë mekanizmin e shqyrtimit, duhet kushtuar vëmendje që trupi të jetë i aftë për të kryer punën e tij

në mënyrë të paanshme, në përputhje me ligjin dhe në bazë të ekspertizës profesionale..

Deputetët mund të japin propozime dhe të kërkojnë që shqyrtimi të jetë i pavarur me cilësinë dhe kredibilitetin e nevojshëm. Ata gjithashtu luajnë rol të rëndësishëm në sigurimin, armët të jenë në përputhje të plotë me DHN-në, përmes insistimit për një qasje multidisiplinare të shqyrtimit. Kjo do të thotë mbështetje në këshillat e ekspertëve ushtarakë, juridikë, mjekësorë dhe ekspertët e mjedisit jetësor, si dhe specialistët e robotikës dhe teknologjisë informative.

Deputetët gjithashtu duhet të kujdesen që pushteti ekzekutiv të bëjë shqyrtimin qysh në fazën më të hershme të mundshme, për shembull gjatë studimit ose zhvillimit të armëve ose metodave të reja ose gjatë marrjes së tyre ose miratimit (por sidoqoftë, para përdorimit të tyre).

Përgjegjësia për zbatimin e shqyrtimit mund të jepet për një trup special ose një komiteti të përbërë nga përfaqësues të përhershëm të sektorëve dhe reparteve relevante. Deputetët inkurajohen për të marrë pjesë në komitetet dhe trupat përgjegjëse për shqyrtimin e armëve të reja. Pa marrë parasysh nëse organi i shqyrtimit është një individ ose një komitet, duhet të ketë kualifikimet e nevojshme, duke përfshirë njohuritë dhe kuptimin e plotë të DHN-së.

Secili organ përgjegjës për studimin, zhvillimin, marrjen modifikimin ose miratimin e armës duhet të deklarohet për çështjen para organit të shqyrtimit për fazat e caktuara të shqyrtimit. Kjo mund të bëhet, për shembull, përmes lajmërimit ose kërkesës për mendim këshillëdhënës ose për shqyrtim. Përveç kësaj, organi përgjegjës i shqyrtimit mund të jetë i autorizuar për të ndërmarrë vlerësim që mund të vijë me iniciativën e tij.

Lista e kontrollimit për deputetë

- Zbuloni sa mirë është vendosur infrastruktura nacionale për pajtueshmëri me DHN-në duke siguruar:
 - ekzistimin e procedurës së verifikimit që çdo armë e re e futur në përdorim është në përputhje me DHN-në;
 - procedura e kontrollimit të armëve të reja mbështetet në mendimin e këshilltarëve të kualifikuar juridikë, si dhe në mendimin e ekipit shumëdisiplinor të ekspertëve.
- Përkujdesuni që organet dhe trupat shtetëror përgjegjës për zhvillimin dhe/ose furnizimin me armë të reja, të dorëzojnë në kontroll armën e re në përputhje me procedurën e vendosur.
- Përkujdesuni që personeli i kualifikuar dhe këshilltarët juridikë në forcat e armatosura të aftësohen në mënyrën e duhur për të zbatuar DHN-në, sidomos në lidhje me rregullat për zhvillimin dhe përdorimin e armëve dhe metodave të reja të luftës.
- Nëse nuk ka të përcaktuar organ për kontroll ose nëse nuk funksionon mirë ose nëse nuk sigurohen këshillat e duhura, atëherë duhet:
 - iniciatori çështjen para qeverisë;
 - qasuni pushtetit ekzekutiv dhe ministrive relevante për të përshpejtuar masat e nevojshme të përmirësimit;
 - ndërmerri çdo masë tjetër të duhur.
- Nëse është e nevojshme, kërkoni votimin e ligjit kornizë në të cilin do të merren udhëzime për aksionin rregullator nga ana e pushtetit ekzekutiv.
- Përkujdesuni për të siguruar buxhet të mjaftueshëm për çdo masë për të cilën janë të nevojshme shpenzime.

Në rast të një konflikti, përkujdesuni që masat e marra të sigurojnë pajtueshmëri me DHN-në dhe të zbatohet në mënyrën e drejtë dhe të respektohen në mënyrë rigorozë. Më shumë informacione për DHN-në dhe teknologjitë e reja janë në dispozicion në: <https://www.icrc.org/en/war-and-law/weapons/ihl-and-new-technologies>.

Gjithashtu mund të konsultoni dokumentet e mëposhtme:

“Teknologjitë e reja dhe luftimi” botim i Rishikimit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq (ton 94, Numri 886, verë 2012), në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/international-review/review-886-new-technologies-warfare/index.jsp>

KNKK, “Armët e reja” në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/new-weapons-factsheet>

“Luftimi Sajber: kanosje serioze për paqen dhe sigurinë globale”, rezoluta është miratuar në Kuvendin e 132-të, prill i vitit 2015, në dispozicion në <http://www.BNP.org/conf-e/132/res-1.htm>.

Aktivitetet humanitare dhe mbrojtja e të dhënave personale

Përdorimi i të dhënave personale në kontekstin humanitar

Gjatë kryerjes së aktiviteteve humanitare, faktorët humanitarë janë të obliguar për të mbledhur dhe përpunuar informacione që përmbajnë të dhëna personale. Këto informacione dhe të dhëna mund të përmbajnë të dhëna jashtëzakonisht të ndjeshme për akuzim për keqpërdorim dhe dhunë, dhe zbulimi i tyre mund të rezultojë me një rrezik të madh për viktimat, dëshmitarët, familjet e tyre dhe njerëzit që i mbledhin. Gjithashtu, kjo do të përfaqësojë shkelje të së drejtës së tyre të privatësisë, dhe mbrojtje të të dhënave personale. Prandaj është e rëndësishme që punëtorët humanitarë t'i ruajnë të dhënat personale.

Mbrojtja e të dhënave personale e viktimave në konflikte të armatosura dhe situata të tjera të dhunës, është pjesë integrale e mbrojtjes dhe sigurimit të ndihmës për këta persona.

Aktivitetet në të cilat KNKK- dhe shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe vijnë në posedim të të dhënave personale janë:

- Vendosja e lidhjeve familjare;
- Mbrojtja e individëve në paraburgim;
- Respektimi i DHN-së;
- Sigurimi i ndihmës mjekësore dhe shërbimet ortopedike;
- Aktivitetet forenzike;
- Dekontaminimi i armëve;
- Sigurimi i sigurisë ekonomike;
- Aktivitetet për sigurimin e ujit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës;
- Arkivimi.

Cili është roli i deputetëve

Baza juridike për përpunimin/transferimin

Sipas ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale, të dhënat personale mund të përpunohen vetëm në bazë të bazave specifikeve juridike. Baza më e njohur juridike përgjithësisht është pajtueshmëria, por mund të ketë edhe të tjera. Ligjet për mbrojtjen e të dhënave, gjithashtu sigurojnë kufizime për transferimin e të dhënave personale në vende të treta dhe organizata ndërkombëtare.

Qasja deri te të dhënat personale të viktimave të mundshme të konflikteve të armatosura dhe të situatave të tjera të dhunës, është kyç për të siguruar se KNKK dhe komponentët tjerë të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe janë në pozitë për të kryer mandatin e tyre në kuadër të DHN-së dhe Statutit të Lëvizjes.

Viktimat e konflikteve të armatosura dhe të situatave të tjera të dhunës, të dhënat e të cilëve mund të jenë të nevojshme për arsye humanitare nuk mund të jenë në pozitë për të siguruar pëlqim. Për shembull, ndoshta ata janë veçuar nga familjet e tyre dhe janë duke u kërkuar, ose evidentohen si të zhdukur, të pavetëdijshëm ose shumë të prekshëm për të qenë në gjendje që të marrin një vendim plotësisht të lirë dhe të informuar për përpunimin e të dhënave të tyre personale.

Parlamentarët për këtë arsye duhet të mbështesin vendosjen e bazave të tjera juridike, përveç asaj të pajtueshmërisë për qasje deri tek të dhënat dhe për të siguruar se ekziston qartësi e mjaftueshme në ligjin se bazat e tilla juridike alternative përfshijnë aktivitetet humanitare, duke përfshirë dhe ato që kryhen në përputhje me DHN-në dhe Statutin e Lëvizjes.

Parlamentarët, gjithashtu, duhet të sigurojnë që transferimi i të dhënave deri te vendet e treta dhe organizatat ndërkombëtare të jetë i lejuar në raste të tilla.

Të dhënat që i nënshtrohen sigurimit të qasjes

Ligjet për mbrojtjen e të dhënave përgjithësisht sigurojnë të drejtën e subjektit të të dhënave – ose, personi në fjalë – kontrolluesi i të dhënave të ketë qasje për te të dhënat personale që ruhen për atë person. Kufizimet e kësaj të drejte përgjithësisht janë të lejuara në bazë të interesit publik dhe/ose mbrojtje e interesave vitalë të subjektit të njëjtë bartës i të dhënave dhe/ose një person tjetër.

Besueshmëria është me rëndësi thelbësore për të marrë qasje dhe për të mbrojtur njerëzit që janë në rrezik ose të prekur nga dhuna dhe/ose konflikti i armatosur. Për shembull, për të mbajtur qasjen e punës, që përfshijnë besueshmëri dhe privilegj përkatës për mos zbulimin e informacioneve të besueshme sipas të drejtës ndërkombëtare.

Kjo mund të kërkojë nga KNKK për kufizuar të drejtat e subjekteve të të dhënave për qasje deri te raportet e besueshme që përmbajnë të dhënat e tyre personale, kur raportet e tilla janë përfshirë me privilegjin për mos zbulimin e të dhënave. Kjo ka për qëllim të mbrojë jetën, integritetin dhe dinjitetin e personave të tjerë.

Kur raportet e tilla i dërgon KNKK-ja deri te pushtetet, për pushtetet, gjithashtu, duhet të jetë e lejuar, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për të kufizuar të drejtat e qasjes deri te përmbajtja e të dhënave.

Deputetët për këtë arsye duhet të kontrollojnë, në raste të tilla, nëse ekziston mekanizmi për kufizimin e qasjes deri te të dhënat personale.

Qëllimi i kufizimit

Të dhënat personale duhet të përpunohen në transparencë të plotë për një qëllim të caktuar qartë. Tasi të caktohen qëllimi, të dhënat personale nuk mund të përpunohen për një qëllim tjetër që nuk është në pajtueshmëri me të, përveç nëse mund të gjendet një bazë e re juridike për këtë qëllim.

Organizatat humanitare përpunojnë të dhëna për qëllime vetëm humanitare dhe për arsye administrative lidhur me ato qëllime humanitare. Megjithatë, organizatat humanitare që nuk gëzojnë privilegjet, imunitetin statusin e një organizate ndërkombëtare mund të jenë nën presion nga pushtetet për të siguruar të dhëna të caktuara personale për organet, për shembull, për shkak qëllimeve lidhur me zbatimin e ligjit, ose për t'u ballafaquar me çështjet e migrimeve. Ky përdorim i të dhënave është në papajtueshmëri me qëllimin për të cilin janë mbledhur të dhënat dhe paraqet kanosje për punën humanitare.

Deputetët duhet të sigurojnë që të vendosen masa të qarta mbrojtëse për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Mbrojtja për KNKK-në

Deputetët duhet të sigurojnë që legjislacioni nacional i shtetit përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave, në mënyrë efektive të mbrojtë të drejtën e besueshmërisë së KNKK-së dhe të lehtësojë aktivitetet e tij humanitare siç është parashikuar me instrumentet ndërkombëtare juridike për mbështetje të mandatit të tij. Në qoftë se legjislacioni i tillë dhe rregullat ekzistuese janë jo adekuate, deputetët mund të parashtrijnë pyetje për qeverinë në këtë temë ose të shfrytëzojnë të drejtën e tyre për iniciativë parlamentare për të përmirësuar situatën.

Për shembull, përmes debatit parlamentar, deputetët mund të theksojnë arsyen absolute për të cilën KNKK-ja nuk i zbulon informacionet dhe të dhënat që i mbledh si dhe specifikën e mandatit të tij, dhe mënyrën në të cilën këto çështje duhet të reflektohen në legjislacionin nacional për mbrojtjen e të dhënave.

Lista e kontrollimit për deputetë

- Nëse shteti juaj ka legjislacion nacional për mbrojtjen e të dhënave, sigurohuni se përmban dispozita të cilat:
 - autorizojnë përpunimin dhe transferimin e të dhënave personale për të KNKK-ja dhe komponentët tjerë të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe;
 - sigurojnë qartësi të mjaftueshme se të drejtat e qasjes për të dhënat personale duhet të kufizohen në bazë të interesit publik, kur ato është e domosdoshme që të mbrohen informacionet që janë përfshirë me privilegjin e KNKK-së për mos publikimin e tyre;
 - me qëllim të mbrojtjes së kufizimit në lidhje me objektivat në zonën e aktiviteteve humanitare dhe për të parandaluar mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për qëllime humanitare për qëllime të tjera të papajtueshme.
- Nëse korniza e përhershme ligjore është jo adekuate, mos hezitoni të:
 - parashtroni pyetje për qeverinë në këtë temë;
 - inicioni një debat parlamentar për nevojën për të siguruar një trajtim të veçantë të KNKK-së dhe për të lehtësuar aktivitetet e kësaj organizate;

- qasuni pushtetit ekzekutiv dhe ministrive relevante me qëllim që të bëni ndryshimet e nevojshme në legjislacionin nacional për mbrojtjen e të dhënave;
- filloni një diskutim për atë se cilat dispozita të reja duhet të jenë përmbajtur;
- ndërmerrni të gjitha masat tjera të duhura.

Fëmijët

Standardet ligjore për mbrojtjen e fëmijëve

Në rast të një konflikti të armatosur ndërkombëtar dhe jo-ndërkombëtare, fëmijët që nuk janë pjesëtarë të forcave të armatosura të shteteve ose grupeve të organizuara të armatosura jo-shtetërore janë përfshirë me mbrojtjet e përgjithshme që u jepen civilëve nga efektet e armiqësive, përveç nëse ata direkt nuk marrin pjesë në armiqësitë. Duke marrë parasysh prekshmerinë e veçantë të fëmijëve, Konventa e Tretë dhe e Katërt e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë të vitit 1977 përcaktojnë një seri rregullash me të cilat u ndahet një mbrojtje e veçantë fëmijëve; fëmijët që marrin pjesë direkt në armiqësitë nuk humbin këtë mbrojtje të veçantë.

Protokollet Shtesë, Konventa për të drejtat e fëmijëve e vitit 1989 dhe Protokoli fakultativ i Konventës që ka të bëjë me Përfshirjen e Fëmijëve në një Konflikt të Armatosur të vitit 2000, gjithashtu përcaktojnë kufizime për pjesëmarrjen e fëmijëve në armiqësitë.

Konventa e Katërt e Gjenevës përfshin dispozita të veçanta për fëmijët, por Protokoli Shtesë I përcakton parimin e mbrojtjes së veçantë. “Fëmijët do të jenë objekt i respektit të veçantë dhe do të jenë të mbrojtur nga çdo formë e një sulmi të pahijshëm. Palët në konflikt do të sigurojnë kujdesin dhe ndihmën e nevojshme për ata, për shkak të moshës së tyre ose një arsye tjetër “ (Neni 77).

Pjesëmarrja e fëmijëve në armiqësitë duhet të jetë në disa forma të ndryshme, duke filluar nga sigurimi i mbështetjes për luftëtarët (siç është bartja e armëve dhe municionit, dhe kryerja e misionëve të zbulimit) e deri në rekrutimin e fëmijëve dhe përdorimin e tyre si luftëtarë në forcat e armatosura nacionale ose grupet e armatosura. Protokollet Shtesë të vitit 1977 ishin marrëveshjet e para ndërkombëtare që përfshinin situatat e tilla. Protokoli Shtesë I kërkon nga shtetet për të ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të parandaluar fëmijët e moshën nën 15-vjeç të marrin pjesë direkt në armiqësitë.

Ekskluzivisht ndalon rekrutimin e tyre në forcat e armatosura dhe inkurajon shtetet anëtare, kur rekrutohet personat e moshës nga 15 deri 18 vjeç, t’u japin përparësi atyre më të moshuarve (Neni 77). Protokoli Shtesë II shkon më tej dhe ndalon pjesëmarrjen – direkt ose indirekt – në armiqësitë, të fëmijëve të moshës nën 15-vjeç.

Në rast të një konflikti të armatosur ndërkombëtar, fëmijët që nuk marrin pjesë në armiqësitë janë përfshirë me dispozitat e Konventës së Katërt të Gjenevës që ka

të bëjë me mbrojtjen e civilëve dhe Protokollin Shtesë I. Ata janë të mbrojtur me garancitë themelore që sigurojnë këto marrëveshje, sidomos të drejtën e sjelljes humane dhe ndalimin e vrasjes, detyrimit, dënimit trupor, torturës, dënimit kolektiv dhe hakmarrjes. Ata gjithashtu janë të mbrojtur me rregullat e Protokollit Shtesë I i cili ka të bëjë me sjelljen e palëve në armiqësitë, duke përfshirë parimin e distinkcionit dhe ndalimin e sulmeve mbi civilët.

Në rast të një konflikti të armatosur ndërkombëtar, fëmijët, gjithashtu, janë të përfshirë me garancitë themelore për personat që nuk janë të përfshirë direkt në armiqësitë. Ata më tej janë të mbrojtur me parimin se “popullsia civile si e tillë, si dhe civilët individualë, nuk do të jenë objekt i sulmit” (neni 13, paragrafi 2 i Protokollit Shtesë II).

Më tej, Konventa për Të Drejtat e Fëmijëve e vitit 1989, e cila pothuaj se është ratifikuar në mënyrë universale, përshtin të gjitha të drejtat themelore të fëmijëve. Ndër nenet e ndryshme përkatëse, Neni 38 i Konventës fton shtetet anëtare për të ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të siguruar që fëmijët e moshës nën 15-vjeç të mos marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në armiqësitë. Neni 38 i Konventës, gjithashtu, parashikon që me rastin e rekrutimit të personave të moshës ndërmjet 15 dhe 18 vjet, duhet të jepet prioritet për më të moshuarit në mesin e tyre.

Protokolli Fakultativ për Përfshirjen e Fëmijëve në një Konflikt të Armatosur, i miratuar më 25 të vitit 2000, forcon mbrojtjen e fëmijëve në një sulm të armatosur. Theksohet se:

- shtetet anëtare duhet të ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për të siguruar që pjesëtarët e forcave të tyre të armatosura që nuk kanë mbushur 18 vjet, të mos marrin pjesë direkt në armiqësitë;
- ndalohet rekrutimi i detyrueshëm në forcat e armatosura e personave nën 18 vjeç;
- shtetet anëtare do të ngritin moshën minimale të rekrutimit vullnetar prej moshës 15 vjeç (ky rregull nuk vlen për akademitë ushtarake);
- grupet e armatosura të ndryshme nga forcat e armatosura nacionale nuk duhet, në asnjë rrethanë, të rekrutojnë njerëz të moshës nën 18 vjeç (pa marrë parasysh nëse kjo është në bazë të detyrueshme ose vullnetare), ose të përdorin ata në armiqësitë; dhe
- shtetet anëtare duhet t'i ndalojnë dhe t'i kualifikojnë si vepra penale praktikat e tilla në nivelin vendor (Neni 4).
- 15 dhe 18 vjeç, prioritet duhet t'u jepet më të moshuarve prej tyre.

Implementimi nacional i masave mbrojtëse

Përveç ratifikimit të marrëveshjeve për mbrojtjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura, shtetet kanë rol aktiv në implementimin e tyre në nivel nacional. Prej tyre kërkohet të ndërmarrin dhe të zbatojnë masat nacionale, pa marrë parasysh nëse janë në formë legjislativi ose në një formë tjetër, dhe të jenë në përputhje me

sistemin e tyre juridik dhe gjyqësor. Prioritet duhet të jepet për zbatimin e këtyre rregullave:

- Shtetet nënshkruese të Protokollit Fakultativ për Përfshirjen e Fëmijëve në një Konflikt të Armatosur duhet të ndërmarrin masa legjislative për ndalesën dhe inkriminimin e rekrutimit të detyrueshëm në forcat e armatosura nacionale të personave nën moshën 18 vjeç dhe rekrutimin e detyrueshëm ose vullnetar ose përdorimin e personave të moshës nën 18 vjeç nga ana e grupeve të armatosura nga forcat e armatosura nacionale.
- Shtetet nënshkruese të Konventës për Të Drejtat e Fëmijëve ose Protokolli Shtesë I, duhet të ndërmarrin masa ligjore për ndalimin e rekrutimit dhe pjesëmarrjes direkt në armiqësitë të fëmijëve të moshës nën 15-vjeç dhe të sigurojnë që gjatë rekrutimit të kenë prioritet më të moshuarit tek ata të moshës ndërmjet 15 dhe 18 vjeç.
- Parimi i pajtueshmërisë, sipas së cilit GjNP-së ka juridiksion në situatat kur një shtet nuk është në gjendje ose nuk dëshiron të përndjekë në mënyrë gjyqësore personat, dikton që shteti nënshkrues i Statutit të GjNP-së të sigurojë që legjislacioni nacional penal i tij do të mundësojë përndjekjen penale të personave që rekrutojnë fëmijë të moshës nën 15-vjeç ose të përdorin fëmijët si pjesëmarrës aktivë në armiqësitë. Legjislacioni nacional gjithashtu duhet të përcaktojë përgjegjësinë individuale penale për kryerësit e këtyre veprave penale, si dhe përgjegjësinë komanduese për të gjithë komandantët që nuk arrijnë për të parandaluar ose dënuar ato. Shtetet duhet të sigurojnë që këto vepra penale të mos mund të përfshihen me asnjë ligj të amnistisë.

Gjithashtu, vendet nënshkruese të Protokolleve Shtesë I dhe II duhet të ndërmarrin masa ligjore dhe masa të tjera për të siguruar që çdo fëmijë i moshës nën 15-vjeç, që është burgosur, paraburgosur ose internuar për arsye lidhur me një konflikt të armatosur, të gëzojë mbrojtje të veçantë të siguruar në përputhje me DHN-në. Fëmijët që janë rekrutuar në mënyrë të paligjshme dhe të cilët janë akuzuar se kanë kryer krime vendore ose ndërkombëtare gjatë një konflikti të armatosur, kryesisht duhet të konsiderohen si viktimë, dhe jo si kryerës dhe të trajtohen si të tillë.

Diseminimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i legjislacionit nacional

Janë të nevojshme përpjekje për të përparuar njohuritë dhe respektimin e DHN-së me qëllim që të sigurohet respektimi i të drejtave të fëmijëve. Në lidhje me DHN-në, shtetet janë të detyruara ligjërisht për të ngritur ndërgjegjen për këto të drejta përmes aktiviteteve të diseminimit. Kjo mund të inkorporohet në konceptin e mbrojtjes së fëmijëve në trajnime në kohë paqe, si dhe ushtrime në të gjitha nivelet e forcave të armatosura dhe nacionale të sigurisë dhe/ose në programin mësimor të universiteteve dhe institucioneve të specializuara.

Gjithashtu, duhet të zhvillohen fushata për ngritjen e ndërgjegjes tek publiku i gjerë dhe tek fëmijët e të dyja gjinive për format dhe pasojat mbi fëmijët që marrin pjesë direkt ose indirekt në armiqësitë, si dhe për efektet konkrete të një konflikti të

armatosur (duke përfshirë dhe lidhshmërinë me forcat e armatosura ose grupet e armatosura) mbi fëmijët dhe familjet dhe komunitetet e tyre.

Shërbimi Këshillëdhënës i KNKK mbështet shtetet në përpjekjet e tyre për të zhvilluar masa ligjvënëse, administrative dhe praktike dedikuara për implementimin vendor të rregullave ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve të prekur nga një konflikt i armatosur. Për këtë qëllim, Shërbimi Këshillëdhënës ka përpunuar dy dokumente referimi:

- Dispozita ligjore model për rekrutimin e fëmijëve ose përdorimin e fëmijëve në konfliktet e armatosura, dedikuara për t'u shfrytëzuar nga ana e shteteve si udhëzime në përgatitjen ose plotësimin e legjislacionit nacional për ndalimin e rekrutimit ose përdorimit të fëmijëve në konfliktet e armatosura, në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/model-legislative-provisions-recruitment-or-use-children-armed-conflict-model-law>;
- Parimet e udhëheqjes për implementimin vendor të një sistemi gjithëpërfshirës për mbrojtjen e fëmijëve lidhur me forcat e armatosura ose grupet e armatosura, qëllimi i të cilave është qartësimi i detyrimeve ekzistuese shtetërore, lehtësimin e respektimit të detyrimeve ekzistuese dhe promovimin, përhapjen dhe zbatimin e dispozitave relevante, në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/domestic-implementation-comprehensive-system-protection-children-associated-armed-forces-or>.

Për më shumë informacione për fëmijët në konfliktet e armatosura, ju lusim të shihni:

BNP/UNICEF, Mbrojtja e Fëmijëve: Doracak për deputetët (shihni pjesën për fëmijët dhe luftën), viti 2004, në dispozicion në www.BNP.org/pdf/publications/childprotection_en.pdf

KNKK, "Mbrojtja juridike e fëmijëve në një konflikt të armatosur", fakte, në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/legal-protection-children-armed-conflict-factsheet>

KNKK, Fëmijët e lidhur me forcat e armatosura ose grupet e armatosura, në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/p0824.htm>.

Refugjatët

Refugjatët janë persona që janë ekspozuar një rreziku ose kanë qenë viktime të përndjekjes në vendin e tyre të origjinës dhe si rezultat kanë kaluar kufirin ndërkombëtar. Personat e zhvendosur brenda vendit (shih pjesën më poshtë), gjithashtu, kanë qenë të detyruar për të braktisur shtëpitë e tyre, por nuk e kanë kaluar kufirin ndërkombëtar.

Refugjatët janë të mbrojtur me ligjin e refugjatëve – kryesisht Konventa për Statusin e Refugjatëve (1951) dhe Protokollin e saj të vitit 1967 (Protokolli i Statusit

së Refugjatëve), Konventa për Aspektet Specifike të Problemeve të Refugjatëve në Afrikë (1969) dhe Deklarata për Refugjatët e Kartagjenas (1984) – dhe ligji i të drejtave të njeriut, dhe sidomos parimi i moskthimit.

Neni 1 i Konventës për Statusin e Refugjatëve, në përputhje me ndryshime me Protokollin e vitit 1967, përcakton refugjatin si çdo person që “për shkak të frikës së bazuar për të qenë i përndjekur për shkak të racës, religjionit, nacionalitetit, anëtarësisë në ndonjë grup social ose mendimit politik, është jashtë vendit shtetas i të cilit është dhe nuk është në gjendje ose, për shkak të frikës së tillë, nuk dëshiron për të shfrytëzuar mbrojtjen e atij vendi; ose, i cili, për shkak të mospasjes së nënshpëtësisë dhe është jashtë vendit të mëparshëm të tij të qëndrimit të zakonshëm si rezultat i ngjarjeve të tilla, nuk është në gjendje ose, për shkak të frikës së tillë, nuk dëshiron për t’u kthyer prapë aty”.

Konventa për Rregullimin e Aspektëve specifike të Problemeve të Refugjatëve në Afrikë dhe Deklarata për Refugjatët e Kartagjenas kanë miratuar një definicion më të gjerë i cili përfshin njerëzit që ikin nga ngjarjet të cilat seriozisht çrregullojnë rendin publik, siç janë konfliktet e armatosura dhe situatat tjera të dhunës.

Refugjatët gjithashtu janë të mbrojtur me DHN kur gjenden në shtetin i cili është përfshirë në konfliktin e armatosur. Përveç mbrojtjes së përgjithshme që u jepet civilëve me DHN, refugjatët marrin një mbrojtje të veçantë sipas Konventës së Katërt të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I të Konventave të Gjenevës. Për shembull, Neni 44 i Konventës së Katërt të Gjenevës thotë se Forcat që kryejnë paraburgim, nuk duhet të trajtojnë si të huaj armiqësorë ata refugjatë të cilët, në të vërtetë, nuk gëzojnë mbrojtjen e çdo qeverie. Neni 73 i Protokollit Shtesë I shton se refugjatët duhet të konsiderohen si persona të mbrojtur në të gjitha rrethanat dhe pas asnjë dallim negativ.

Për më shumë informacione për refugjatët dhe rolin e deputetëve ju lusim të shihni:

BNP/UNHCR, Mbrojtja e refugjatëve: Udhëzues për ligjin ndërkombëtar të refugjatëve, viti 2001, në dispozicion në <http://www.unhcr.org/3d4aba564.html>

KNKK, E Drejta Humanitare Ndërkombëtare: Përgjigje të pyetjeve tuaja, viti 2015, në dispozicion në <https://shop.icrc.org/international-humanitarian-law-answers-to-your-questions-261.html>

Konventa e Statusit të Refugjatëve (viti 1951) dhe Protokollin i saj i vitit 1967 (Protokollin i Statusit të Refugjatëve), në dispozicion në <http://www.unhcr.org/3b66c2aa10.html>

Konventa e Aspektëve Specifike të Problemeve të Refugjatëve në Afrikë (viti 1969), në dispozicion në <http://www.unhcr.org/45dc1a682.html>

Deklarata për Refugjatët e Kartagjenas (viti 1984), në dispozicion në <http://www.unhcr.org/45dc19084.html>

Personat e zhvendosur brenda vendit

Parimet Udhëheqëse të Kombeve të Bashkuara për Zhvendosjen e Brendshme (viti 1998) përcaktojnë “personat e zhvendosur brenda vendit” (PZHBV) si “persona ose grup personash që kanë qenë të detyruar me forcë ose të obliguar për të ikur ose për të braktisur shtëpitë e tyre ose vende e jetesës së zakonshme, sidomos si rezultat i, ose me qëllim që të shmangin efektet e një konfliktit të armatosur, situatat e dhunës së përgjithshme, shkeljen e të drejtave njerëzore ose katastrofat natyrore ose katastrofat e shkaktuar nga njeriu, të cilat nuk kanë kaluar kufirin e njohur në mënyrë ndërkombëtare të shtetit”.

Mirëpo, nuk ekziston një marrëveshje universale e cila veçanërisht ka të bëjë me nevojat për mbrojtjen e personave të zhvendosur brenda vendit. Konventa për mbrojtje dhe ndihmë për personat e zhvendosur brenda vendit në Afrikë (Konventa e Kampalas), që hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2012, është marrëveshja e parë ndërkombëtar për zgjidhjen e çështjes së mbrojtjes dhe ndihmës për personat e zhvendosur brenda vendit. Personat e zhvendosur brenda vendit janë të mbrojtur me pjesë të ndryshme të ligjit, duke përfshirë të drejtën vendore, ligjin e të drejtave të njeriut dhe – nëse ndodhen në një vend që është përfshirë në një konflikt të armatosur – DHN.

DHN-ja përmban shumë dispozita të cilat kanë të bëjnë me parandalimin e zhvendosjes dhe mbrojtjes së personave të zhvendosur brenda vendit – kryesisht në Konventën e Katërt të Gjenevës dhe Protokollet Shtesë I dhe II, si dhe mbrojtjen zakonore. DHN-ja shprehimisht ndalon zhvendosjen e detyrueshme të civilëve nga vendi i tyre i jetesës, përveç nëse këtë nuk e kërkon situata e sigurisë ose nëse kjo është e nevojshme për shkak të arsyeve më të larta ushtarake.

Rregullat e DHN-së, që kanë për qëllim mbrojtjen e civilëve, nëse respektohen, mund të parandalojnë zhvendosjen dhe vuajtjen që pason dhe të sigurojnë mbrojtjen e personave që janë të detyruar me forcë për të ikur. Derisa janë të zhvendosur, këto komunitete luftojnë për të përmbushur nevojat e tyre thelbësore në kushte të vështirësive serioze, ata gjithashtu mund të përballen me tensione të komuniteteve nikoqire, rrethana jo të sigurta ose jo të shëndetshme për jetesë dhe nga rreziku për t'u kthyer me në mënyrë të detyruar në zona të pasigurta. Veçanërisht duhet të përmenden rregullat që ndalojnë:

- Sulme të drejtpërdrejta në civilë dhe objekte civile, si dhe sulmet jo selektive;
- Sjellja e popullsisë civile në gjendje urie dhe shkatërrimi i objekteve të nevojshme për mbijetesën e popullsisë;
- Dënimi kolektiv, si për shembull shkatërrimi i vendeve të banimit.

Të gjitha këto rregulla janë të njohura me DHN-në zakonore dhe zbatohet gjatë konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare.

Nga shtetet kërkohet për të implementuar rregullat e DHN-së për mbrojtjen e civilëve në kuadër të sistemit nacional juridik.

Për më shumë informacione për personat e zhvendosur brenda vendit dhe roli i deputetëve, ju lusim të shihni:

BNP/UNHCR, Zhvendosja e brendshme: Përgjegjësia dhe aksioni, viti 2003, në dispozicion në <http://www.unhcr.org/525bee0c9.html>

KNKK, “Personat e zhvendosur brenda vendit dhe e drejta humanitare ndërkombëtare” fakte, në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/internally-displaced-persons-and-international-humanitarian-law-factsheet>

KNKK, E Drejta Humanitare Ndërkombëtare: Përgjigje në pyetjet tuaja, viti 2015, në dispozicion në <https://shop.icrc.org/international-humanitarian-law-answers-to-your-questions-261.html>

Personat e zhdukur

Edhe DHN-ja – sidomos Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë të vitit 1977 dhe DHN-ja zakonore – dhe Ligji Ndërkombëtar për Të Drejtat e Njeriut kanë për qëllim të sigurojnë njerëzit të mos zhduken, dhe kur ndodh kjo, të zbardhet fati dhe vendndodhja e tyre.

Në situata të një konfliktit të armatosur ndërkombëtar, palët në konflikt duhet të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për të zbardhur fatin dhe vendndodhjen e personave të zhdukur. Për shembull, kjo nënkupton formimin e një byroje informative dhe një shërbimi për regjistrimin e varreve; dërgimin e lajmeve dhe postës në mesin e pjesëtarëve të forcave të armatosura ose grupeve dhe familjeve të tyre dhe në mesin e personave të privuar nga liria për shkak të arsyeve lidhur me vdekjen dhe të dhënat personale të personave të privuar nga liria; dhe të vepruarit në mënyrë adekuate me mbetjet njerëzore.

Në situata e një konfliktit të armatosur jo-ndërkombëtar, Neni 3, i përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës, nuk përmban dispozita konkrete për personat e zhdukur. Megjithatë, atyre u referohet mbrojtja e përgjithshme që u jepet personave që nuk janë, ose që tanimë nuk marrin pjesë në mënyrë direkt në armiqësitë. Veçanërisht, ata “në të gjitha rrethanat do të trajtohen në mënyrë humane” dhe do të mbrohen nga veprat e ndaluara me Nenin e përbashkët 3 (a), (b), (c) dhe (d).

Neni 8 i Protokollit Shtesë II kërkon “gjithmonë kur rrethanat lejojnë, dhe sidomos pas angazhimit, të ndërmerren të gjitha masat e mundshme (...) për të kërkuar të vdekurit, të pengohet shkatërrimi i mbetjeve mortore, ose, mbetjet mortore të varrosen në mënyrë dinjitoze”.

Në përputhje me rregullat 112, 116 dhe 117 të studimit⁸ për Të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare Zakonore të Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq, të gjitha palët në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe jo-ndërkombëtare duhet të ndërmarrin të gjitha masat e mundshme për të mësuar fatin e personave që janë paraqitur si të zhdukur dhe të kërkojnë, të mbledhin, identifikojnë dhe evakuojnë personat e vdekur.

Instrumentet e ndryshme të LNDNj janë relevante në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga zhdukja me forcë (për shembull, Konventa Ndër-Amerikane për Zhdukjen me Forcë të Personave). Mirëpo, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë është marrëveshja e parë universale që përfshin detyrime specifike për shtetet anëtare.

Më konkretisht, Konventa kërkon nga shtetet anëtare për të ndërmarrë të gjitha masat e duhur për kërkimin, caktimin e vendndodhjes dhe lirimin e personave të zhdukur, dhe në rast të vdekjes, të caktojnë vendndodhjen e mbetjeve të tyre, të veprohet me to me respekt dhe të kthehen, si dhe të hulumtojnë veprat e zhdukjes me forcë dhe të nxirren personat përgjegjës para drejtësisë.

Përgjithësisht, çështja e zhdukjes dhe detyrimet e shteteve në këtë aspekt është pranuar dhe zhvilluar gjerësisht në jurisprudencën e trupave rajonale, siç janë Gjykata Ndër-Amerikane për Të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata Evropiane për Të Drejtat e Njeriut.

Edhe DHN-ja edhe LNDNj tregojnë në dy detyrime të përgjithshme që i obligojnë shtetet dhe partitë në një konflikt të armatosur: detyrimi që të sqarohet fati dhe vendndodhja e personave të zhdukur dhe detyrimi për të parandaluar zhdukjen e njerëzve. I pari, gjithashtu, nënkupton respektimin e të drejtës së familjeve për të qenë e njoftuar me fatin dhe vendndodhjen e familjarëve të tyre. Përveç kësaj, shtetet duhet të sigurojnë miratimin e masave nacionale për mbrojtjen e të dhënave personale, për të siguruar një përgjigje për nevojat e familjeve të personave të zhdukur dhe të identifikohen dhe të veprohet me mbetjet njerëzore.

Sipas DHN-së dhe LNDNj, detyrimi për të sqaruar fatin dhe vendndodhjen e personave të zhdukur, gjithashtu, nënkupton respektimin e të drejtës së familjeve për të ditur fatin e familjarëve të paraqitur si të zhdukur, vendndodhjen e tyre ose rrethanat dhe arsyet për vdekjen e tyre.⁹ Kjo e drejtë duhet të njihet në mënyrë eksplicite për anëtarët individualë të familjes. Në zgjidhjen e kësaj të drejte, shtetet duhet të ndërmarrin masat e domosdoshme për të hulumtuar rastet e zhdukjes dhe të informojnë familjet gjatë tërë procesit.

Përveç kësaj, pa marrë parasysh kornizën ligjore i zbatueshëm, detyrat siç janë kërkimi i varreve dhe zhvarrosja e mbetjeve njerëzore janë pjesa thelbësore e sqarimit të fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur. Gjetja dhe identifikimi

⁸ Shihni studimin për Të Drejtën Zakonore të DHN së KNKK: Jean-Marie Henckaerts and Louise Doswald-Beck, E Drejta Humanitare Zakonore, Libri I: Rregullat, KNKK, Gjenevë / Cambridge University Press, Kembrixh, viti 2005, në dispozicion në <http://www.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/home>.

⁹ Neni 32, PSh I; Neni 24 i Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë

i trupave të personave të zhdukur, për shembull, do t'u mundësojë familjeve për të mbajtur një varrim përkatës, të zbatojnë ceremoni përkatëse fetare dhe kulturore.

Përgjegjësia primare për parandalimin e zhdukjeve dhe përcaktimin e fatit të njerëzve të paraqitur si të zhdukur qëndron tek pushtetet shtetërore. Prandaj, me rëndësi thelbësore është që parlamentarët që miratojnë një legjislacion nacional për të parandaluar zhdukje dhe të zgjidhet frati dhe vendndodhja e personave të zhdukur. Për shembull, kjo nënkupton, njohjen e statusit juridik të personave të zhdukur dhe vendosjen e procedurave të centralizuara të kërkimit dhe identifikimit të mbetjeve njerëzore dhe të sigurohet që ato në mënyrë adekuate do t'u dorëzohen familjarëve të tyre.

Për më shumë informacione për çështjen e personave të zhdukur ju lusim të shihni:

BNP/KNKK, Personat e zhdukur: Doracak për parlamentarët, viti 2009, në dispozicion në https://www.icrc.org/eng/assets/files/other/icrc_002_1117.pdf

KNKK, "Personat e zhdukur dhe familjet e tyre" fakte, në dispozicion në <https://www.icrc.org/en/document/missing-persons-and-their-families-factsheet>

Persona me handikap

Personat me handikap janë personat me aftësi të kufizuara fizike, mentale, intelektuale ose sensorike, të cilët në ndërvëprim me pengesa të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në bazë të barabartë me njerëzit e tjerë.

Sipas Raportit Botëror për Handikap,¹⁰ mbi një miliard njerëz – rreth 15% të popullsisë botërore – jetojnë me ndonjë formë të handikapit. Shpërndarja e handikapit po rritet për shkak të plakjes së popullsisë globale dhe rritjes së gjendjeve shëndetësore kronike. Fëmijët me handikap, disa prej tyre të përjashtuar në aspekt social nga lindja, janë një nga grupet më të prekshme dhe në mënyrë jo proporcionale gëzojnë të drejtën e arsimimit dhe shpeshherë vuajnë nga institucionalizimi, dhuna, keqpërdorimi, eksploatimi dhe braktisja.

Përfaqësimi i handikapit në çdo vend është nën ndikimin e trendëve shëndetësorë, mjedisit jetësor dhe faktorët e tjerë. Këto janë aksidentet e trafikut, katastrofat natyrore, konfliktet e armatosura, dhuna e armatosur, ushqimi dhe keqpërdorimi i substancave, si dhe ndikimi i sistemeve shëndetësore dhe sociale të mbrojtjes.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Personave me Handikap është konventa e parë për të drejtat e njeriut në shekullin njëzetentë. Ajo është miratuar nga Kuvendi i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara në dhjetor të vitit 2006, e hapur për nënshkrim në mars të vitit 2007 dhe hyri në fuqi në maj të vitit

¹⁰ Raporti Botëror për Handikap, Organizata Botërore Shëndetësore dhe Banka Botërore, viti2011.

2008. Ajo është nënshkruar deri tani nga 160 shtete, ndërsa 162 shtete kanë ratifikuar ose kanë aderuar drejt saj.

Konventa përfaqëson kornizën e të drejtave të njeriut që përfshin një spektër të gjerë të së drejtave qytetare, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Ajo ka dimension të fuqishëm social dhe ekonomik dhe përmban referenca për DHN-në. Ajo synon të arrij një shoqëri përfshirëse për personat me handikap përmes heqjes së shumë pengesave (fizike, informatike dhe komunikative, politike, juridike, institucionale, ekonomike dhe bihejvioarale). Konventa ka për qëllim zgjidhjen e diskriminimit, ndryshimin e perceptimeve dhe luftën kundër stereotipave dhe paragjytimeve.

Neni 11 i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar është me interes të veçantë në lidhje me DHN-në, për shkak se ka të bëjë me situatat e rrezikut dhe situatat emergjente humanitare.

I njeh detyrimet e DHN-së dhe LNDNj dhe kërkon të ndërmerren të gjitha masat e domosdoshme për të mbrojtur personat me handikap në situata të rrezikut, duke përfshirë situatat e konfliktit të armatosur dhe situatat humanitare emergjente, si dhe katastrofat natyrore. Përveç kësaj, Konventat e Gjenevës i mbrojnë personat me handikap që kanë marrë handikabin gjatë një konflikti të armatosur. Përveç kësaj, disa marrëveshje¹¹ lidhur me armët përmbajnë dispozita për ndihmë për viktimat.

KNKK dhe shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në 189 vende kryejnë rol ndihmës për autoritetet shtetërore, duke siguruar përvojën e tyre dhe ekspertizën në sigurimin e shërbimeve për personat më të prekshëm. Ata, gjithashtu, luajnë rol kyç në nivel nacional, në sigurimin e mbështetjes së qeverive në lidhje me lajmërimin dhe zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Personave me Handikap, sidomos në lidhje me Nenin 11 të kësaj Konvente.

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Personave me Handikap, gjithashtu, thekson rëndësinë në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut në procesin e ndihmës për të mbijetuarit nga kontaminimi i armëve dhe familjet e tyre. Rrjedhimisht, të gjitha shtetet e prekura dhe shtetet që janë në pozitë për të ndihmuar, duhet të frymëzohen nga Konventa e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Personave me Handikap në përmbushjen e përgjegjësisë së tyre në përputhje me Konventën për Ndalimin e Minave Kundër Këmbësorisë, Protokollin V i Konventës për Disa Armë Konvencionale dhe Konventa për Municionin Thërrmues.

Për më shumë informacione për të drejtat e personave me handikap ju lusim të shihni:

¹¹ Shihni për shembull, Konventa për Ndalimin e Municionit Thërrmues dhe Minave Kundër Këmbësorisë.

BNP/OHCR, Nga përjashtimi deri te barabarësia: Realizimi i të drejtave të personave me handicap, viti 2007, në dispozicion në www.BNP.org/PDF/publications/disabilities-e.pdf.

Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë

Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë janë subjekte private afariste që sigurojnë shërbime ushtarake dhe/ose të sigurisë, pa marrë parasysh se si përshkruajnë ato veten e tyre. Shërbimet ushtarake dhe të sigurisë janë në formë të sigurimit të rojeve të armatosura dhe mbrojtje të njerëzve dhe objekteve; mirëmbajtja dhe administrimi i sistemeve të armëve; ruajtja e personave të paraburgosur; dhe këshillimi dhe trajnimi i forcave të armatosura lokale dhe personelit të sigurimit.

Statusi i punonjësve në kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë në një konflikt të armatosur përcaktohet nga DHN-ja, nga rasti në rast.

Natyra dhe rrethanat e funksioneve në të cilat janë përfshirë ata janë të rëndësishme së veçantë. Përveç nëse nuk janë të përfshirë në forcat e armatosura të një shteti ose kanë funksione luftarake për një grup të caktuar të organizuar e të armatosur që i përket palës në konflikt, punonjësit në kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë janë civilë. Përveç kësaj, ata nuk mund të jenë cak i sulmit, dhe ata janë të mbrojtur nga sulmi përveç dhe vetëm në kohën e periudhës derisa direkt marrin pjesë në armiqësitë.

Mirëpo, nëse të punësuarit në kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë kryejnë veprime që janë të barabarta me pjesëmarrjen direkt në armiqësitë (shihni “Kush e mbron DHN-në dhe si?” Në Pjesën 1), ata humbin mbrojtjen nga sulmi derisa marrin pjesë në armiqësitë. Nëse zihen rob, mund të gjykohen vetëm për pjesëmarrje në armiqësitë, madje edhe nëse ata nuk kanë kryer asnjë shkelje të DHN-së.

Shembull për pjesëmarrje direkt në armiqësitë janë shërbimet e tilla si ruajtja e bazave ushtarake nga sulmet e palës kundërshtarë, mbledhja e informacioneve taktike-ushtarake-të kundërzbulimit dhe përdorimi i sistemeve luftarake.

Nga kjo, nëse të punësuarit në kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë marrin pjesë në situata të një konflikti të armatosur, ata duhet të respektojnë DHN-në dhe mund të përndiqen penalisht për shkeljet e DHN-së që do t'i kryejnë. E njëjta vlen pa marrë parasysh nëse janë të angazhuar nga shtetet, organizatat ndërkombëtare ose kompanive private.

Me iniciativë të përbashkët të Zvicrës dhe Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të kuq, në vitin 2008 është mbështetur dokumenti i Montresë nga ana e 17 vendeve, për detyrimet ndërkombëtare relevante juridike dhe praktikë e mira lidhur me punën e

kompanive private ushtarake dhe të sigurisë gjatë kohës së konflikti të armatosur.¹²

Ky dokument riafirmon detyrimin ekzistues juridik të shteteve në lidhje me kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë dhe rekomandon një katalog të praktikave të mira për implementimin e detyrimeve ekzistuese juridike.

Më 16 dhjetor të vitit 2014, është iniciuar Forumi për Dokumentin e Montresë. Forumi është krijuar për të siguruar mbështetje dhe këmbim të praktikave të mira për rregullimin e punës së kompanive private ushtarake dhe të sigurisë dhe të vazhdojë të punojë në implementimin dhe promovimin e dokumentit.

Përgjegjësitë e shteteve që angazhojnë kompani ushtarake dhe të sigurisë në territorin e tyre

Shtetet nuk mund të lirohen nga detyrimi i tyre sipas DHN-së përmes lidhjes së marrëveshjes me kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë. Shtetet duhet të sigurojnë që punonjësit e këtyre kompanive të respektojnë DHN-në. Masa të rëndësishme për realizimin e këtij qëllimi janë:

- Të kërkohet nga punonjësit të jenë të aftësuar në mënyrën e duhur për DHN; dhe
- Të kërkohet që rregullat e angazhimit dhe procedurat operative standarde të agjencive private ushtarake dhe të sigurisë të jenë në përputhje me DHN-në.

Nëse të punësuarit e kompanive private ushtarake dhe të sigurisë shkelin DHN-në, shteti që i ka angazhuar mund të thirret në përgjegjësi për shkak të shkeljeve të bëra nëse ato lidhen me shkeljen e së drejtës ndërkombëtare. Shtetet duhet të sigurojnë ekzistimin e mekanizmave me qëllim që punonjësit e kompanive private ushtarake dhe të sigurisë të mund të thirren në përgjegjësi për shkak të shkeljeve të DHN-së.

Përgjegjësia e shteteve në territorin e të cilëve punojnë këto kompani private ushtarake dhe të sigurisë

Shtetet në territorin e të cilave punojnë kompanitë ushtarake dhe të sigurisë rregullojnë punën e tyre përmes ligjeve nacionale.

Një nga mënyrat që shteti të tregojë kontrollin dhe mbikëqyrjen është përmes dhënies së licencave ose vendosjes së një sistemi rregullator. Elementet kyç të kornizës rregullatore nacionale mund jenë përcaktimi i një liste se cilat shërbime munden ose nuk munden të sigurohen nga ana e kompanive private ushtarake dhe të sigurisë ose të punësuarve të tyre. Shtetet mund të detyrojnë kompanitë

¹² KNKK, Dokumenti i Montresë për kompanitë private dhe ushtarake të sigurisë, viti 2009, në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/p0996.htm>. Nga 19 prilli i vitit 2016, 53 shtete dhe tri organizata ndërkombëtare mbështetën Dokumentin e Montresë.

private ushtarake dhe të sigurisë për të përmbushur disa kritere para se t'u jepet licenca. Në kuadër të kritereve, këto kompani duhet të plotësojnë këto norma:

- Të aftësojnë punonjësit e tyre për DHN-në;
- Të miratojnë procedura standarde operative dhe rregulla të angazhimit që do të sigurojnë respektimin e DHN-së, dhe të vendosin masa përkatëse disiplinore.

Shteti gjithashtu mund të miratojë të gjitha marrëveshjet varësisht nga natyra e aktiviteteve të propozuara dhe situatës në vendin ku punon kompania private ushtarake dhe e sigurisë. Gjithashtu mund të imponojë sanksione për punën pa një autorizim të domosdoshëm ose për punën që ka rezultuar me shkelje të rregullave. Sanksionet mund të jenë marrja e licencës e deri në dënime penale.

Sistemi i tillë rregullator duhet të plotësohet me një sistem efikas për përndjekjen e personave të akuzuar për shkeljet e DHN-së.

Për më shumë informacione për kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë dhe rolin e parlamentarëve, ju lusim shihni:

BNP/Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, Mbikëqyrja Parlamentare e Sektorit të Sigurisë, viti 2003, në dispozicion në [http://www.dcaf.ch/Project/DCAF-BNP-Handbook-on-Parliamentary-Oversight-of-the-Security-Sector/\(show\)/publications](http://www.dcaf.ch/Project/DCAF-BNP-Handbook-on-Parliamentary-Oversight-of-the-Security-Sector/(show)/publications)

KNKK, "E Drejta Humanitare Ndërkombëtare dhe kompanitë private ushtarake/të sigurisë", në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/faq/pmsc-faq-150908-htm>

Armët bërthamore

Nuk ekziston një ndalesë gjithëpërfshirëse ose universale në lidhje me përdorimin e armëve nukleare. Marrëveshja për mos zgjerimin nuklear e vitit 1968, kryesisht ka për qëllim të parandalojë përhapjen e armëve nukleare dhe të sigurojë lëvizjen drejt qëllimit të çarmatimit bërthamor.

Mirëpo, në vitin 1996, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, në cilësinë këshillëdhënëse konfirmoi se DHN-ja zbatohet në armët bërthamore veçanërisht parimi i distinkcionit të DHN-së dhe ndalesa për shkaktimin e vuajtjes së panevojshme. Në zbatimin e këtyre dhe rregullave të ngjashme për armët bërthamore, gjykata konkludoi se "kanosja ose përdorimi i armës bërthamore përgjithësisht do të ishte në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare – të zbatueshme në një konflikt të armatosur, dhe veçanërisht parimet dhe rregullat e së drejtës humanitare". Mirëpo, gjykata nuk ishte në gjendje për të vendosur nëse përdorimi i armëve bërthamore do të ishte ligjor ose joligjor në një rrethanë të jashtëzakonshme të vetëmbrojtjes kur është në pyetje mbijetesa e shtetit.

Ekzistimi i vazhdueshëm i armëve bërthamore mbetet një brengë serioze, veçanërisht në aspekt të pasojave të tyre humanitare. Në këtë drejtim, në vitin

2011, në Këshillin e Delegatëve të Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (i përbërë nga KNKK, Federata ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe), miratuan rezolutën “puna drejt eliminimit të armëve bërthamore”, në të cilën prezantohet pozita e Lëvizjes në lidhje me armët bërthamore.

Në këtë rezolutë Këshilli i Delegatëve thekson se ishte vështirë për të parashikuar si përdorimi i armëve bërthamore mund të jetë në pajtueshmëri me rregullat e DHN-së, veçanërisht me rregullat e distinksionit, kujdesit dhe proporcionalitetit. Gjithashtu, apelon tek të gjitha shtetet asnjëherë përsëri të mos përdorin armët bërthamore dhe fton në vazhdimin e negociatave për ndalimin dhe eliminimin e armëve bërthamore përmes marrëveshjeve ndërkombëtare obliguese, në përputhje me angazhimet dhe detyrimet ekzistuese. Në vitin 2013, Këshilli i Delegatëve miratoi rezolutën e dytë në të cilën është paraqitur plani katërvjeçar për zhvillimin e punës së Lëvizjes për këtë çështje.¹³

Viteve të fundit, shtetet i kushtojnë vëmendje gjithnjë e më të madhe ndikimi serioz humanitar të armëve bërthamore. Hulumtimet e reja ndihmuan për të potencuar efektet e drejtpërdrejta dhe afatgjata nga përdorimi i çdolloj armësh bërthamore, duke përfshirë pasojat potenciale nga një shpërthim i rastit. Me dekada diskursi rreth armëve bërthamore është fokusuar në aspektet ushtarake dhe të sigurisë dhe në brengosjen rreth përhapjes së kësaj arme. Mirëpo, shtetet zgjerojnë debatin për të përfshirë pasojat humanitare katastrofale nga armët bërthamore dhe implikimet për DHN-në. Në të njëjtën kohë, shumë shtete dhe organizata po rrisin ose sërish theksojnë thirrjet për negociata për miratimin e një marrëveshje për ndalimin dhe eliminimin e armëve bërthamore njëherë e përgjithmonë.

Konferenca e Oslos e vitit 2013, në temën ndikimi humanitar i armëve bërthamore ishte një ngjarje e madhe kyç. Kjo ishte hera e parë qeveritë të mbledhen në një forum global për të diskutuar pasojat e armës bërthamore nga pikëpamja humanitare. Takimet pasuese në këtë temë u mbajtën në Najarit, Meksiko (shkurt i vitit 2014) dhe Vjenë, Austri (dhjetor i vitit 2014). Këto takime ndihmuan për të thelluar kuptimin e bashkësisë ndërkombëtare për pasojat potenciale nga përdorimi i armës bërthamore mbi civilët, mjedisin jetësor dhe tërë planetin.

Ndër gjërat tjera, ata treguan se, edhe pse kapaciteti i zhvillimit të armëve akoma më të fuqishme bërthamore është më i madh krahasuar me vitin 1945, kapaciteti në shumicën e vendeve dhe në nivel ndërkombëtar për të siguruar ndihmë adekuate si përgjigje ndaj shpërthimit bërthamor, mungon seriozisht. Takimet gjithashtu ndihmuan për të na përkujtuar se krahas vuajtjeve të njerëzve të Hiroshimës dhe Nagasakit në vitin 1945, shumë njerëz të tjerë vazhdojnë të vuajnë nga efektet e testimit të armëve bërthamore. Ky diskurs në rritje konfirmon se çarmatimi bërthamor mbetet një imperativ humanitar.

Për më shumë informacione për armët bërthamore dhe çarmatimin, ju lusim të shihni në:

¹³ KNKK, “puna drejt eliminimit të armëve bërthamore: plani katërvjeçar i veprimit”, viti 2013, në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/p1140.htm>

BNP/deputetët për mospërhapjen dhe çarmatimin e armëve bërthamore, mbështetja për mospërhapjen dhe çarmatimin e armëve bërthamore, viti 2012, në dispozicion në <http://www.pnnd.org/resources/BNP-pnnd-handbook>

KNKK, armët bërthamore, <https://www.icrc.org/en/war-and-law/weapons/nuclear-weapons>.

Pjesa 4: Instrumentet model dhe materiali referues

Managua, Nikaragua, Konferenca për forcat e armatosura të Amerikës Qendrore. Forcat e armatosura të Hondurasit, Guatemalës, El Salvadorit, Nikaraguas dhe Republikës Dominikane, marrin pjesë në punëtorinë e rregullave në operatione ushtarake. KNKK/Migel Ramirez.



Më shumë instrumente model janë në dispozicion në doracakun KNKK: implementimi nacional i të drejtës humanitare ndërkombëtare, <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/pdvd40.htm>

Aneksi 1: Instrumentet model për ratifikimin ose aderimin drejt konventave ndërkombëtare

Shtetet nënshkruese: Instrumenti model i ratifikimit Pranimi ose miratimi

Konventa është miratuar në më dhe e hapur për të nënshkruar në më, me ç'rast Konventa është nënshkruar në emër të qeverisë nga më

DHE PRANDAJ UNË, (emri dhe funksioni i shefit të shtetit, shefit të qeverisë ose ministrit të punëve të jashtme), deklaroj se qeveria e, shqyrtoi Konventën e sipërpërmendur dhe e ratifikoi (pranoi, miratoi) këtë konventë dhe sinqerisht mori përsipër për të zbatuar dhe kryer dispozitat që i përmban ajo.

SI DËSHMI PËR KËTË e nënshkruaj këtë instrument (ratifikoj, pranoj, miratoj) në më

(Nënshkrimi) + (vula)

Shtetet jo-nënshkruese: Instrumenti model i aderimit

Konventa është miratuar në më

DHE PRANDAJ UNË, (emri dhe funksioni i shefit të shtetit, shefit të qeverisë ose ministrit të punëve të jashtme), deklaroj se qeveria e

....., e shqyrtoi Konventën e sipërpërmendur, dhe aderoi në këtë konventë dhe sinqerisht mori përsipër për të zbatuar dhe kryer dispozitat që i përmban ajo.

SI DËSHMI PËR KËTË e nënshkruaj këtë instrument për aderim në më

(nënshkrimi) + (vula)

Aneksi 2: Instrumentet model për ratifikimin ose aderimin drejt marrëveshjeve DHN

Konventa për Ndalimin ose kufizimin e përdorimit të disa armëve konvencionale që mund të shkaktojnë lëndime të tepruara ose të shkaktojnë efekte jo selektive dhe Protokollet e Konventave

Vëmendje. *Për t'u bërë nënshkrues, shteti duhet të deponojë një instrument të ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimi deri te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili është depozitues i marrëveshjeve, në adresën e mëposhtme:*

United Nations
Treaty Section, Office of Legal Affairs
New York, NY 10017
United States of America

Gjithashtu, për t'u bërë nënshkrues i Konventës për Disa Armë Konvencionale, Shteti duhet të shpallë se miraton që të obligohet me të paktën dy nga pesë Protokollet e Konventës.

Modeli A – për shtetet nënshkruese të Konventës së vitit 1980

Konventa për Ndalimin ose kufizimin e përdorimit të disa armëve konvencionale që mund të shkaktojnë vuajtje të tepruara ose të shkaktojnë efekte jo selektive (me Protokollet I, II dhe III) është miratuar në Gjenevë më 10 tetor të vitit 1980,

Me ç'rast shefi i deponoi instrumentin për ratifikimin/pranimin/miratimin/aderimin ndaj kësaj Konvente dhe shprehu miratimin për t'u detyruar me Protokollet I, II dhe III që janë në Aneks të Konventës më (data),

Me ç'rast Konferencat e Rishikimit ose takimet e shteteve nënshkruese të kësaj konvente në kohën e duhur miratuan Protokollin IV më 13 tetor të vitit 1995, Protokollin II me ndryshimet më 3 maj të vitit 1996 dhe amendamentin e Nenit 1 të Konventës më 21 dhjetor të vitit 2001 dhe Protokollin V më 28 nëntor të vitit 2003,

Nga kjo unë (emri dhe titulli i shefit të shtetit, shefit të qeverisë ose ministrit të punëve të jashtme) deklaroj se qeveria e (emri i shtetit) i shqyrtoi instrumentet e sipërpërmendura, me ç'rast pranon të obligohet me (Protokolli I, Protokollin II, me ndryshimet e 3 majit të vitit 1996, Protokollin III, Protokollin IV, Protokollin V)¹⁴ dhe e ratifikoi/pranoi/miratoi/aderoi në amendamentin e Konventës dhe singlerisht merr përsipër obligimin për të zbatuar dhe kryer dispozitat që i përmban ajo.

SI DËSHMI PËR KËTË, e nënshkrova dhe vendosa vulën në këtë instrument.
Bërë në..... [vendi], në këtë..... ditë [data] ...

[nënshkrimi]

¹⁴ Shtetet nënshkruese të Konventës të cilat tanimë kanë pranuar të obligohen me të paktën 2 prej Protokolleve duhet në mënyrë të duhur të modifikojnë instrumentin.

.....
Shefi i shtetit ose kryeministri ose ministri i punëve të jashtme
[vula]

Modeli B – për shtetet jo-nënshkruese

Konventa për Ndalimin ose kufizimin e disa armëve konvencionale që mund të shkaktojnë lëndime të tepruara ose të shkaktojnë efekte jo selektive (me Protokollin I, II dhe III) u miratua në Gjenevë më 10 tetor të vitit 1980,

Me ç'rast Konferencat e Rishikimit ose takimet e shteteve nënshkruese të kësaj konvente në kohën e duhur miratuan Protokollin IV më 13 tetor të vitit 1995, Protokollin II me ndryshimet më 3 maj të vitit 1996, dhe amendamentin e Nenit 1 të Konventës më 21 dhjetor të vitit 2001, dhe Protokollin V më 28 nëntor të vitit 2003,

Nga kjo unë (emri dhe titulli i shefit të shtetit, shefit të qeverisë ose ministrit të punëve të jashtme) deklaroj se qeveria e (emri i shtetit) i shqyrtoi instrumentet e sipërpërmendura, me ç'rast pranon të obligohet me (Protokolli I, Protokolli II, me ndryshimet e 3 majit të vitit 1996, Protokolli III, Protokolli IV, Protokolli V) dhe singërisht merr përsipër obligimin për të zbatuar dhe kryer dispozitat që i përmban ajo.

SI DËSHMI PËR KËTË, e nënshkrova dhe vendosa vulën në këtë instrument.
Bërë në..... [vendi], në këtë..... ditë [data] ...

[nënshkrimi]

.....
Shefi i shtetit ose kryeministri ose ministri i punëve të jashtme

[vula]

Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare

Vëmendje: Shteti mund të aderojë në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare duke deponuar në instrumentin e ratifikimit, pranimit ose miratimit deri te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara. Instrumenti duhet të dërgohet në adresën e mëposhtme:

Sekretari i Përgjithshëm
United Nations Headquarters
Secretariat Building
New York, NY 10017
United States of America

Statuti Roman i Gjykatës Penale Ndërkombëtare është sjellë në Romë më 17 korrik të vitit 1998,

Tani nga kjo unë Nga kjo unë (emri i shefit të shtetit, shefit të qeverisë ose ministrit të punëve të jashtme) deklaroj se qeveria e (emri i shtetit) e shqyrtoi Statutin e përmendur, dhe pranon/miraton/ aderon në të dhe singërisht merr përsipër obligimin për të zbatuar dhe kryer dispozitat që i përmban ai.

SI DËSHMI PËR KËTË, e nënshkrova dhe vendosa vulën në këtë instrument.
Bërë në..... [vendi], në këtë..... ditë [data] ...

[nënshkrimi]

.....
Shefi i shtetit ose kryeministri ose ministri i punëve të jashtme
[vula]

Aneksi 3: Propozim-deklaratat

Deklarata për njohjen e kompetencave të Komisionit Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve

Komisioni Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve (Protokolli I, Neni 90)

Klauzola fakultative

Qeveria e (emri i shtetit) deklaroi se një *ipso facto* dhe pa një marrëveshje të veçantë, në lidhje me çdo palë tjetër të lartë kontraktuese pranon këtë obligim, kompetencën e Komisionit Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve për të hulumtuar çdo pohim nga palët tjera, në përputhje me autorizimet nga Neni 90 të Protokollit I, si shtesë e Konventave të Gjenevës së 12 gushtit të vitit 1949.

SI DËSHMI PËR KËTË, nënshkrova dhe vendosa vulën në këtë instrument.
Bërë në..... [vendi], në këtë..... ditë [data] ...

[nënshkrimi]

.....
Shefi i shtetit ose kryeministri ose ministri i punëve të jashtme

[vula]

Deklarata për shtetet që deklarojnë pranimin e obligimeve në përputhje me Protokollin IV të Disa Armëve Konvencionale të vitit 1980

Opsioni nr. 1 (rekomandohet), deklarata model e të kuptuarit

“Qeveria e
..... kupton se dispozitat e Protokollit IV do të zbatohen në të gjitha rrethanat”

Opsioni nr. 2, deklarata model

“Qeveria e
..... do të zbatojë dispozitat e Protokollit IV në të gjitha rrethanat.”

Opsioni nr. 3, deklarata model

Qeveria e
..... do të zbatojë dispozitat e Protokollit IV në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe konfliktet e armatosura jo-ndërkombëtare në përputhje me definicionin në Nenin 3, i përbashkët për Konventat e Gjenevës së vitit 1949.”

Aneksi 4: Ligjet model

A. Dispozitat ligjore model për rekrutimin apo shfrytëzimin e fëmijëve në një konflikt të armatosur

Nëse dëshironi për të rishikuar versionin e këtij ligji model që përmban shënime, ju lusim të shihni në Aneksin XVII të doracakut të KNKK *Implementimi nacional i së drejtës humanitare ndërkombëtare*.

Opsioni 1 (qasja “mbi 18”)

1. Rekrutimi apo shfrytëzimi i fëmijëve në një konflikt të armatosur

Asnjë person nuk duhet:

- a. Të rekrutojë persona nën moshën 18-vjeçare në forcat e armatosura ose grupet e armatosura;
- b. Të përdorë personat nën 18 vjeç në aksionet armiqësore.

2. Dënimet

Çdo persona që do të veprojë në kundërshtim me Paragrafin 1 do të thirret në përgjegjësi me burg jo më shumë se XXX vjet ose dënim në të holla jo më të lartë se XXX, ose të dyja.

Opsioni 2 (marrëveshja më e ngushtë dhe qasja e bazuar zakonore)

1. Rekrutimi me forcë e personave të moshës nën 18 vjeç

Asnjë person nuk duhet të rekrutojë me forcë një person të moshës nën 18 vjeç në forcat e armatosura.

2. Rekrutimi i personave të moshës nën 15 vjeç ose angazhimi i tyre në aksionet armiqësore

Asnjë person nuk duhet:

- a. Të rekrutojë persona të moshës nën 15 vjeç në forcat e armatosura ose grupet e armatosura;
- b. Të përdorë persona nën 15 vjeç në aksionet armiqësore.

3. Rekrutimi apo shfrytëzimi i personave të moshës nën 18 vjeç në grupet e armatosura

Asnjë person nuk duhet:

- a. Të rekrutojë persona të moshës nën 18 vjeçare në një grup të armatosur apo në grupe të armatosura;
- b. Të përdorë persona nën 18 vjeç në aksione armiqësore.
- c. Ky paragraf ka të bëjë me rekrutimin apo shfrytëzimin e personave të moshës nën 18 vjeç nga ana e forcave të armatosura.

4. Dënimet

- 4.1 Çdo person që do të veprojë në kundërshtim me Paragrafin 1 do të thirret në përgjegjësi me dënim me burg jo më shumë se XXX vjet ose me dënim në të holla jo më të lartë se XXX, ose të dyja.

4.2 Çdo person që do të veprojë në kundërshtim me Paragrafin 2 do të thirret në përgjegjësi me dënim me burg jo më shumë se XXX vjet ose me dënim në të holla jo më të lartë se XXX, ose të dyja.

4.3 Çdo person që do të veprojë në kundërshtim me Paragrafin 3 do të thirret në përgjegjësi me dënim me burg jo më shumë se XXX vjet ose me dënim në të holla jo më të lartë se XXX, ose të dyja.

5. Rregulloret për rekrutim në forcat e armatosura

5.1 Anëtarët e forcave të armatosura që nuk kanë mbushur 18 vjet nuk duhet të marrin pjesë direkt në armiqësitë.

5.2 Personat e moshës ndërmjet 15 dhe 17 vjeç mund të rekrutohen në bazë vullnetare në forcat e armatosura të shtetit, në qoftë se respektohen elementet e mëposhtme:

- a. Anëtarët e forcave të armatosura që nuk kanë mbushur 18 vjet nuk do të marrin pjesë direkt në armiqësitë.
- b. Rekrutimi i tillë është vetëm në bazë vullnetare.
- c. Rekrutimi i tillë zbatohet me miratimin e marrë nga prindërit ose përfaqësuesit ligjorë të personit.
- d. Personat e tillë janë të informuar për detyrimet që janë pjesë e shërbimit ushtarak.
- e. Personat e tillë sigurojnë një dëshmi të sigurt për moshën para se të jenë pranuar në shërbimin ushtarak.

5.3 Me rastin e rekrutimit të këtyre personave që kanë mbushur 15 vjet, por nuk kanë mbushur 18 vjet, prioritet u jepet personave më të moshuar.

B. Ligji model për emblemat: Ligji nacional për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës së Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq

Për versionin e ligjit model me komente, shihni në Aneksin II të doracakut të KNKK *Implementimi nacional i të drejtës humanitare ndërkombëtare*.

I. Rregullat e përgjithshme

Neni 1: Fusha e mbrojtjes

Duke pasur parasysh:

- Konventat e Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949, dhe Protokollet e tyre Shtesë I dhe II të 8 qershorit të vitit 1977, duke përfshirë Aneksin 1 të Protokollit Shtesë I në lidhje me rregulloret për identifikimin e njësive dhe transporteve mjekësore, dhe Protokollin Shtesë III të 8 dhjetorit të vitit 2005;

- Rregulloret për përdorimin e emblemës së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe nga ana e shoqatave nacionale, të miratuara në Konferencën e 20-të Ndërkombëtare të Kryqit të kuq, dhe amendamentet pasuese;
- Rezolucioni 1 i Konferencës së 29-të Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (Gjenevë, 20 – 21 qershor i vitit 2006);
- Ligji (dekreti, ose një akt tjetër) i (data) për njohjen e (shoqatës nacionale të ...);

Elementet e mëposhtme janë të mbrojtura me këtë ligj:

- Emblemat e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq në një sfond të bardhë;
- Emrat “Kryqi i kuq”, “Gjysmëhëna e kuqe” dhe “Kristali i kuq”;
- Sinjalet mbrojtëse për identifikimin e njësiteve dhe transporteve mjekësore.

Neni 2: Përdorimi mbrojtës dhe përdorimi tregues

1. Gjatë një konflikti të armatosur, emblema që përdoret si mjet mbrojtës është verifikuar me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë si një shenjë e dukshme për mbrojtjen e personelit mjekësor dhe njësiteve dhe transporteve mjekësore. Prandaj dimensionet e emblemës do të jenë sa të jetë e mundur më të mëdha.
2. Emblema e cila përdoret si mjet tregues tregon se personi ose objekti është i lidhur me institucionin e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Emblema do të jetë me madhësi të vogël.

II. Rregullat e përdorimit të emblemës

A. Përdorimi mbrojtës i emblemës

Neni 3: Përdorimi nga ana e shërbimeve mjekësore të forcave të armatosura

1. Nën kontrollin e ministrisë së mbrojtjes, shërbimi mjekësor i forcave të armatosura të (emri i shtetit), në kohë paqeje dhe në kohë të një konflikti të armatosur, do të përdorin emblemën e (emri i emblemës që do të përdoret) për të shënuar personelin mjekësor, njësitë dhe transportet mjekësore në tokë, det dhe ajër.
Personeli mjekësor do të mbajë shirita në krahë dhe letërnjoftime në të cilat do të theksohet emblema. Këto shirita dhe letërnjoftime do të lëshohen nga – (shembull, ministria e mbrojtjes).
Personeli fetar në forcat e armatosura do të gëzojë mbrojtjen e njëjtë si dhe personeli mjekësor dhe do të identifikohet në mënyrën e njëjtë.
2. Nëse kjo forcon mbrojtjen, shërbimet mjekësore dhe personeli fetar i forcave të armatosura, ndaj emblemës së tyre, pa paragjykime mund të

përdorin kohë pas kohe çdo emblemë mbrojtëse të njohur dhe të gëzojnë një status të barabartë në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë.

Neni 4: Përdorimi nga ana e spitaleve dhe njësive të tjera civile mjekësore

1. Me një autorizim të shpejtë nga ministria e shëndetësisë dhe nën kontrollin e saj, personeli mjekësor civil, spitalet dhe njësitë tjera mjekësore civile, si dhe transportet mjekësore civile, të emëruara në mënyrë të posaçme për transport dhe mjekim të të plagosurve, të sëmurëve dhe personave që kanë pësuar fundosje të anijes, do të shënohen me emblemën që përdoret si mjet mbrojtës në kohë të një konflikti të armatosur.
2. Personeli mjekësor civil do të mbajë në krahë edhe letërnjoftime në të cilat do të jetë theksuar emblema. Këto shirita për në krahë dhe letërnjoftimet do të lëshohen nga ana e ... (ministria e shëndetësisë).
3. Personeli fetar civil në spitalet dhe njësitë tjera mjekësore do të identifikohet në mënyrën e njëjtë.

Neni 5: Përdorimi nga ana e (shoqata nacionale e ...)

1. (Shoqata nacionale e ...) është autorizuar për të vënë personelin mjekësor dhe njësitë dhe transportet mjekësore në dispozicion të shërbimit mjekësor të forcave të armatosura.
Ky personale, njësitë dhe transportet do t'u nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve të luftës dhe mund të autorizohen nga ana e ministrisë së mbrojtjes për të theksuar emblemën mbrojtëse të Kryqit të kuq (Gjysmëhënës së kuqe ose Kristalit të kuq) ose, nëse kjo e rrit mbrojtjen e tyre, mund të përdorin kohë pas kohe çdo emblemë mbrojtëse të njohur dhe të cilët gëzojnë status të barabartë në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë.
Personeli do të mbajë shirita në krahë dhe letërnjoftime, në përputhje me Nenin 3, alineja 2 të këtij ligji.
2. Shoqata nacionale mund të autorizohet për të përdorur emblemën si mjet mbrojtës për personelin e saj mjekësor dhe njësitë mjekësore në përputhje me Nenin 4 të këtij ligji.

B. Përdorimi tregues i emblemës

Neni 6: Përdorimi nga ana e (shoqata nacionale e ...)

1. (Shoqata nacionale e ...) është autorizuar për të përdorur emblemën si mjet tregues me qëllim që të tregojë se një person ose një objekt i caktuar është i lidhur me shoqatën nacionale. Dimensionet e emblemës do të jenë të vogla, për të shmangur çdo konfuzion me emblemën që përdoret si mjet mbrojtës.

2. (Shoqata nacionale e ...) mundet, në përputhje me legjislacionin nacional dhe në rrethana të jashtëzakonshme dhe për të lehtësuar punën e saj, kohë pas kohe të përdorë Kristalin e kuq.
3. (Shoqata nacionale e ...) do të zbatojë “Rregulloret për përdorimin e emblemës së Kryqit të kuq ose Gjysmëhënës së kuqe nga ana e shoqatave nacionale”.
4. Shoqatat nacionale të vende të tjera të pranishme në territorin e (emri i shtetit) me miratimin e (shoqata nacionale e ...) do të kenë të drejtë për të përdorur emblemën nën kushtet e njëjta.

C. Organizatat ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

Neni 7: Përdorimi i emblemave nga ana e organizatave ndërkombëtare të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

1. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq dhe Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe mund të përdorin emblemat e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në çdo kohë dhe për të gjitha aktivitetet e veta.
2. Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq dhe Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe personeli i tyre i autorizuar mund të përdorin Kristalin e kuq në rrethana të jashtëzakonshme dhe për të lehtësuar punën e tyre.

III. Kontrolli dhe dispozitat ndëshkuese

Neni 8: Masat e kontrollit

1. Autoritetet e (emri i shtetit) në çdo kohë do të sigurojnë respektim konsekuent të rregullave të lidhura me përdorimin e emblemave të Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe dhe Kristalit të kuq, emrat “Kryqi i kuq”, “Gjysmëhëna e kuqe” dhe “Kristali i kuq”, dhe sinjalet mbrojtëse. Ato do të kryejnë një kontroll rigoroz mbi personat që janë të autorizuar për të përdorur emblemat, emrat dhe sinjalet e përmendura.
2. Autoritete do të ndërmarrin të gjitha hapat e domosdoshëm për të parandaluar keqpërdorimin, veçanërisht:
 - Përmes diseminimit të gjerë të rregullave tek forcat e armatosura, policia, organet shtetërore dhe popullsia civile;
 - Përmes dhënies së instruksioneve për shërbimet nacionale civile dhe ushtarake për përdorimin e emblemës mbrojtëse në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë dhe përmes sigurimit

të sanksioneve përkatëse penale, administrative dhe disiplinore në rast të keqpërdorimit.

Neni 9: Keqpërdorimi i emblemës si mjet mbrojtës gjatë kohës së një konfliktit të armatosur

1. Çdonjëri që me vetëdije ka kryer ose ka dhënë urdhër për t'u kryer vepra që kanë rezultuar me vdekje, ose kanë shkaktuar një dëm serioz trupor ose shëndetësor, si rezultat i shfrytëzimit tinëzar të emblemës së Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe ose sinjalit mbrojtës, ka kryer krim të luftës dhe do të dënohet me burg në kohëzgjatje prej (...) vjetësh. Përdorimi tinëzar i Kristalit të kuq nën kushtet e njëjta i nënshtrohet dënimit të njëjtë. Përdorimi perfid do të thotë shfrytëzim i vullnetit të mirë të palës kundërshtare, me qëllim që të mashtrohet dhe të besojë se personi ka të drejtë të jetë objekt i mbrojtjes në përputhje me rregullat e së drejtës humanitare ndërkombëtare.
2. Çdonjëri që në kohë të një konflikti të armatosur me vetëdije dhe me pa të drejtë përdor shenjën e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe ose Kristalit të kuq ose sinjalin mbrojtës, ose çdo shenjë tjetër që përfaqëson imitim të mund të çojë në konfuzion, do të dënohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej (... muajsh ose vitesh).

Neni 10: Keqpërdorimi i emblemës si mjet tregues në paqe dhe në kohë të një konflikti të armatosur

1. Çdonjëri që me vetëdije dhe me pa të drejtë ka përdorur emblemën e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe ose Kristalit të kuq, fjalët "Kryqi i kuq", "Gjysmëhëna e kuqe" ose "Kristali i kuq", sinjalin mbrojtës ose çdo shenjë tjetër që përfaqëson imitim ose që mund të çojë në konfuzion, pa marrë parasysh qëllimin e këtij përdorimi; Çdonjëri që ka theksuar emblemën e përmendur ose fjalët e shenjës, posterët, shpalljet, flajerët ose dokumentet komerciale, ose që i ka vënë në mallrat ose paketimet, ose i ka shitur, i ka ofruar për shitje ose i ka vënë në qarkullim të shënuara në këtë mënyrë; Do të dënohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej (... ditësh ose muajsh) dhe/ose do të duhet të paguajë dënim në të holla në lartësi të (shuma e valutës lokale).
2. Nëse dënimi është kryer në menaxhmentin e një trupi korporativ (kompani komerciale, asociacion etj.), dënimi do të zbatohet për personat që kanë kryer shkeljes ose për personat që kanë urdhëruar kryerjen e shkeljes.

Neni 11: Keqpërdorimi i Kryqit të bardhë në Sfond të kuq

Si rezultat i konfuzionit që mund të paraqitet në mes stemës së Zvicrës dhe emblemës së Kryqit të kuq, përdorimi i kryqit të bardhë në sfond të kuq, ose çdo shenjë që përfaqëson imitim të tillë, si shenjë mbrojtëse ose shenjë komerciale ose si komponentë e shenjave të tilla, ose për një qëllim të kundërt me tregtinë e drejtë, ose në rrethana të cilat me gjasë mund të cenojnë ndjenjat

e një qytetari zviceran, gjithashtu është e ndaluar në çdo kohë; shkelësit do të dënohen me pagim të dënimit në lartësi prej (shuma e valutës lokale).

Neni 12: Masat e përkohshme

Autoritetet e (emri i shtetit) do të ndërmarrin masat e nevojshme të përkohshme. Autoritetet mund të urdhërojnë marrjen e objekteve dhe materiale që kryejnë cenimin e këtij ligji, të kërkojnë heqjen e emblemës së Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe ose Kristalit të kuq ose të fjalëve “Kryqi i kuq”, “Gjysmëhëna e kuqe” ose “Kristali i kuq”, në llogari të kryerësit të shkeljes, dhe të urdhërojnë shkatërrimin e instrumenteve që janë përdorur për riprodhimin e tyre.

Neni 13: Regjistrimi i asociacioneve, emrave tregtarë dhe shenjave mbrojtëse

1. Regjistrimi i asociacioneve dhe emrave tregtarë, dhe arkivimi i shenjave mbrojtëse, shenjave komerciale dhe modeleve dhe dizajneve industriale duke përdorur emblemën e Kryqit të kuq, Gjysmëhënës së kuqe ose Kristalit të kuq, ose emrat “Kryqi i kuq”, “Gjysmëhëna e kuqe” ose “Kristali i kuq”, përfaqëson shkelje të këtij ligji dhe do të refuzohet.
2. Personat që përdorin Kristalin e kuq ose emrin “Kristali i kuq”, ose çdo shenjë tjetër që është imitim, para miratimit të Protokollit Shtesë III, do të lejohen të vazhdojnë që ta përdorin atë, në qoftë se theksojnë se përdorimi i tij nuk do të jetë i tillë në kohë të një konflikti të armatosur për të penguar mbrojtjen e Konventave të Gjenevës dhe Protokollet e tyre Shtesë, në qoftë se të drejtat e tilla i ka fituar subjekti para hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 14: Roli i (shoqata nacionale e ...)

(Shoqata nacionale e ...) do të bashkëpunojë me organet shtetërore në përpjekjet e tyre për të penguar ose ndaluar çdo keqpërdorim. Shoqata nacionale ka të drejtë për të informuar (organin përgjegjës) për një keqpërdorim të tillë dhe të marrë pjesë në procedurat relevante penale, qytetare ose administrative.

IV. Zbatimi dhe hyrja në fuqi

Neni 15: Zbatimi i ligjit ekzistues

... (Ministria e mbrojtjes, ministria e shëndetësisë) është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Neni 16: Hyrja në fuqi

Ky ligj do të hyjë në fuqi më (data e miratimit, etj.).

C. E Drejta e pashkruar në lidhje me konventën e municioneve tërmmuese të vitit 2008

Për versionin e ligjit model me komente, shihni në Aneksin XII të doracakut të KNKK *Implementimi nacional i të drejtës humanitare ndërkombëtare*.

Pjesa 1 – Preliminare

I. Emri i shkurtë dhe data e hyrjes në fuqi

1. Ky ligj mund të citohet si Ligji i Municionit Thërrmues (shkruani vitin).
2. Ky ligj hyn në fuqi më (shkruani datën/procedurën).

II. Interpretimi

Në këtë ligj –

1. “municioni thërrmues i braktisur” do të thotë municioni thërrmues ose municioni eksplozues që nuk përdoret dhe është lënë ose është hedhur, dhe nuk është më nën kontrollin e palës që e ka vendosur ose e ka hedhur. ai mund të jetë i përgatitur ose të mos jetë i përgatitur për t’u përdorur.
2. “municioni thërrmues” do të thotë municion konvencional që është dizajnuar për t’u thërrmuar ose për të liruar pjesë të municionit çdonjëra prej tyre duke peshuar më pak se 20 kilogramë, dhe është përbërë nga këto pjesë eksplozive të municionit. ky term nuk ka kuptimin e mëposhtëm:
 - a. municion ose pjesë e municionit i dizajnuar për të lëshuar zjarr, tym, piroteknikë; ose municion i dizajnuar vetëm për dedikim kundërajror;
 - b. municion ose pjesë e municionit i dizajnuar për të prodhuar efekte elektrike ose elektronike;
 - c. municion i cili me qëllim që të shmangë efektet selektive dhe rreziqet që dalin nga pjesët e pa eksploduara të municionit, i ka këto karakteristika:
 - I. çdo municion përmban më pak se 10 pjesë eksplozive të municionit;
 - II. çdo pjesë municioni peshon më shumë se 4 kilogramë;
 - III. çdo pjesë municioni eksploziv është dizajnuar për të zbuluar dhe qëlluar një cak të veçantë;
 - IV. çdo pjesë e municionit eksploziv është pajisur me mekanizëm elektronik vetë-shkatërrues;
 - V. çdo pjesë e municionit eksploziv është pajisur me një mekanizëm vetë-çaktivizues.
3. “Zona e kontaminuar nga municioni thërrmues” është zona e njohur si ose për të cilën ekziston dyshimi se përmban mbetje të municionit thërrmues.

4. “Mbetjet e municionit thërrmues” do të thotë municioni thërrmues i çaktivizuar, municioni thërrmues i braktisur, pjesë të pa eksploduar të municionit dhe bomba të pa eksploduar.
5. “Viktimat e municionit thërrmues” janë të gjithë personat të janë vrarë ose kanë pësuar një lëndim fizik ose psikologjik, kanë pësuar humbje ekonomike, marginalizim social ose që kanë pengesa të konsiderueshme në realizimin e të drejtave të tyre si rezultat i përdorimit të municionit thërrmues. Këtu janë përfshirë ata persona që kanë pësuar një ndikim direkt të municionit thërrmues si dhe familjet dhe komunitetet e tyre.
6. “Konventa” do të thotë Konventa e Municionit Thërrmues e vitit 2008.
7. “Bombol me vrimë nxjerrëse” nënkupton një kontejner të dizajnuar për të shpërndarë ose lëshuar bomba shpërthyes, i cili është bashkangjitur një fluturakeje në kohën e shpërndarjes ose lirim të tij.
8. “Pjesa shpërthyesë e municionit” nënkupton municionin konvencional i cili për të kryer detyrën e tij shpërndahet ose lëshon municion thërrmues dhe është dizajnuar për të funksionuar përmes detonimit të mbushjes shpërthyesë para, gjatë, ose pas goditjes.
9. “Bomba shpërthyes”, nënkupton një municion konvencional që peshon më pak se 20 kilogramë, e cila nuk është vetëlëvizëse dhe e cila për të kryer detyrën e saj, shpërndahet ose lëshohet nga spërkatësi, dhe funksionon përmes detonimit të mbushjes shpërthyesë, para, gjatë ose pas goditjes.
10. “Municioni thërrmues i pasuksesshëm” nënkupton municionin thërrmues që është gjuajtur, lëshuar, lansuar, hedhur me projektil ose në një mënyrë tjetër është hedhur, i cili duhet të shpërndahet ose të lëshojë mbushjes e tij shpërthyesë, por që nuk ka pasur sukses.
11. “Mina” nënkupton municionin e dizajnuar për t’u vendosur nën, në ose afër tokës ose zonave të tjera sipërfaqësore dhe të shpërthejë në prani, afërsi ose në kontakt me një person ose automjet.
12. “Mekanizmi vetë-shkatërrues” nënkupton një mekanizëm të inkorporuar automatik funksion i cili është plotësim i mekanizmit primar inicial të municionit, i cili mundëson shkatërrimin e municionit në të cilin është inkorporuar.
13. “Transferimi” nënkupton, krahas lëvizjes fizike të municionit thërrmues në ose nga territori nacional, transferimi deri te dhe kontrolli mbi municionin thërrmues, por nuk nënkupton transferimin në territor duke përmblajtur mbetje të municionit thërrmues.
14. “Bombat e pashpërthyer” nënkupton bombat shpërthyesë të cilat janë shpërndarë, liruar ose në një mënyrë tjetër janë ndarë nga spërkatësi dhe nuk kanë arritur të shpërthejnë siç ka qenë qëllimi.

15. "Pjesët e pashpërthyera të municionit" nënkupton pjesët shpërthyese të municionit të cilat janë shpërndarë ose liruar, ose në një mënyrë tjetër janë ndarë nga municioni thërmues por që nuk kanë arritur të shpërthejnë siç është dashur për të shpërthyer.

Pjesa 2 – Ndalesat dhe lëndimet

III. Sjellja e ndaluar

1. Në përputhje me Nenin 6, asnjë person nuk duhet të përdorë municion thërmues.
2. Në përputhje me Nenin 6, asnjë person nuk duhet direkt ose indirekt –
 - a. të zhvillojë ose prodhojë municion thërmues;
 - b. të furnizojë municion thërmues;
 - c. të posedojë, ruajë ose depozitojë municion thërmues;
 - d. të bartë municion thërmues për ndokënd.
3. Në përputhje me Nenin 6, asnjë person nuk duhet të ndihmojë, inkurajojë ose shtyjë ndokënd për t'u angazhuar në ndonjë aktivitet që ka të bëjë me alinenë 1 dhe alinenë 2 më lart.
4. Alinetë 1 dhe 2 të këtij Neni zbatohen, *mutatis mutandis*, në bomba shpërthyese që janë të dizajnuara në mënyrë specifike për t'u shpërndarë ose liruar nga spërkatësi i cili është bashkëngjitur në një fluturake.
5. Ky ligj nuk ka të bëjë me minat.

IV. Shkeljet dhe dënimet

1. Çdo person që do të jetë në kundërshtim me Paragrafin 3 do të jetë përgjegjës për shkelje dhe do të bartë përgjegjësi:
 - a. në rast të një individi, dënimi me burg në kohëzgjatje jo më gjatë se () vjet ose dënim në të holla jo më i madh se (), ose të dyja;
 - b. në rast të një korporate, dënim jo më i lartë se ().
2. Kur dënimi nga alineja 1 e këtij Paragrafi, i kryer nga korporata do të dëshmohej se është kryer me miratim ose heshtje, ose si rezultat i neglizhencës së një pjese të çdo drejtori, menaxheri ose një udhëheqësi tjetër të ngjashëm të një korporate, ose çdo trupi tjetër që ka vepruar në këtë cilësi, ky person, si dhe trupi korporativ do të jenë fajtorë për këtë shkelje dhe do të mbajnë përgjegjësinë për të ngritur procedurë kundër tyre dhe të jenë të dënuar në përputhje me alinenë 1 të këtij Paragrafi.

3. Çdo gjykatë, që do të gjykojë një person në përputhje me alinenë 1 (a) ose (b), mund të urdhërojë që municioni i përdorur thërrmues ose një mjet tjetër për kryerjen e shkeljes të konfiskohet nga shteti.

V. Zbatimi jashtë-territorial

Paragrafi 3 ka të bëjë me sjelljen jashtë territorit të (shkruani emrin e vendit) të qytetarëve të (shkruani emrin e vendit) dhe korporatave të inkuorporuara në përputhje me ligjin e (shkruani emrin e vendit).

VI. Përfjashtimet: Sjellja e lejuar

Paragrafi 3 nuk zbatohet në:

1. furnizimin, posedimin, mbajtjen ose transferimin e municionit thërrmues, pjesëve shpërthyer të municionit dhe bombave shpërthyesë, në përputhje me lejen në fuqi sipas Paragrafit 11;
2. posedimin, ruajtjen dhe transferimin e municionit thërrmues dhe pjesëve shpërthyesë të municionit dhe bombave shpërthyesë nga ana e anëtarëve të (shkruani emrin e forcave të armatosura), një nëpunësi policor, një nëpunësi gjyqësor, një nëpunësi doganor ose çdo personi tjetër i emëruar nga ministri me lajmërim me shkrim gjatë detyrës së atij personi për shkak të:
 - a. rrjedhës së procedurës penale;
 - b. demontimin e municionit thërrmues;
 - c. ruajtjen e municionit thërrmues për shkak të shkatërrimit të ardhshëm;
 - d. dërgimi i municionit thërrmues (shkruani emrin e organit/personit të emëruar nga ministri) për shkak të shkatërrimit.

Pjesa 3 – Mbledhja dhe shkatërrimi i municionit tërhmues

VII. Lajmërimi për municionin tërhmues

Çdo person që është i njohur se posedon municion tërhmues dhe/ose bomba shpërthyesë, pjesë shpërthyesë të municionit ose mbetje të municionit tërhmues, në mënyrën e cila dallon nga Paragrafi 6, duhet pa vonesë, të lajmërojë (emri i organit shtetëror/personit të emëruar nga ministri) për të rregulluar mbledhjen dhe shkatërrimin.

VIII. Shkatërrimi i municionit tërhmues

Në përputhje me Paragrafin 10, ministri do të sigurojë:

1. Shkatërrimin e gjithë municionit të depozituar tërhmues, bombat shpërthyesë dhe pjesët shpërthyesë të municionit që i posedon ose që i ka (shkruani emrin e vendit) ose që janë nën juridiksionin dhe kontrollin e tij;
2. Mbledhjen dhe shkatërrimin e tërë municionit tërhmues në përputhje me Nenin 7.

IX. Zonat e kontaminuara të municionit tërhmues

Kur një zonë e caktuar është identifikuar si zonë e kontaminuar nga municioni tërhmues ose nëse ekziston dyshimi se zona është e kontaminuar si rezultat i municionit tërhmues, ministri do të sigurojë si vijon, sa të jetë e mundur më shpejtë në këtë zonë nën juridiksionin ose kontrollin e shtetit:

1. do të zbatohet një anketë, vlerësim dhe regjistrim i kanosjes që del nga mbetjet e municionit tërhmues dhe do të bëhet çdo përpjekje për të identifikuar zonat e kontaminuara nga municioni tërhmues;
2. do të bëhet vlerësimi dhe dhënia e përparësisë së nevojave në lidhje me shënimin e mbrojtjes së civilëve, pastrimin dhe shkatërrimin, dhe ndërmarrjen e hapave për mobilizimin e resurseve dhe përgatitjen e një plani nacional për zbatimin e këtyre aktiviteteve;
3. ndërmarrja e të gjitha hapave të mundshëm për të siguruar që zonat e kontaminuara nga municioni tërhmues të jenë shënuar në perimetër, të monitoruara dhe të mbrojtura nga gardhe ose mjete të tjera për të siguruar pengimin efektive të qasjes së civilëve;
4. pastrimi dhe shkatërrimi i të gjitha mbetjeve të municionit tërhmues; dhe
5. zbatimi i edukimit për uljen e rreziqeve për të ngritur ndërgjegjen e popullsisë civile që jeton në ose rreth zonave të kontaminuara nga municioni tërhmues për rreziqet që ekzistojnë si rezultat i këtyre mbetjeve.

X. Ndihma për viktimat

Në përputhje me ministritë relevante, ministri do të sigurojë pajtueshmëri me obligimet që dalin nga Konventa, në lidhje me edukimin për rreziqet dhe ndihmën për viktimat, sidomos për shkak të:

1. vlerësimit të nevojave të viktimave nga municioni thërrmues;
2. përgatitjes, implementimit dhe zbatimit të çdo ligji dhe politike të nevojshme nacionale;
3. përgatitja e planit dhe buxhetit nacional, duke përfshirë kornizat kohore për zbatimin e këtyre aktiviteteve, me qëllim të inkorporimit të tyre në kornizat ekzistuese nacionale dhe mekanizmat e ndihmës për personat me handicap dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut, me respekt të plotë të rolit specifik dhe kontributit të faktorëve relevantë;
4. ndërmarrja e hapave për mobilizimin e resurseve nacionale ndërkombëtare;
5. mos bërja e diskriminimit të viktimave të municionit thërrmues, ose në mesin e viktimave të municionit thërrmues dhe personat që kanë marrë lëndime ose handicap për arsye të tjera; dallimet në trajtimin e tyre duhet të bazohen vetëm në bazë të nevojave mjekësore, rehabilituese, psikologjike dhe socio-ekonomike;
6. konsultimi i ngushtë me viktimat e përfshira në mënyrë aktive të municionit thërrmues dhe organizatat e tyre përfaqësuese;
7. emërimi i një personi kontakti në qeveri për koordinimin e çështjeve të lidhura me implementimin e këtij Neni;
8. përpjekje për inkorporimin e udhëzimeve relevante dhe praktikave të mira, duke përfshirë këto zona për kujdes mjekësor, rehabilitim dhe mbështetje psikologjike, si dhe përfshirje sociale dhe ekonomike.

XI. Leja për marrjen, mbajtjen ose transferimin

1. ministri mundet, në formë të shkruar të japë leje për të përcaktuar një sasi të municionit thërrmues, bombat shpërthyes dhe pjesët shpërthyes të municionit të mbahen ose të furnizohen, për zhvillim ose trajnim të teknikave të zbulimit, pastrimit ose shkatërrimit të bombave shpërthyes të municionit thërrmues, dhe pjesët shpërthyes të municionit ose për shkak të zhvillimit të masave të luftës kundër municionit thërrmues, por numri i këtyre produkteve nuk duhet të tejkalojë numrin minimal të absolutisht të domosdoshmet për këtë qëllim.
2. është i lejuar transferimi i municionit thërrmues në një shtet tjetër për shkak të shkatërrimit, si dhe për qëllime të përshkruara në alinenë 1 të këtij Paragrafi.

Pjesa 4 – Informimi – organet për mbledhjen e informacioneve

XII. Kërkesa për sqarim

Ministri, në qoftë se merr kërkesë për sqarim nga një shtet tjetër, lidhur me çështjet e pajtueshmërisë së dispozitave të Konventës, do të sigurojë, përmes Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në afat prej 28 ditësh, të gjitha informacionet që do të ndihmojnë në sqarimin e çështjes.

XIII. Marrja e informacioneve dhe dokumenteve

Ministri mundet me lajmërim me shkrim të kërkojë nga çdo person t'i japë ministrit informacione ose dokumente të tilla siç qëndron në lajmërimin, nëse ministri ka arsye të besojë se ai ose ajo kanë informacione ose dokumentet që janë relevante për:

1. administratën ose zbatimin e këtij ligji;
2. detyrimin e (emri i shtetit) për të paraqitur raport në përputhje me Nenin 7 të Konventës;
3. detyrimin e (emri i shtetit) për të siguruar informacion në përputhje me Nenin 8 të Konventës;

XIV. Mosrespektimi i dispozitave dhe sigurimi i informacioneve të gabuara

Çdo person që:

1. pa arsyetim të arsyeshëm nuk do të respektojë lajmërimin që i është dorëzuar nga ana e ministrit;
2. me vetëdije jep deklaratë të gabuar ose të rrejshme si përgjigje e lajmërimit të dhënë;

do të jetë fajtor për kundërvajtje dhe përgjegjës, sipas akuzës, në dënim me burg jo më gjatë se () vjet apo dënim në të holla në lartësi prej (), ose të dyja.

Pjesa 5 – Administrimi i ligjit

XV. Rregulloret

(Shkruani emrin e organit shtetëror) mund të sjellë rregullore për çështje të tjera që do të jenë të nevojshme ose të lejuara të përshkruhen, ose që janë të nevojshme ose adekuate të përshkruhen, për të zbatuar ose për të hyrë në fuqi ky ligj.

XVI. Detyrimi i ligjit ndaj shtetit

Ky ligj është i detyrueshëm për shtetin.

Orari

Konventa për municionin thërrmues

D. Ligji model i Konventave të Gjenevës

Ligji për hyrjen në fuqi të disa konventave të miratuara në Gjenevë më 12 gusht të vitit 1949, dhe Protokollet Shtesë I dhe II të Konventave të sjella më 8 qershor të vitit 1977 dhe Protokoli Shtesë III i këtyre Konventave i 8 dhjetorit të vitit 2005, dhe për qëllime të ngjashme

Miratuar nga (Parlamenti, shkruaje emrin e vendit):

Pjesa 1 – Preliminare

I. Emri i shkurtë dhe hyrja në fuqi

1. ky ligj mund të citohet si ligj i Konventave të Gjenevës (shkruaje vitin).
2. ky ligj hyn në fuqi më (shkruaje vitin).

II. Interpretimi

1. në këtë ligj, përveç nëse nuk paraqitet një qëllim i kundërt –

“gjkata” nuk nënkupton nxjerrjen para gjykatës ushtarake ose një gjykate tjetër të armatës;

“Konventa e Parë” nënkupton Konventën e Gjenevës për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në luftë e 12 gushtit të vitit 1949, kopja e Konventës (duke mos përfshirë anekset e kësaj Konvente) është përmendur në Orarin 1;

“Konventa e Dytë” nënkupton Konventën e Gjenevës për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve dhe të sëmurëve dhe atyre që kanë pësuar një fundosje të anijes pjesëtarë të forcave të armatosura detare e 12 gushtit të vitit 1949, kopja e Konventës (duke mos përfshirë anekset e kësaj Konvente) është përmendur në Orarin 2;

“Konventa e Tretë” nënkupton Konventën e Gjenevës për veprimin me të burgosurit e luftës e 12 gushtit të vitit 1949, kopja e Konventës (duke mos përfshirë anekset e kësaj Konvente) është përmendur në Orarin 3;

“Konventa e Katërt” nënkupton Konventën e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë gjatë kohës së luftës e 12 gushtit të vitit 1949, kopja e Konventës (duke mos përfshirë anekset e kësaj Konvente) është përmendur në Orarin 4;

“Konventat” nënkupton Konventën e Parë, Konventën e Dytë, Konventën e Tretë dhe Konventën e Katërt;

“përfaqësuesi i të burgosurve” në lidhje me një të burgosur të mbrojtur të luftës në një periudhë të caktuar kohore nënkupton personin i cili ka kryer funksionet e përfaqësuesit të të burgosurve në kuadër të kuptimit të Nenit 79 të Konventës së Tretë në lidhje me një të burgosur në kamp ose në një vend ku ka qenë i burgosuri, ose që për herë të fundit para atij momenti është burgosur si i burgosur i mbrojtur i luftës;

“personi i mbrojtur i internuar” nënkupton personin e mbrojtur me Konventën e Katërt të Gjenevës ose Protokollin I dhe i internuar në (shkruani emrin e vendit);

“i burgosuri i mbrojtur i luftës” nënkupton personin me Konventën e Tretë të Gjenevës që është i mbrojtur si i burgosur i luftës në përputhje me Protokollin I;

“forca mbrojtëse” në lidhje me një të burgosur të mbrojtur të luftës ose një person të mbrojtur të internuar, nënkupton forcën ose organizimin që zbatohet, në interes të fuqisë shtetas i së cilës është, ose të cilat fuqi i përfaqëson ose që ka qenë një periudhë të caktuar kohore anëtar, ka përmbushur detyra për forcat mbrojtëse me Konventën e Tretë, Konventën e Katërt ose Protokollin I, varësisht nga rasti;

“Protokolli I” nënkupton Protokollin Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949, i cili ka të bëjë me Mbrojtjen e Viktimave në Konfliktet e Armatosura Ndërkombëtare (Protokolli I) të 8 qershorit të vitit 1977, kopja e këtij Protokolli (duke përfshirë Aneksin 1 të këtij Protokolli) është përmendur në Orarin 5;

“Protokolli II” nënkupton Protokollin Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949, i cili ka të bëjë me Mbrojtjen e Viktimave në Konfliktet e Armatosura Jo-ndërkombëtare (Protokolli II) të 8 qershorit të vitit 1977, kopja e këtij Protokolli është përmendur në Orarin 6;

“Protokolli III” nënkupton Protokollin Shtesë të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit të vitit 1949, i cili ka të bëjë me Miratimin e Emblemës Mbrojtëse Shtesë (Protokolli III) të 8 dhjetorit të vitit 2005, kopja e këtij Protokolli është përmendur në Orarin 7;

“Protokollet” nënkupton Protokollin I, Protokollin II dhe Protokollin III.

2. nëse ratifikimi në emrin e (shkruaje emrin e shtetit) të çdo Konvente ose ndonjërit nga Protokollet i nënshtrohet të përmbajturit ose është i shoqëruar me deklaratë, ajo Konventë ose ai Protokoll, për qëllimet e këtij ligji, do të hyjë në fuqi dhe do të interpretohet në përputhje me atë të përmbajtur ose deklaratë.

Pjesa 2 – Dënimi për shkelësit e Konventave dhe Protokollit I

III. Dënimet e shkeljeve të rënda të Konventave dhe Protokollit I

1. çdo person, pa marrë parasysh nacionalitetin e tij, i cili në (shkruaje emrin e shtetit), ose në një vend tjetër, kryen, ose ndihmon, nxit ose blen ndonjë person për të kryer një shkelje të rëndë të ndonjë Konvente, Protokollin I Protokollin III, është fajtor për një shkelje ndëshkuese.
2. për qëllimet e këtij paragrafi:
 - a. shkelje e rëndë e Konventës së parë është shkelja e asaj Konvente që nënkupton veprën e përmendur në Nenin 50 të asaj Konvente të kryer mbi persona ose pasuri të mbrojtur me këtë Konventë;
 - b. shkelje e rëndë e Konventës së dytë është shkelja e asaj Konvente që nënkupton veprën e përmendur në Nenin 51 të asaj Konvente të kryer mbi persona ose pasuri të mbrojtur me këtë Konventë;
 - c. shkelje e rëndë e Konventës së tretë është shkelja e asaj Konvente që nënkupton veprën e përmendur në Nenin 130 të asaj Konvente të kryer mbi persona ose pasuri të mbrojtur me këtë Konventë;
 - d. shkelje e rëndë e Konventës së katërt është shkelja e asaj Konvente që nënkupton veprën e përmendur në Nenin 147 të asaj Konvente të kryer mbi persona ose pasuri të mbrojtur me këtë Konventë;
 - e. shkelje e rëndë e Protokollit I është gjithçka që ka të bëjë me një shkelje të rëndë të Protokollit I në alinenë 4 të Nenit 11, ose alineja 2, 3 ose 4 e Nenit 85 të Protokollit; dhe
 - f. shkelje e rëndë e Protokollit III është çdo keqpërdorim i emblemës së Protokollit të Tretë që ka të bëjë me një përdorim tinëzar në kuptimin e Nenit 85, alineja f) e Protokollit I.
3. në rast të një cenimi të këtij Paragrafi i kryer jashtë (shkruaje emrin e shtetit), kundër personit mund të zhvillohet procedurë, të akuzohet, gjykohet dhe dënuar për këtë qëllim në çdo vend në (shkruaje emrin e shtetit), nëse shkelja është bërë në atë vend, dhe cenimi, për të gjitha qëllimet e rastit ose konsekuente të gjyqimit ose dënimit, do të konsiderohen se janë kryer në atë vend.

IV. Dënimi për shkeljet e rënda të Konventave dhe Protokollit I

1. çdo person, pa marrë parasysh nacionalitetin e tij, i cili në (shkruaje emrin e shtetit), kryen, ose ndihmon, nxit ose blen ndonjë person tjetër për të kryer një shkelje të rëndë të ndonjë nga Konventat ose Protokollet, që nuk janë përfshirë me Paragrafin 3, është fajtor për shkelje të dënueshme.
2. çdo shtetas i (shkruaje emrin e shtetit), i cili jashtë nga (shkruaje emrin e shtetit), kryen ose ndihmon, nxit ose blen provizion nga një person tjetër për të shkelur ndonjë Konventë ose Protokollet që nuk janë përfshirë në Paragrafin 3, është fajtor për një shkelje të dënueshme.

V. Dënimet dhe procedura

1. dënimi për shkeljen e Paragrafit 3 ose Paragrafit 4 është:

- a. kur dënimi nënkupton vrasjen me vetëdije të personit të mbrojtur me një Konventë relevante ose me Protokollin I – burg i përjetshëm ose ndonjë periudhë më e vogël; dhe
- b. në çdo rast tjetër – dënim me burg në kohëzgjatje jo më gjatë se 14 vjet.

2. Shkelja e paragrafit 3 ose paragrafit 4 nuk do të përndiqet në mënyrë gjyqësore përveç në rast se ka akuzë nga ana e (Prokurorit Publik).

VI. Dëshmia për zbatimin e Konventave ose Protokolleve

Nëse, në një procedurë në përputhje me këtë vepër në lidhje me shkeljen e ndonjë nga Konventat ose ndonjë nga Protokollet, u paraqit pyetja sipas:

- a. Nenit 2 ose Nenit 3 të asaj Konvente (i cili ka të bëjë me rrethanat në të cilat zbatohet Konventa);
- b. Nenit 1 ose Nenit 3 të Protokollit I (i cili ka të bëjë me rrethanat në të cilat zbatohet Protokollin);
- c. Nenit 1 të Protokollit II (i cili ka të bëjë me rrethanat në të cilat zbatohet Protokollin);
- d. Nenit 1 të Protokollit III (i cili ka të bëjë me rrethanat në të cilat zbatohet Protokollin);

Një certifikatë e nënshkruar nga (Ministri i Punëve të Jashtme) me të cilën konfirmohet se puna relevante për këtë çështje është prima facie dëshmi e punës së dëshmuar në këtë mënyrë.

VII. Juridiksioni i gjykatave

1. një person nuk do të gjykohet për cenimin e paragrafit 3 ose paragrafit 4 nga një gjykatë tjetër, përveç (shkruaje emrin e gjykatës).
2. dispozitat lidhur me gjykimin nga ana e gjykatës supreme për personat që kanë kryer shkelje civile do të jenë të plotfuqishme për qëllimet e juridiksionit të gjykatës supreme e thirru në (shkruaje emrin e shtetit) si kjo pjesë të mos ketë kaluar.

Pjesa 3 – Procedurat ligjore në lidhje me respektimin e personave të mbrojtur

VIII. Lajmërimi për seanca për personat e mbrojtur zbatuar nga forca mbrojtëse.

1. Gjykata para së cilës:

- a. do të gjykohet një i burgosur i mbrojtur i luftës për shkak të shkeljes; ose
- b. do të gjykohet një person i mbrojtur i internuar për shkelje për të cilën gjykata është e autorizuar për ta gjykuar ose për ta burgosur në periudhë prej 2 vitesh ose më shumë;

nuk do të vazhdojë gjykimin derisa të mos dëshmohet në kënaqësi të gjykatës se lajmërimi që i përmban veçoritë e përmendura në alinenë (2), në qoftë se ato janë të njohura për prokurorin, është dorëzuar të paktën para 3 javësh dhe nga ana e palës së mbrojtur (nëse ka palë mbrojtëse), dhe nëse i akuzuari është i burgosur i mbrojtur i luftës, të akuzuarit dhe përfaqësuesit të të burgosurit.

2. Veçoritë e përmendura në nën-alinenë (1) janë:

- a. emri i plotë, data dhe ditëlindja dhe përshkrimi i të pandehurit, duke përfshirë profesionin e tij/të saj; dhe nëse i akuzuari është i burgosur i mbrojtur i luftës, akti i të pandehurit dhe numri i tij/saj i armatës, numri i regjimentit, numri i tij personal dhe serik;
- b. vendi i paraburgimit, internimit ose qëndrimit të të pandehurit;
- c. shkelja për të cilën akuzohet i pandehuri; dhe
- d. gjykata para së cilës zhvillohet gjykimi dhe koha dhe vendi i përcaktuar për procesin gjyqësor.

3. Për qëllimet e këtij paragrafi, duhet të ketë një dokument:

- a. nënshkruar nga emri i forcës mbrojtëse ose nga përfaqësuesi i të burgosurit ose nga personi i pandehur, varësisht nga rasti; dhe
- b. vërtetim se është pranuar nga ajo forcë, përfaqësuesi i personit në ditën e caktuar të lajmërimit i përshkruar në dokumentin si lajmërim sipas këtij paragrafi;

do të jetë, përveç nëse nuk tregohet e kundërta, një dëshmi e mjaftueshme se lajmërimi i nevojshëm nga neni (1) i është dorëzuar asaj force, përfaqësuesit ose personit në atë ditë.

4. Gjykata që do të ndërpresë gjykimin për të mundësuar përmbushjen e këtij paragrafi në përputhje dhe me ligje të tjera të ngjashme do të prolongojë procesin derisa është ndërprerë seanca.

IX. Përfaqësimi juridik i disa personave

1. Gjykata para së cilës:

- a. do të nxirret personi për t'u gjykuar për shkelje sipas paragrafit 3 dhe paragrafit 4 të këtij ligji; ose

- b. do të nxirret një i burgosur i mbrojtur i luftës për t'u gjykuar për ndonjë shkelje;

nuk do të vazhdojë gjykimi përveç nëse –

- të pandehurin e përfaqëson një avokat; dhe
- nuk dëshmohej në kënaqësi të gjykatës se periudha prej jo më pak se 14 ka kaluar pasi për herë të parë i janë dorëzuar avokatit instruksionet për përfaqësimin e të pandehurit në gjykatë.

dhe, nëse gjykata ndërpret gjykimin për të mundësuar përmbushjen e parakushteve të këtij nën-akti, atëherë në përputhje me çdo ligj, gjykata mund të prolongojë gjykimin në kohëzgjatje të periudhës së ndërprerjes së seancës.

2. Kur i pandehuri është i burgosur i mbrojtur i luftës, në mungesë të avokatit që pranon për të përfaqësuar të pandehurin, do të jepet një avokat me instruksione për qëllimin e dhënë nga ana e forcës mbrojtëse, pa paragjykitime në lidhje me normat e alinesë (2) të paragrafit (1) për shkak që përfaqësimit të të pandehurit.
3. Nëse gjykata ndërpret gjykimin në përputhje me paragrafin (1) për shkak të arsyes që i pandehuri nuk është i përfaqësuar nga një avokat, gjykata do të jep një avokat për t'u kujdesuar për interesat e të pandehurit në çdo procedurë të ardhshme në lidhje me shkeljen, dhe në çdo procedurë tjetër të ardhshme, në mungesë të avokatit që nuk pranohet nga avokati për shkak të përfaqësimit të tij/të saj ose si rezultat i instruksioneve të dhëna në nën-paragrafin (2), avokati i emëruar për qëllime e këtij nën-paragrafi, pa paragjykitime për nevojat nga alineja 2 e nën-paragrafit (1), do të caktohet për të përfaqësuar interesat e të pandehurit në përputhje me nën-paragrafin (1).
4. Do të caktohet një avokat në përputhje me nën-paragrafin (3) në mënyrën e përshkruar në rregulloren, ose në mungesë të dispozitës në rregulloret, me urdhër të gjykatës, dhe avokati i emëruar do të ketë të drejtë për të qenë i paguar nga (Ministri) me një shumë të tillë për të mbuluar shpenzimet dhe pagesat e përshkruara me rregulloret.

X. Ankesat nga ana e të burgosurve të mbrojtur të luftës dhe personat e internuar

1. Kur një i burgosur i mbrojtur i luftës ose një person i mbrojtur i internuar është dënuar me dënim me burg në lartë të dy ose më shumë viteve, periudha kohore në të cilën personi duhet të paraqesë ankesë ose lajmërim për paraqitjen e kërkesës për mungesë së ankesës (shkruaje emrin e gjykatës së apelit), pa marrë parasysh gjithçka të përmendur në aktet lidhur me ankesat e tilla, do të jetë periudha e datës së sjelljes së aktgjykimit ose

në rast të ankesës kundër aktgjykimit të aktgjykimit, deri në mbarimin e 10 ditëve pas datës në të cilën personi merr njoftimin –

- a. në rast të një të burgosuri të mbrojtur të luftës nga një oficer i (forcat e armatosura); ose
- b. në rast të një personi të mbrojtur të internuar, nga ose në emër të guvernatorit ose një personi tjetër që është përgjegjës për burgun ose vendin kur ai/ajo është burgosur;

se forca mbrojtëse është njoftuar për akuzën dhe aktgjykimin e tij/të saj.

2. Pasi është verifikuar ankesa kundër akuzës ose aktgjykimit të gjykatës për një të burgosur të mbrojtur të luftës ose një person i mbrojtur i internuar, dënimi mbetet dhe bëhet dënim me burg në periudhë prej 2 vitesh ose më shumë, kohë kjo në të cilën personi duhet të paraqesë kërkesë deri te (Prokurori Publik) për vërtetim për autorizimin e ankesës deri te (shkruaje emrin e gjykatës së apelit) do të jetë periudha nga data e vendimit të mëparshëm të ankesës deri në 7 ditë pas datës në të cilën personi ka marrë njoftimin e dorëzuar nga një person i përmendur në alinenë (a) ose (b), varësisht nga rasti, ose nën paragrafin (1), se forca mbrojtëse është informuar për vendimin e gjykatës pas ankesës së mëparshme.
3. Kur zbatohen nën paragrafin (1) ose (2) në lidhje me një person të akuzuar, atëherë përveç nëse në një mënyrë tjetër urdhëron gjykata, urdhri i gjykatës lidhur me kthimin e pasurisë ose pagimin e kompensimit për personin e dëmtuar nuk do të jetë i plotfuqishëm, dhe dispozita e ligjit lidhur me kthimin e pasurisë sipas akuzës nuk do të hyjë në fuqi në lidhje me akuzën, deri sa të ekzistojë mundësia për të paraqitur ankesë nga ana e personit të akuzuar kundër akuzës ose aktgjykimit të tij/të saj.
4. Nën paragrafët (1) dhe (2) nuk zbatohen në lidhje me ankesën kundër akuzës ose aktgjykimit, ose kundër vendimit gjyqësor për ankesën e mëparshme, nëse në momentin e akuzës ose aktgjykimit, ose vendimit të gjykatës për ankesën e mëparshme varësisht nga rasti, nuk ka forcë mbrojtëse.

XI. Ulja e dënimit dhe paraburgimit të të burgosurve të mbrojtur të luftës dhe personave të internuar

1. Në çdo rast ku i burgosuri i mbrojtur i luftës ose personi i mbrojtur i internuar është akuzuar për shkelje dhe është dënuar me dënim me burg, ligjërisht është (Prokurori Publik) të japë propozim për uljen e dënimit me burg për një periudhë të caktuar kohore, që nuk është i më e gjatë se kjo periudhë, nëse ka pasur, gjatë kohës së cilës personi ka qenë në paraburgim lidhur me shkeljen, për shkak të prolongimit ose kohëzgjatjes së gjykimit (duke përfshirë periudhën e gjykimit), pasi të ketë filluar të rrjedhë aktgjykimi, ose konsiderohet se ka filluar të rrjedhë.

2. Në rastin kur (Prokurori Publik) është i kënaqur që i burgosuri i mbrojtur i luftës i akuzuar për vepër ka qenë në paraburgim në lidhje atë vepër, për shkak të shtyrjes ose kohëzgjatjes së gjykimit (duke përfshirë edhe periudhën e gjykimit), për një periudhë të përgjithshme jo më pak se 3 muaj, ligjërisht është (Prokurori Publik) të jep udhëzim që i burgosuri të transferohet nga ai paraburgim në një paraburgim të (nëpunës i forcave të armatosura) dhe më tej të mbetet në paraburgim ushtarak në një kamp ose vend ku të burgosurit e mbrojtur të luftës janë të burgosur, dhe të sjellët para gjyqit në afatin e caktuar me urdhër të burgut.

Pjesa 4 – Keqpërdorimi i Kryqit të kuq dhe emblemave, shenjave, sinjaleve, letërnjoftimeve, markat dhe uniformat tjera

XII. Përdorimi i Kryqit të kuq, Gjysmëhënë së kuqe dhe emblemave të tjera, etj.

1. Në përputhje me dispozitat e këtij paragrafi, askush nuk e ka të lejuar pa miratimin e marrë në formë të shkruar nga (Ministri i Mbrojtjes ose një person i autorizuar në formë me shkrim nga Ministri për të dhënë miratim në përputhje me këtë paragraf), për të përdorur ose theksuar për ndonjë qëllim ndonjë nga këto:
 - a. emblemën e kryqit të kuq me krahë vertikale dhe horizontale të gjatësisë së njëjtë, dhe tërësisht të rrethuara me prapavijë të bardhë, ose emrin “Kryqi i kuq” ose “Kryqi i Gjenevës”;
 - b. emblemën e Gjysmëhënës së kuqe në dhe plotësisht të rrethuar me prapavijë të bardhë ose emrin “Gjysmëhëna e kuqe”;
 - c. emblemën me ngjyrë të kuqe dhe plotësisht të rrethuar në prapavijë të bardhë, ose luanin e kthyer nga e djathta në të majtë, me fytyrën e kthyer kah vëzhguesi, i cili mban të ngritur në kthetrën e djathtë një jatagan, dhe mbi stemën e luanit qëndron një gjysmë dielli që lëshon rreze, ose emrin “Luani i kuq dhe dielli”;
 - d. emblemën me ngjyrë të kuqe dhe plotësisht të rrethuar me një sfond të bardhë, ose një kornizë të kuqe në formë të kuadratit i vendosur në skaj (me ose pa emblemë në qendër ose një kombinim i tillë në përputhje me Nenin 3, alineja 1 e Protokollit Shtesë III), ose emrin “Kristali i kuq” ose emrin “Emblema e Protokollit të Tretë”;
 - e. emblemën në kryq të bardhë ose të argjendtë me krahë vertikale ose horizontale me gjatësi të njëjtë, plotësisht të rrethuar me sfond të kuq, i cili është emblemë heraldike e Konfederatës Zvicerane;
 - f. shenjën e një trekëndëshi barabrinjës i kaltër, plotësisht të rrethuar me sfond të verdhë, që është shenjë mbrojtëse ndërkombëtare e mbrojtjes civile;

- g. çdo sinjal mbrojtës i përcaktuar në Kapitullin 3 të Aneksit 1 të Protokollit I, që janë sinjale për identifikimin e njësiveve transporteve mjekësore;
 - h. shenjën e përbërë nga grupi i 3 rrathëve të ndritshëm portokalli me madhe të barabartë, të vendosur në një bosht të njëjtë, dallimi në mes rrathëve është një radius, që përfaqëson shenjë të veçantë ndërkombëtare për ndërtime dhe instalime që përmbajnë fuqi të rrezikshme;
 - i. dizajni, fjalët ose sinjali që është përkujton afërsisht në ndonjë nga emblemat, emrat, shenjat ose sinjalet e përcaktuara në alinenë (a), (b), (c), (d), (e), (f), (g) ose (h) që mund të çojë në gabim, ose në rasti është i tillë, të jetë kuptuar si njëri nga këto emblema, emra, shenja ose sinjale;
 - j. flamuj, emblema, emra, shenja, dizajnë, formulime, letërnjoftime, harta informacioni, marka ose uniforma të tilla të tjera siç janë përshkruar në Konventat ose Protokollet.
2. (Ministri i Mbrojtjes ose një person i autorizuar në formë me shkrim nga Ministri për të dhënë miratim në përputhje me këtë paragraf) nuk do të japë një miratim të tillë, përveç nëse kanë hyrë në fuqi dispozitat e Konventave ose Protokolleve dhe mund të refuzojë ose të tërheqë një miratim të tillë varësisht nga nevoja.
 3. Kjo pjesë ka të bëjë me përdorimin në ose jashtë nga (shkruaje emrin e shtetit) të një embleme, emri, shenje, sinjali, dizajni, formulimi, letërnjoftimi, marke ose uniforme në përputhje me nën paragrafin (1) në çdo anije ose fluturake të regjistruar në (shkruaje emrin e shtetit).

XIII. Shkeljet dhe dënimet

1. Çdo person që do të veprojë në kundërshtim me paragrafin 12(1) do të thirret në përgjegjësi për shkeljen dhe do të dënohet me dënim që nuk është më i lartë se (shkruani dënimin maksimal në të holla) ose me dënim me burg në kohëzgjatje jo më gjatë se (shkruaje periudhën maksimale të dënimit me burg) ose të dyja.
2. Kur gjykata do të akuzojë një person për shkelje sipas paragrafit 12(1), gjykata mund të urdhërojë konfiskim nga ana e shtetit të:
 - a. Çdolloj mallrash ose artikujsh tjerë në lidhje me përdorimin e një embleme, emri, shenje, sinjali, dizajni ose, formulimi nga ana e këtij personi; dhe
 - b. Çdo letërnjoftim, kartë identifikimi, markë ose uniformë e përdorur që ka çuar në shkelje.
3. Kur shkelja në përputhje me Nenin 12(1) është provuar se është kryer nga një trup korporativ me miratimin ose heshtjen e drejtorit, menaxherit, sekretarit ose të një nëpunësi tjetër të korporatës, ose personit që e ka kryer

veprën në çdolloj cilësie, ai ose ajo, si dhe trupi i korporatës do të bartin përgjegjësinë për shkelje dhe do të përndiqen penalisht dhe do të dënohen në mënyrë përkatëse.

4. Veprimet në përputhje me paragrafin 12(1) nuk do të iniciohen pa miratim në formë të shkruar nga (Prokurori Publik).

XIV. Përfashtimi

Në rast kur ka të regjistruar një shenjë mbrojtëse para sjelljes së këtij ligji, paragrafët 12 dhe 13 nuk zbatohen vetëm në qoftë se ekziston një emblemë e përcaktuar nga nën paragrafi 12(1) (b), (c) ose (d) ose dizajni që përkujton në një emblemë të tillë, dhe ku personi është akuzuar për përdorim të një embleme, shenje ose dizajni të tillë për çfarëdo qëllimi dhe nëse provohet se personi e ka përdorur si pjesë të shenjës mbrojtëse në atë mënyrë të regjistruar paraprakisht, dhe për këtë qëllim në mbrojtje të tij, personi duhet të dëshmojë:

- a. se personi ligjërisht e ka përdorur emblemën, shenjen ose dizajni për këtë qëllim para se të sillet ky ligj; ose
- b. në rastin kur personi është akuzuar për përdorim të emblemës, shenjës ose dizajnit të mallit ose një produkti tjetër, se emblema, shenja ose dizajni janë vënë në mallrat ose në atë artikull para se personi t'i ketë marrë ose t'i ketë prodhuar një person tjetër ose i ka përdorur ato gjatë tregtisë që ligjërisht e ka përdorur emblemën, shenjen ose dizajni në produkte ose artikuj të ngjashëm para sjelljes së këtij ligji.

Pjesa 5 – Rregullat

XV. Rregullat

(shkruajeni emrin e rregullës – organit që e sjellë) për sjelljen e rregullave:

- a. përcaktimi i një formulari për flamujt, emblemat, emrat, shenjat, sinjalet, dizajnet, formulimet, letërnjoftimet, hartat informative, markat ose uniformat e përdorimit me qëllim të hyrjes në fuqi të forcës së Konventave ose Protokolleve ose të dyjave dhe rregullimi i përdorimit të tyre;
- b. përcaktimi i dënimit që mund të imponohet në lidhje me shkeljen ose mosrespektimin e çdolloj rregulli në përputhje me alinenë (a) të këtij paragrafi, që mund të dënohet me dënim në të holla që nuk është më i lartë se (shkruaj shumën maksimale të dënimit në të holla) ose me dënim me burg që nuk është më i gjatë se (shkruaj periudhën maksimale të dënimit me burg) ose të dyja; dhe
- c. kushtet për gjëra të tjera që janë të nevojshëm për të përmbushur ose që janë të lejuara për t'i përcaktuar, ose që janë të domosdoshme ose të përshtatshme për t'u përcaktuar, për kryerjen ose për të hyrë në fuqi ky ligj..

1. Konventa e Gjenevës për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve dhe të sëmurëve në forcat e armatosura në luftë e miratuar në Gjenevë më 12 gusht të vitit 1949.
2. Konventa e Gjenevës për përmirësimin e gjendjes së të plagosurve dhe të sëmurëve dhe të atyre që kanë pësuar një fundosje të anijes pjesëtarë të forcave të armatosura detare e miratuar në Gjenevë më 12 gusht të vitit 1949.
3. Konventa e Gjenevës për të vepruar me të burgosurit e luftës e miratuar në Gjenevë më 12 gusht të vitit 1949.
4. Konventa e Gjenevës për mbrojtjen e civilëve gjatë kohës së luftës e miratuar në Gjenevë më 12 gusht të vitit 1949.
5. Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës i 12 gushtit të vitit 1949, i cili ka të bëjë me Mbrojtjen e Viktimave në Konfliktet e Armatosura Ndërkombëtare (Protokolli I) i 8 qershorit të vitit 1977.
6. Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës i 12 gushtit të vitit 1949, i cili ka të bëjë me Mbrojtjen e Viktimave në Konfliktet e Armatosura Jo-ndërkombëtare (Protokolli II) i 8 qershorit të vitit 1977.
7. Protokolli Shtesë i Konventave të Gjenevës i 12 gushtit të vitit 1949, i cili ka të bëjë me Miratimin e Emblemës Mbrojtëse Shtesë (Protokolli III) i 8 dhjetorit të vitit 2005.
8. Rezoluta 1 e Konferencës së 29-të Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe (Gjenevë 20 – 21 qershor i vitit 2006).

KNKK dhe BNP në vija të shkurta

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq - KNKK

Mandati dhe misioni i KNKK-së

Puna e KNKK-së bazohet në Konventat e Gjenevës, Protokollet e tyre Shtesë dhe Statutin – dhe në ato të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës

së kuqe – dhe rezolutat e Konferencave Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. KNKK është organizatë e pavarur, e paanshme dhe neutrale e cila siguron mbrojtje dhe ndihmë humanitare për viktimat e një konfliktit të armatosur dhe situatat tjera të dhunës.

Me iniciativë të KNKK shtetet miratuan Konferencën origjinale të Gjenevës së vitit 1864. Që atëherë, KNKK, me mbështetjen e tërë Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, në mënyrë konstante inkurajon qeveritë për të përshtatur të drejtën humanitare ndërkombëtare drejt rrethanave ndryshuese në botë, sidomos për të harmonizuar me zhvillimin modern në lidhje me mjetet dhe metodat e luftës, për të siguruar një mbrojtje dhe ndihmë më efektive për viktimat e konflikteve të armatosura. Sot, të gjitha shtetet janë të detyruara me katër Konventat e Gjenevës, të cilat gjatë kohës së një konflikti të armatosur, i mbrojnë të plagosurit, të sëmurët dhe ata që kanë pësuar fundosje të anijes, pjesëtarë të forcave të armatosura, të burgosurit e luftës dhe civilët.

Mbi 3 të katërtat e të gjitha shteteve për momentin janë nënshkruese të dy Protokolleve Shtesë të Konventave të vitit 1977. Protokolli I mbron viktimat e konflikteve të armatosura ndërkombëtare, dhe Protokolli II viktimat e konflikteve të armatosura jo-ndërkombëtare. Këto marrëveshje përmbajnë rregulla të cilat mbrojnë popullsinë civile nga efektet e armiqësive. Protokolli Shtesë III i vitit 2005, lejon përdorimin e emblemës shtesë – Kristali i kuq – nga ana e shoqatave nacionale të Lëvizjes.

Baza juridike për çdo aksion që ndërmerr KNKK-ja del nga:

- Katër Konventat e Gjenevës dhe Protokollit Shtesë I i mundësojnë KNKK-së një mandat të veçantë për të vepruar në rast të një konflikti të armatosur ndërkombëtar. KNKK ka të drejtë për të vizituar të burgosurit e luftës dhe personat e internuar civilë. Konventat gjithashtu i japin të drejtë të gjerë ndërmarrjes së iniciativave të KNKK-së.
- Në konflikte të armatosura jo-ndërkombëtare, KNKK gëzon të drejtën e iniciativave humanitare e njohur nga ana e komunitetit ndërkombëtar dhe e inkorporuar në Nenin 3 të përbashkët për Konventat e Gjenevës.
- Në rast të trazirave dhe tensioneve të brendshme, dhe në çdo situatë tjetër që garantojnë një aksion humanitar, KNKK gjithashtu gëzon të drejtën e iniciativës që është e njohur në Statutin e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Së këtejmi, gjithmonë kur DHN nuk zbatohet, KNKK mund të ofrojë shërbimet e veta për qeveritë pa paraqitur kjo ofertë përzierje në punët e brendshme të shteteve në fjalë.

Misioni i KNKK

KNKK është organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur që ka mision për të mrbojtur jetën dhe dinjitetin e viktimave të një konflikti të armatosur dhe situata të tjera të dhunës dhe për të siguruar ndihmë për ta.

KNKK gjithashtu përpiket për të parandaluar vuajtjen përmes promovimit dhe forcimit të së drejtës humanitare dhe parimeve universale.

E themeluar në vitin 1863, KNKK përfaqëson fillin e Konventave të Gjenevës dhe Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Ai i drejton dhe koordinon aktivitetet ndërkombëtare që i zbaton Lëvizja në konflikte të armatosura dhe në situata të tjera të dhunës.

Për më shumë informacione:

Kryqi i kuq ndërkombëtar

19, Avenue de la Paix, 1202 Geneva, Switzerland

Tel: +41 22 734 60 01

Fax: +41 22 733 20 57

ICRC: <http://www.icrc.org/>

Twitter: <http://twitter.com/ICRC>

Facebook: <http://www.facebook.com/ICRC/>

Instagram: <http://www.instagram.com/ICRC/>

Linkedin: <http://www.linkedin.com/company/icrc>

YouTube: <http://www.youtube.com/user/icrcfilms>

Shërbimi Këshillëdhënës i Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare

Si strukturë e specializuar e KNKK, Shërbimi Këshillëdhënës u ndihmon shteteve në implementimin e DHN-së në nivel nacional. Me rrjetin global të këshilltarëve juridikë, shërbimi këshillëdhënës siguron udhëzime për organet shtetërore për masat specifike për implementimin nacional lidhur me përmbushjen e detyrimeve për DHN në nivel nacional. Shërbimi Këshillëdhënës gjithashtu ndihmon në këmbimin e informacioneve lidhur me masat e implementimit nacional. Krahas sigurimit të këshillave juridike dhe mbështetjes teknike, Shërbimi Këshillëdhënës ndihmon në ndërtimin e kapaciteteve me kërkesë të autoriteteve nacionale dhe trupave të tjera në fjalë.

Shërbimi Këshillëdhënës bashkëpunon ngushtë me qeveritë, duke pasur parasysh nevojat e tyre specifike, sistemet politike dhe traditat juridike. Nëpërmjet punës së sa inkurajon shtetet për të miratuar marrëveshjet DHN dhe instrumentet tjera relevante dhe vënien e tyre në përdorim në një kornizë ligjore gjithëpërfshirëse.

Shërbimi Këshillëdhënës u siguron qeverive këshilla juridike dhe ndihmë teknike përmes rrjetit global të këshilltarëve të aftësuar dhe me përvojë juridikë. Shërbimi Këshillëdhënës mban kontakte bilaterale me shërbimet shtetërore, organizon punëtori tematike profesionale dhe sponsoron takime rajonale dhe ndërkombëtare për shërbimet relevante shtetërore. Këshilltarët e tij juridikë ngushtë

bashkëpunojnë me shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, me institucione akademike dhe grupe të tjera dhe individë.

KNKK ofron resurse të specializuara për këmbimin e informacioneve për DHN, të drejtën zakonore dhe masa të tjera të ngjashme. Këto resurse në mënyrë konstante zgjerohen dhe janë përmbajtur në bazën e të dhënave të DHN-së për implementimin nacional të DHN-së, që përmban një përmbledhje ligjesh dhe të drejtës zakonore kushtuar normave të DHN-së.

Shërbimi Këshillëdhënës bashkëpunon me organizata relevante ndërkombëtare dhe rajonale për promovimin e kuptimit të DHN-së dhe thellimit të punës së KNKK-së për implementimin e DHN-së. Ndërmjet këtyre organizatave janë UNESCO – Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, Sekretariati i Komonuelltit, Këshilli i Evropës, Organizata e Shteteve të Bashkuara, Gjykata Penale Ndërkombëtare dhe Bashkimi Ndërparlamentar.

Për më shumë informacione kontaktoni gva_advisoryservice@icrc.org

Dokumentet referuese

- KNKK, E Drejta Humanitare Ndërkombëtare: Përgjigje të pyetjeve të juaja, viti 2015, në dispozicion në <https://shop.icrc.org/international-humanitarian-law-answers-to-your-questions-261.html>
- KNKK, Implementimi vendos i Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare, , në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/pdvd40.htm>
- Kryqi i kuq i Australisë, Promovimi i respektimi të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare – doracaku për deputetët, në dispozicion në <http://www.redcross.org.au/ihl-resources.aspx>
- KNKK, zbuloheni KNKK-në, në dispozicion në <https://www.icrc.org/eng/resources/documents/publication/p0790.htm>

Faqet e dobishme të internetit

KNKK: <https://www.icrc.org/en>

Gjykata Penale Ndërkombëtare: https://www.icc-cpi.int/EN_Menus/icc/pages/default.aspx

Rishikimi Ndërkombëtar i Kryqit të kuq: <https://www.icrc.org/en/international-review>

Komisioni Humanitar Ndërkombëtar për Verifikimin e Fakteve:

<http://www.ihffc.org/index.asp?Language=EN&page=home>

Lista e shteteve nënshkruese të marrëveshjeve DHN: <https://www.icrc.org/ihl>

Baza e të dhënave të KNKK për implementimin nacional të DHN-së:

<https://www.icrc.org/ihl-nat>

Ligjet model për çështjet DHN:

<https://www.icrc.org/eng/resources/documents/legal-fact-sheet/national-implementation-model-laws.htm>

Platforma e ligjeve dhe politikave: <https://www.icrc.org/en/war-and-law/law-and-policy>

Për më shumë informacione për marrëveshjet dhe të drejtën zakonore:

<https://www.icrc.org/en/war-and-law/treaties-customary-law>

Për më shumë informacione për DHN-në zakonore:

<https://www.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/home>

Për më shumë informacione për programet e trajnimit të forcave të armatosura:

<https://www.icrc.org/en/what-we-do/building-respect-ihl/dialogue-weapon-bearers>

E-kursi për të mësuar për DHN-në: <https://www.icrc.org/eng/war-and-law/law-and-policy/online-training-centre.htm>

Lista e fundit e rasteve, dokumenteve dhe e ligjeve nacionale për praktikrat moderne të DHN-së: <https://www.icrc.org/en/document/how-does-law-protect-war-online-platform>

Bashkimi Ndërparlamentar

Bashkimi Ndërparlamentar është organizata e vetme e përbërë nga parlamentet nacionale të mbarë botës. Mbrojmë dhe ndërtojmë demokracinë përmes dialogut politik dhe aksionit konkret.

BNP-ja për momentin ka **170 Parlamente Anëtarë** dhe 10 Anëtarë Shoqërues. Punojmë në bashkëpunim të ngushtë me Kombet e Bashkuara dhe organizata të tjera partnere me të cilat kemi qëllime të përbashkëta.

Punojmë **në fushë të gjerë të aktiviteteve** të tilla si paqja, drejtësia, demokracia dhe para së gjithash zhvillimi. Punojmë në çështje të një spektri të gjerë duke filluar nga HIV/SIDA, të drejtat e njeriut, barabarësia gjinore, ndryshimet klimatike dhe pjesëmarrja politike e të rinjve. Ndhimojmë vendet që dalin nga konfliktet ose që zhvillohen si demokraci.

Gjithashtu punojmë për të futur mendimet e qytetarëve të mbarë botës në kuadër të një vendimmarrje globale përmes punës sonë gjithnjë e më të rëndësishme në fushën e **udhëheqjes ndërkombëtare**.

Sot, ne jemi organizatë që më së afërmi shpreh mendimin publik botëror. Më shumë se 6.5 miliardë nga 7 miliardë njerëz të popullsisë në botë, jetojnë në shtete, parlamentet e të cilave janë anëtare të BNP-së – dhe përfaqësuesit e tyre të zgjedhur marrin pjesë në menaxhimin e politikave tona.

Përmes afërsisë së parlamenteve tona, i afrojmë edhe njerëzit.

Organizata më e vjetër politike multilaterale botërore, BNP është **themeluar në vitin 1889**, me qëllim që të përdorë dialogun ndërparlamentar për të zgjidhur kontestet ndërmjet kombeve në mënyrë paqësore. Ky mision mbetet i vërtetë dhe relevant edhe sot siç ishte në vitin 1889.

Ne financohemi nga anëtarët tona nga fondet publike. Zyra jonë qendrore është në Gjenevë, Zvicër.

Për më shumë informacione:

Bashkimi Ndërparlamentar

5, chemin du Pommier

1218 Le Grand-Saconnex/Geneva, Switzerland

Tel.: +41 22 919 41 50

Fax: +41 22 919 41 60

postbox@IPU.org

www.IPU.org

Twitter: IPUparliament

AKRONIMET

KKO	Konventa për Ndalimin ose Kufizimin e përdorimit të disa armëve konvencionale që mund të shkaktojnë lëndime të tepruara ose të kenë efekte jo selektive
KAN	Konflikti i armatosur ndërkombëtar
GjPN	Gjykata Penale Ndërkombëtare
TPNR	Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ruandën
TPNIJ	Tribunali Penal Ndërkombëtar për Ish-Jugosllavinë
PZHBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
DHN	E Drejta Humanitare Ndërkombëtare
DNDNj	E Drejta Ndërkombëtare e Të Drejtave të Njeriut
KAJN	Konflikti i armatosur jo-ndërkombëtar
KPUS	Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë